

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX,
E enjte, 13 shkurt 2020
çmimi 0.40 €
nr. 6000

“Epoka e re” 20 vjet
rrugëtim, 6 000
numra dhe unë 13 vjet
me “Epokën...”

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

Mal
QORRAJ



AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PËR NUMRIN 6000, TË GJITHË JUVE, 6000 MIRËNJOHJE TË ZEMRËS



Muhamet MAVRAJ

Numri i 6000-të i të përditshmes “Epoka e re” u shtyp tashmë.

Është histori më vete, për mua shumë e dhimbshme në shumë periudha dhe shumë më e rrezikshme sesa e dhimbshme në disa çaste karakteristike. Kemi jetuar edhe çaste shumë të mira por, të gjitha, bashkë me vështirësitë, janë çaste të ndjenjës së mirë që të jep gazetaria. Por, meritat për asgjë nuk janë të miat. Janë të atyre që kanë punuar në të sadopak apo sado shumë, apo edhe përgjithmonë si Shkëmbim Krasniqi që për 6000 numra nuk ka pranuar një herë të vetme të mungojë, të

shkojë në pushime apo të rrijë vetëm për ngushëllime në shtëpi në raste mortit që, madje, u martua një të shtune që të vinte në punë të dielën për numrin e së hënës. Pas tij vijjnë Sadik Zeqiri, Mal Qorraj, Shqipe Hetemi, Berat Dakaj e kështu me radhë, Muhameti (Koci), Lirimi, Albulena etj.

Artikulli im për numrin 6000, në të vërtetë, për fjalë të mia merr emrat e mëposhtëm dhe po kaq emra të tjerë të shpërndarë nëpër botë, që kanë punuar qoftë si kolumnistë, qoftë si korrespondentë apo në ndonjë detyrë tjetër gazetare. Disa nga ish-kolegët a punëtorët tashmë të ndjerë, u prehshin në paqe përgjithmonë: Hamdi Miftari, Bajram Smakaj, Skënder Idrizi dhe Avni Makolli. Sikurse lexuesve e përkrahësve të sinqertë të gazetës, ndër të cilët veçoj shokun tim Ismet Sylejmanin, të gjithëve, po ta kisha mundësinë, përfshirë emrat e mëposhtëm do t'u ndaja nga 6000 mirënjohje:

Afet Bela, Afërdita Maliqi, Agim Muhaxheri, Ahmet

Bilalli, Ahmet Tmava, Alban Zeneli, Albert Ademi, Albert Shala, Albulena Mavraj, Arben Atashi, Arben Mlinaku, Arbenita Kamberi, Arbër Grabovci, Arbert Abdyli, Arbresha Baftiu, Argin Kelmendi, Arieta Gashi, Arizona Dibra, Arlinda Sejdiu, Arsim Lani, Arsim Osmani, Arsim Sinani, Arta Sylejmani, Artan Mustafa, Astron Mahmutaj, Avdullah Hoxha, Avni Azemi, Avni Makolli, Aziz Bytyçi, Bajram Lani, Bajram Smakaj, Behram Krasniqi, Bekim Ademi, Beqir Beqaj, Berat Dakaj, Besart Krasniqi, Besim Muhadri, Besnik Dema, Besnik Krasniqi, Bislim Berisha, Blerim Çoçaj, Blerina Veseli, Burim Etemaj, Daut Gashi, Demir Reshiti, Donika Bunari, Driton Bublaku, Driton Hajrizi, Driton Kamberi, Driton Lajçi, Driton Leku, Driton Paqarada, Ekrem Kryeziu, Elmedina Ballazhi, Emine Rushiti, Enver Maloku, Eranda Nepravishta, Ernest Luma, Fahri Axhalena, Fatma Restelica, Fatmir Bytyçi, Faton Dermaku, Faton Polisi, Fazli

Muharremi, Fehmi Ajvazi, Fehmi Baftiu, Fehmi Gegaj, Fehmi Sylejmani, Fehmi Maloku, Fidajete Geci, Florije Ademi, Ganimete Muli, Gazmend Morina, Gëzim Pozhegu, Haki Hysenaj, Hamdi Miftari, Heset Zymberi, Hysni Sylja, Igballe Imeraj, Ilir Kabashi, Imer Mushkolaj, Islam Haxhiu, Ismail Gagica, Ismail Rexhepi, Jahja Tmava, Jasemina Mulaku, Jehona Velju, Jetlir Zyberaj, Jeton Kelmendi, Jeton Musliu, Jeton Osmanaj, Jeton Rushiti, Jeton Mazrekaj, Kimete Islami, Kimete Krasniqi, Kreshnik Sylejmani, Kujtim Shala, Liridon Ibërdemaj, Lirije Klaiqi, Lirim Geci, Lulzim Ahmeti, Lulëzim Etemaj, Lulzim Sahiti, Mal Qorraj, Malsore Llapashtica, Mangji Gashi, Marin Kelmendi, Melisa Demiri, Mentor Gojani, Mentor Shala, Mihrije Krapë, Milaim Sylja, Milazim Kadriu, Mimoza Hoxha, Minire Berisha, Miradije Aliu, Miradije Gashi, Muhamet Jahiri, Muhamet Koci, Musa Ramizi, Musa

Sabedini, Musli Krasniqi, Myrvete Haxholli, Naim Zeqiri, Nebih Behluli, Nexhat Çoçaj, Nexhat Krasniqi, Nexhmije Ahmeti, Ngadhnjim Ademi, Nijazi Ramadani, Prend Buzhala, Qemajl Krasniqi, Qëndresa Fazliu, Qëndresa Mustafa, Qëndresa Rama, Qerim Rexhaj, Ragip Guraziu, Ragip Gjoshi, Ramize Murtezi, Rexhë Hasani, Rexhep Tërshnjaku, Ridvan Berisha, Rifat Buzuku, Rifat Sadikaj, Rinor Beka, Rrahman Jasharaj, Rushe Haxhaj, Sabahate Shala, Sadete Bajrami, Sadik Zeqiri, Safete Makolli, Sali Beqiraj, Saranda Geci, Seman Shala, Sheribane Hashani, Shkelzen Çoçaj, Shkëmbim Krasniqi, Shpend Çoçaj, Shqipe Hetemi, Skender Idrizi, Tomor Grabovci, Uran Krasniqi, Valdete Elshani, Veton Zymberi, Xhavit Nura, Xhevdet Fetahu, Yldije Sulka, Zanë Zyba, Zymer Osmani dhe po kaq të tjerë! Sot do të pimë kafe të gjithë së bashku! Ejani! Faleminderit të gjithëve për gjithçka!

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

KNAUF INSULATION
Ehtë koha ta korrësh energjinë!
Mob: 049/335-221
049/335-224
049/334-224
www.knaufinsulation.com/al

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

6 000 0

Gazeta e përditshme "Epoka e re" sot (e enjte) ka nxjerrë në treg numrin 6 000. Numri që sot keni në duar është shumë i veçantë. Në këtë numër keni përshtypjet e të gjithë atyre që kanë mësuar ABC-në e

gazetarisë në "Epokë...", që sot janë pjesë e mediave të ndryshme në vendin tonë dhe të atyre që sot janë pjesë e saj. Në këtë numër kemi vendosur të mos e botojmë asnjë aktivitet ditor, por faqet e saj i

kemi rezervuar për të gjithë ata që kanë dhënë kontribut për rrugëtimin 20-vjeçar të "Epokës së re". Sot, në orën 12.00, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në sallën e

Institutit të Studimeve Sociale dhe Humanistike, me gazetarë dhe ish-gazetarë do të takohemi për ta kremtuar 20-vjetorin e gazetës, për të shpalosur kujtime nga puna jonë, për ta ngrehur nga një

dolli, për t'i dhënë dikujt mirënjohje e dikujt falënderim dhe për ta falënderuar secilin për kontributin e vazhdueshëm që ka dhënë për gazetën "Epoka e re" që nga themelimi i saj.



Sadik Zeqiri: Ky shekull ka pasur nevojë për "Epokën e re"

Kur ka dalë nga shtypi numri i parë i gazetës "Epoka e re" unë nuk kam qenë pjesë e saj. Isha ende në kazamatet serbe duke vuajtur dënimin që ma kishte caktuar gjykata e Serbisë. Pasi jam liruar nga burgju, botuesi i gazetës, Muhamet Mavraj, erdhi për të më vizituar në shtëpi. Fjalët e tij, kur mbaroi vizitën në shtëpinë time, ishin: "Pusho sa të duash dhe pas pushimit eja në Prishtinë, se na pret një punë e madhe". Kam ardhur në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në pallatin e shtypit, në katin e 12-të. Aty kam takuar shumë gazetarë e bashkëpunëtorë të gazetës. E kam takuar Mavrajn i cili më vonë më ka ngarkuar me detyrën e sekretarit të redaksisë, më pas drejtor financiar e dikur drejtor i përgjithshëm, detyrën që e bëj ende. Por gjatë kësaj periudhe kemi pasur edhe ditë të lavdishme dhe të hidhura. Lavdia është vetë ajo kur i gjithë tirazhi i shtypur shitej që në mëngjes, ndërsa ditë vuajtjesh kisha kur, për një kohë të gjatë gazeta shtypej në shtypshkronja të Maqedonisë, gazeta vonohej për rrjetin e shpërndarjes dhe pasi veturat niseshin për qytete të Kosovës, "Epoka" mbetej në magazinat e "Rilindjes". Për të mos mbetur në magazinat e "Rilindjes", shumicën e herëve

unë dhe "Daja", Shkëmbim Krasniqi, merrmim rrugë në dy drejtime të Kosovës. Ai për Ferizaj e Gjilan, unë për Dukagjin e anë tjetër, për ta shpërndarë gazetën nëpër pikat e rrjetit privat dhe rrjetit të "Rilindjes", vetëm që gazeta të jetë në duart e lexuesve. Për t'i mbushur 20 vjet jetë gazeta "Epoka e re" dhe për ta botuar numrin e 6000 duhet falënderuar botuesin Muhamet Mavraj, lexuesit që na qëndruan besnikë deri sot e që shpresojmë edhe në të ardhmen. Duhet falënderuar të gjithë ata që na mbështetën dhe na besuan ta reklamojnë biznesin e tyre, ata që na dërguan urime dhe njoftime për festa e ditë të zakonshme, ato institucione lokale dhe qendrore të Kosovës që na dërguan konkurse, shpallje dhe njoftime, pa të cilat nuk do të mund të mbijetonim. Duhet falënderuar edhe shtypshkronjat që patën mirësinë dhe durimin, që edhe atëherë kur e vononim gazetën për ta dorëzuar në shtyp, na pritnin. Faleminderit edhe rrjeteve të shpërndarjes që bënë shpërndarjen e gazetës dhe që vazhdojnë ta shpërndajnë të njëjtën punë ende!



Mal Qorraj: "Epoka e re" 20 vjet rrugëtim, 6 000 numra dhe unë 13 vjet me "Epokën..."

"Epoka e re" sot ka rrumbullakuar 6 000 numra për 20 vjet të rrugëtimin të saj në

tregun medial. Ky numër i sotëm që keni në duar, i 6 000-ti, është i veçantë për faktin se në të keni përshtypjet e të gjithë atyre që kanë kaluar në këtë medium dhe atyre që janë pjesë e saj.

"Epoka e re" për këto 20 vjet ka përgatitur profesionalisht gazetarë të shumtë, disa prej të cilëve rrëfejnë në këtë numër jubile, po ashtu ka përgatitur redaktorë dhe kryeredaktorë. Nga përshtypjet e tyre për këtë 20-vjetor del se "Epoka e re" ishte një shkollë e gazetarisë, por unë do ta quaja universitet për profesionin e gazetarisë. "Epoka e re" në gjithë këtë rrugëtim është treguar gazetë e guximshme, e pathyeshme dhe pandalshme në misionin e saj madhor të informimit të së vërtetës për opinionin.

"Epoka e re" për këto vite ka trajtuar tema të rëndësishme të karakterit politik, ekonomik, social, kulturor dhe sportiv. "Epoka..." vazhdon të mbetet një gazetë që u jep hapësirë për mendime të gjitha palëve, kudo që ka shqiptarë.

Sigurisht se për ekzistimin e saj deri më sot merita ka botuesi Muhamet Mavraj dhe lexuesit e saj fanatikë, tek pastaj ne që jemi pjesë e saj dhe ata që ishin më herët. "Epoka e re" deri sot ka ecur vetë, me vetëfinancim, me ata që e blejnë dhe me reklamimin që bëjnë disa kompani që nuk janë ndarë nga "Epoka..."

Krahas versionit të shkruar, "Epoka e re" është edhe në platformën online, ku edhe në këtë platformë është duke dhënë kontribut të çmuar në bërjen e gazetarisë së pavarur, duke mos u lëshuar në lajme të rreme vetëm sa për të fituar nga klikimet.

Sot në Kosovë nuk është lehtë që fillikat, pa ndihmën e askujt, të botosh një gazetë dhe t'ia festosh

ditëlindjen e 20-të. Këtë e ka bërë Muhamet Mavraj. Si çdo kompani, edhe "Epoka e re" në këtë rrugëtim të saj medial, po flas për 13 vjet sa jam pjesë e saj, ka pasur sfida, por që janë tejkaluar. Kur ka vullnet dhe sinqeritet në punë çdo pengesë tejkalohet.

"Epoka e re" për mua është shtëpi e dytë, ku më së shumti e kaloj kohën. Më ka mësuar shumë profesionalisht, por edhe unë i kam qëndruar besnik për këto 13 vjet. Të jesh pjesë e një mediumi që ka vlera kombëtare është krenari.

Në "Epokën e re" bëra shumë miq e shumë shokë. Në "Epokën e re" takova edhe personin e jetës, gazetaren Qendresa Rama, me të cilën sot kemi një vajzë të mrekullueshme, Junën.

Uroj të festojmë edhe shumë ditëlindje të tjera të "Epokës së re"!



Veton Zymberi: "Epoka e re" më bëri të dashurohem në profesionin e gazetarit

Më 21 shkurt i mbushi trembëdhjetë vjet në familjen e madhe të "Epokës së re", gazetë e cila më guxim, raportimin e drejtë dhe mbrojtjen e vlerave të luftës më bëri të dashurohem në profesionin e gazetarit. Si gjimnazist isha lexues i rregullt i gazetës së luftës, siç e quanin në atë kohë "Epokën", kurse pas përfundimit të shkollës së mesme, duke pirë kafe çasti në

qytetin e Pejës me njërin nga shokët më të mirë dhe njëkohësisht duke shfletuar "Epokën" në faqen e fundit e vrojtova konkursin e Fakultetit të parë dhe të vetmit të gazetarisë deri në atë kohë "Faik Konica". Të nesërmen u lajmërova në administratën e këtij fakulteti dhe u regjistrova. Në provimin pranues, dekani dhe profesori tashmë i ndjerë, Ramiz Kelmendi, më pati dhënë një këshillë: "Për të qenë një gazetar i mirë duhesh që gjuhën shqipe ta flasësh e ta shkruash pastër". Kjo këshillë e drejtë e profesorit nuk më pëlqeu aspak për faktin se isha i mësuar që të mos e flisja gjuhën standarde në familje dhe shoqëri. Në semestrin e fundit të studimeve, me iniciativë të shokut të studimeve, Mal Qorraj, fillova praktikën në gazetën time të zemrës, "Epokën e re". Normalisht se falënderim i veçantë për mundësinë e dhënë dhe meritën për krejt të arriturat në jetën time është botuesi Muhamet Mavraj. Pas praktikës njëmuajore, drejtori i gazetës Sadik Zeqiri më njoftoi se tani e tutje je pjesë e familjes së "Epokës". Lajm që më gëzoj përtej mase për faktin se brenda muajit arrita që të tregoj se jam i gatshëm të bëhem pjesë e stafit të mrekullueshëm të gazetës "Epoka e re". Ende pa mbushur vitin në gazetë, redaktori i sportit, Liridoni, ndërpreu punën, por mungesën e përvojës e mbulovala me përkrahjen e drejtorit që ne e quajmë "Dika", i cili edhe sot vazhdon të ma ofrojë përkrahjen si në ditët e para. Pastaj në gazetë erdhën Fatmiri, Tomori dhe Fatoni dhe, me ndihmën e korrespondentëve, pasqyruam ngjarjet më të rëndësishme në sportin vendor dhe ndërkombëtar, promovuam edhe shumë sportistë të rinj që sot kanë bërë emër edhe jashtë

Kosovës. Gjatë kësaj kohe u njoftova edhe shumë sportistë e sportiste që, përveçse i kam miq të mirë, ata ma bëjnë punën më të lehtë dhe më të dashur. Mbështetje të pandërprerë kisha edhe nga shoku i fakultetit, Mal Qorraj, që vetëm gjumin e kishim në mes. Bashkëpunim të shkëlqyeshëm kishim edhe me kryeredaktorin e atëhershëm Burim Etemaj, me redaktorin përgjegjës Xhevdet Fetahajn, me redaktorin gjuhësor Berat Dakaj, më të cilin shpeshherë kemi mosmarrëveshje për rregullat e gjuhës shqipe. E të pazëvendësueshëm ishin edhe Jetliri, Muhameti, Fatoni, Albulena, Shqipja, Liria, Lulëzimi, Afeti, Artoni, Agimi, Ahmeti, Nita, Qëndresa, Ikbballja, Arsimi, Minirja, Arjeta, Lirimi, Meti, Qëndresa (Mustafa), Albani, Dritoni, Zymeri, Agnesa, Arjeta, Zana, Arbisa, Besarti, Saranda, Donika, Mentori. Ndërsa për këto vite pata fatin që njoftova dhe punova me personin që nuk shitet dhe nuk blihet për asnjë çmim, redaktorin e faqesjes, Shkëmbim Krasniqin. “Daja” është shpirti i “Epokës...”



Lirim Geci: “Epokën e re” e konsideroj si shtëpinë e dytë

Gazetën “Epoka e re” gjatë studimeve e kam lexuar shpesh, pothuajse çdo ditë, por kurrë nuk më ka shkuar në mendje se një ditë do të punoj në të si gazetar edhe për shkak të profilit tjetër studimor. Por, ishte një bisedë miqësore me botuesin Muhamet Mavraj, të cilin personalisht e njoha gjatë studimeve, nga i cili m’u dha mundësia të jem pjesë e “Epokës së re”. Si sot më kujtohet biseda e fillimprillit 2009 që kishim me Mavrajn, e që aty i pranishëm ishte edhe Muhamet Koci, i cili më kishte thënë: “Nga nesër mund t’ia filloni punën në gazetë. Dhe mos u shqetësoni për profilin e studimeve, sepse disa gazetarë që punojnë në ‘Epokë...’ janë më të mirë edhe pse nuk kanë studiuar për gazetari”. Pas kësaj bisede dhe mundësie të ofruar, pas disa ditësh vendosa të shkoj në “Epokë...”. Kështu filloi gjithçka në rrugëtimin tim në gazetari. Në ditët e para puna ishte mjaft sfiduese dhe stresuese, por me kalimin e kohës gjithçka ndryshoi falë bashkëpunimit dhe korrektësisë me stafin redaktorial e kolegët gazetarë, të cilëve u jam

shumë falënderues. Gjatë punës si gazetar, por edhe si gazetë kemi kaluar shumë sfida, por bashkërisht kemi arritur t’i përballojmë të gjitha. Pa dashur të lëshohem shumë në profesionin e gazetarit, për shkak se këtë më së miri e kuptojnë kolegët e kësaj fushe, “Epokën e re” e konsideroj shtëpinë e dytë, nga e cila kam mësuar shumë si në aspektin profesional, po ashtu edhe në atë jetësor. Falë mundësisë që më është dhënë nga Mavraj dhe “Epoka e re”, kam krijuar shumë miq, e po besoj shumë pak “armiq”. Natyrisht gjatë punës time mund të kem bërë edhe gabime, por asnjëherë me ndonjë qëllim të caktuar. Në këtë drejtim çdoherë jam munduar të jem sa më korrekt dhe objektiv. Objektiviteti dhe korrektësia më të gjithë, pa dallim, ka qenë dhe mbetet politika redaktuese e “Epokës së re”. Duke i dëshiruar shumë suksese në 20-vjetorin dhe numrin e 6 000-të, uroj që “Epoka e re” t’i rezistojë çdo furtune dhe të vazhdojë të jetë profesionale dhe korrekte sikurse sot. Gëzuar dhe suksese!



Muhamet Koci: “Epoka...”, është shkollë e gazetarisë për mua

Rrugëtimi i gazetës “Epoka e re” në dekadën e fundit ka qenë rrugëtim edhe i jetës time. Prej prillit të vitit 2009, kur mua dhe Lirimit (Gecit), botuesi i kësaj gazete, Muhamet Mavraj, na i hapi dyert e “Epokës së re”, ky institucion për mua ka përfaqësuar shtëpinë e dytë. “Epoka e re”, sikurse dhjetëra gazetarëve të tjerë, më shërbeu edhe si shkollë gazetarie. Këtu mësova hapat e gazetarisë dhe u ngrita profesionalisht, sepse studimet i kisha përfunduar nga fusha e shkencave politike. Në këtë 20-vjetor të “Epokës” kam dy falënderime. Së pari, faleminderit botuesit Muhamet Mavraj për mundësinë dhe besimin. Ai është sebeb kryesor që i kam hyrë këtij profesioni sfidues dhe që vazhdoj të jem ende pjesë e kësaj medie të madhe. Së dyti, faleminderit ish-kolegëve dhe kolegëve të redaksisë për bashkëpunimin. Me ta për këto 11 vjet kemi kaluar momente për të cilat mund të shkruhen libra, kemi analizuar çdo ngjarje vendore dhe ndërkombëtare, kemi qarë

hallet e kemi qeshur, jemi dashur e urreyer, kemi debatuar fort e kemi kritikuar, por përherë ditën e nesërme kemi qenë sërish kolegë dhe shokë. “Epokë”, gëzuar numrin e 6000-të dhe ditëlindjen e 20-të.



Faton Dërmaku: Me “Epokën e re” jam ngritur profesionalisht

20 vjet dhe 6 000 numra nuk janë pak. “Epoka e re” është një gazetë e cila deri në këto vite e këta numra asnjëherë nuk u thye dhe nuk u zmbrops nga qëllimi i saj: që të drejtës t’i shkojë deri në fund. Nga dhjetori 2007 punoj në familjen “Epoka e re”. E quaj familje sepse kohën më të madhe e kaloj në ambientet e gazetës. “Epoka e re” për këto vite rrugëtim tregoj se është e pathyeshme. Dhe ja sot, feston 20-vjetorin. Për këto vite që jam pjesë e “Epokës” kam bërë shumë miq e shokë. Jam ngritur profesionalisht. Një falënderim special që ma dha mundësinë që unë të jem pjesë e kësaj familje shkollë për pronarin dhe botuesin Muhamet Mavraj, pastaj drejtorin Sadik Zeqiri, kryeredaktorin dhe shokun Mal Qorraj, dhe gjithë kolegët e tjerë që më kanë përkrahur deri më tani.

Dua ta përmend edhe një gjë, ardhjen time në “Epoka e re” e ka mundësuar një njeri me vlera të mëdha kombëtare, i cili sot nuk është në mesin tonë. Ai është Shasivar Makolli. Ai më tha: “Faton, nëse do të arrish diçka në jetë dhe të jesh i vlerësuar nga të tjerët, shko te Muhamet Mavraj dhe ushtroje profesionin e gazetarit”. Në 20-vjetorin e gazetës merita kanë të gjithë punonjësit të cilët me punën e tyre i kanë dhënë frymë “Epokës...” dhe sigurisht meritën më të madhe e kanë lexuesit, të cilët ende janë fanatikë të gazetës sonë. Përpjekjet dhe puna e palodhshme e të gjithë punëtorëve ka kaluar nëpër shumë vështirësi, mirëpo gjithmonë kemi dalë fitues. I nderuar z. Mavraj, vlerësoj gjithçka që ju jeni duke bërë për t’i përparuar planet dhe detyrat tona në gazetë. Ju uroj sinqerisht shëndet të mirë, mirëqenie dhe shpirt të mirë për shumë vite me shpresën e bashkëpunimit të mëtejshëm e të frytshëm.



Albulena Mavraj: Me shtypin u rrita, duke pasur çdo ditë në shtëpi gazetën “Epoka e re”

Me shtypin u rrita, duke pasur çdo ditë në shtëpi gazetën “Epoka e re”, por edhe gazetën e tjera. Shpesh mendoj se, duke qenë e rrethuar nga to, që në vegjëli, ma imponuan të bëhem gazetarë dhe ta dua erën e shtypit. Mirëpo, në atë kohë gazetën e shfletova nga fundi, nga fjalëkryqi, të cilin shpesh e plotësonim me rahmetlin, gjyshin tim. Duke u rritur dhe duke shfletuar gazetën mbarë, duke lexuar në vazhdimësi padrejtësi që i ishin bërë dhe vazhdonin t’i bëheshin kombit time, duke lexuar tentim denigrimesh të vlerave kombëtare dhe kacafytjet e “Epokës së re”, për t’i mbrojtur ato vlera, mendoja se një ditë a thua a do të mund që me anë të shkrimeve të mia edhe unë t’u dal ballë padrejtësive? Por, meqë problemet shoqërore në kohë tranzicioni ishin të shumta, padrejtësitë shekullore edhe më të mëdha, mendoja se jam ende e re dhe duhet të lexoj edhe më shumë për të studiuar dhe për t’u bërë gazetarë. Prandaj, kur erdhi koha për studime unë u regjistrova në një drejtim krejtësisht tjetër nga gazetaria dhe të cilin iu përkushtova me zellin më të madh. Porse “Epoka...” sërish ishte e pashmangshme. Baras me literaturën për provime lexoja lajmet ditore në rubrikën e ekonomisë, lexoja analiza dhe opinione, që ma forconin bindjen se duhet të regjistrohem edhe në Fakultetin e Filologjisë – Degën Gazetari. Dhe sa herë kaloja pranë objektit të Filologjisë më dukej sikurse kam diçka në atë objekt dhe një karrige e studentes është diku për mua. Kështu që, fillova ta studioj gazetarinë dhe në “Epokë...”, fillimisht vendosa që të shkoj në “Epokë...”, por vetëm për 2 apo 3 muaj, sa për të përfunduar një praktikë, meqë isha e gërshtuar edhe me profesionin e ekonomisë. Më thoshin “që në gazetari hyn, por më s’mund të dalësh. S’ka gjë më nga gazetari, teknologjia e ka bërë të vetën etj”. E kisha madje edhe një precedent të tillë në familje, që gazetaria ia devijoi rrugën nga studimet e para që në të ardhmen do t’ia ofronin një

profesion fitimprurës, porse duke u marrë me gazetari dhe preokupimet shoqërore, si duket do të plakët në këtë drejtim. Ndërkaq, mua në atë kohë mu kish tek që t’i besoja vetëm vetvetes dhe isha e bindur që s’do të më rrëmbej ky profesion. Por ja që “Epoka e re” ma theu atë vetëbesim dhe doli që unë isha gabim. Por unë e bëra gabimin më të mirë në jetë. U bëra gazetarë. “Epoka e re” është derë ku hyn, familjarizohesh dhe bëhet pastaj shtëpia jote. Aty të gjithë e kanë të njëjtin qëllim, informimin e drejtë, balancimin e të takuarve, mosshantazhimin e askujt, as për inate personale e as për smirë. Meqenëse unë jam më e reja e gazetës “Epoka e re” nuk më takon shumë dhe s’dua ta thyej parimin e modestisë siç e kam thyer parimin e vetëbesimit dhe të flas për vlerat, sfidat dhe sakrificën e të qenit 20 vjet në treg. Për këtë flasin MM, Sadiku, “Daja”, Mali, Vetoni e qindra të tjerë, kurse për vitet e shkuara kanë folur dhe vazhdojnë të flasin të tjerët me nostalgji sa herë përmendet emri “Epokë...”.



Arsim Osmani: “Epoka e re” u rrit dhe u zhvillua bashkë me Kosovën e pasluftës

Ishte fat dhe nder për mua që tash e 12 vjet të punoj në gazetën “Epoka e re” në rubrikën e lajmeve ndërkombëtare, në orarin e pas ditës. Me këtë rast falënderoj botuesin Muhamet Mavraj që më mundësoi një punë të dytë, si dhe stafin për bashkëpunim dhe kolegjalitet. Kur nisa punën në redaksi pashë kryesisht djem dhe vajza të reja të përkushtuar për ta bërë punën më të mirë dhe profesionale në këtë gazetë ditore, e cila i qëndroi besnike idesë për shtetin e Kosovës dhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm të saj dhe duke mbijetuar në një situatë jo shumë të përshtatshme dhe në një konkurrencë jo fer, me shumë sfida dhe peripeci. “Epoka e re”, që u rrit dhe u zhvillua bashkë me Kosovën e pasluftës, si gazetë mbarëkombëtare vazhdimisht u ka dhënë hapësirë edhe informacioneve dhe ngjarjeve me rëndësi edhe jashtë Kosovës, pra nga të gjitha trojet shqiptare, si nga Shqipëria, Lugina e Preshevës, Maqedonia Veriore, Mali i Zi, por edhe nga diaspora shqiptare. Gazeta jonë, po ashtu,

është munduar që lexuesit t'i mbajë me kohë të informuar edhe për ngjarjet më të rëndësishme nga rajoni dhe bota. Në punën time gjatë kësaj periudhe do ta veçoja përcjelljen e punimeve të seancave në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, ku diskutohej për gjendjen në Kosovë. Këto seanca zakonisht mbaheshin pas dite sipas orës lokale në Nju Jork dhe kjo na bënte që të rrinim deri në mesnatë me qëllim që lexuesit tanë të informoheshin se çfarë po ndodhte në OKB. Në fillim këto seanca dukeshin goxha interesante, por që më vonë u bënë një rutinë që nuk sillte asgjë të re dhe tashmë ishim mësuar me përplasjet mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aleatëve të saj, që ishin në mbështetje të Kosovës, dhe Rusisë e Kinës që shfaqnin të kundërtën. Ndërkaq, kohët e fundit dua të cekim përkthimin me shumë kënaqësi të analizave të ministrit të sapolëvizur të Integritetit Evropian në qeverinë "Kurti", prof. Blerim Reka, të cilat botoheshin në një forum në Bruksel, kurse unë i përktheja për nevojat e gazetës sonë. Botuesit dhe gjithë stafit të "Epokës së re" i uroj 20-vjetorin e botimit, me dëshirën që ta vazhdojë pasqyrimin objektiv të të gjitha proceseve të rëndësishme, gjithnjë në shërbim të shtetit.



Arbenita Kamberi:
"Epokës..." mos i mbarofshin sukseset kurrë!

"Epokës së re" i uroj edhe shumë numra të tjerë dhe është ndër mediat më të guximshme që i njoh unë dhe ka pasur shumë sfida të cilat i ka kaluar me shumë përkushtim dhe me paanim. I lumtë stafit dhe Muhamet Mavrajt për guximin! Është media e cila ka mësuar shumë gjenerata, dhe shpresoj që do të vazhdojë edhe më tutje. Sukseset mos i mbarofshin kurrë!



Mentor Hajrizi: Ky përvjetor shënon një ngjarje tepër të gëzuar

Gazeta "Epoka e re" as që mund të shqitet dot nga mendja jonë ani pse epokës moderne po i shtohen përditë mediat e shkruara elektronike. "Epoka e re" është lajmëtare e kohës, e ngadhënjimit dhe e lirisë së shumëpritur. Kjo gazetë mendjehollë dhe e pavarur është personifikim i zhvillimit profesional, i informimit të drejtë dhe të paanshëm. Gazeta më e lexuar dhe më e besueshme njëkohësisht "Epoka e re", lexohet pa masë nga lexuesit besnikë të saj, brenda dhe jashtë vendit. Z. Mavraj, kryeredaktorët, redaktorët dhe gazetarët e zellshëm të "Epokës..." raportojnë edhe më në përputhje me normat etike dhe të gazetarisë profesionale. Ata janë specialistë unikë të medias së shkruar, prandaj çdo sukses i arrirë u takon këtyre punëtorëve mendjendritur.

Përvjetorin XX të saj nuk e gëzon vetëm "Epoka e re", por tërë shqiptaria, e gëzojmë të gjithë ne. Ky përvjetor shënon një ngjarje tepër të gëzuar. "Epokës së re" i urojmë përherë jetëgjatësi, punë të mbarë dhe kurorëzim të sukseseve të pafundme!



Qendresa Rama:
"Epokë...", urime numrin 6 000!

Krahas studimeve një student/e ka nevojë ta ushtrojë praktikën në profesionin që studion. Unë, meqë isha studente në Universitetin AAB (Drejtimi Komunikim Masiv - Gazetari), zgjodha "Epokën e re" për të bërë praktikë. Më 3 mars 2014 kjo gazetë m'i hapi dyert që, krahas studimeve, unë ta mësoj edhe më shumë profesionin e gazetarisë përmes praktikës. Bëra mbi tre muaj praktikë në "Epokë..." dhe pastaj vazhdova studimet në AAB, por pas një kohe u ktheva sërish në "Epokën e re" si

gazetare, ku edhe sot jam pjesë e saj. Kush më shtyri që ta dua "Epokën..." si gazetë? Reklama e saj që lëshohej në RTK para lajmeve qendrore më bëri që unë ta dua këtë gazetë. Më linin përshtypje të veçantë titujt kur lexoheshin dhe mendoja që një ditë do të bëhem pjesë e stafit të gazetës dhe kjo u bë realitet. "Epoka e re" është një gazetë profesionale dhe e paanshme, e cila për këto 20 vjet u ka dhënë mundësi shumë të rinjve që t'i bëjnë hapat e parë në profesionin e gazetarisë. Ndihehem shumë e lumtur që jam pjesë e stafit të gazetës "Epoka e re". "Epokë...", urime numrin 6 000! Festofsh edhe mijëra numra të tjerë!



Imer Mushkolaj: "Epoka e re" vërtet solli frymë të re në median shqiptare

Të fillosh një gazetë të përditshme, menjëherë pas luftës, me një ekip të ri gazetarësh me pak përvojë se të papërvojë, ishte sfidë e madhe. Por, gjithçka bëhej më e lehtë sepse entuziazmi ishte i madh, ashtu si dhe dëshira për të sjellë diçka të re në tregun medial kosovar. Nuk kam se si të mos i kujtoj netët e gjata në redaksi, në fillimet e gazetës, kur çdo shkronjë, çdo fjalë, çdo fotografi trajtohej me dashuri. Ndodhte që një pjesë e ekipit edhe të flinin në redaksi, sepse një gazetë e re po lindte, një dritare e re informimi po hapej. Me kalimin e kohës jo rastësisht "Epoka e re" mori epitetin e gazetës më të guximshme shqiptare ngaqë trajtonte tema që deri atëherë nuk ishin trajtuar ose ishin trajtuar fare pak. "Epoka e re" ishte e drejtpërdrejtë, por edhe platformë për mendimin e të gjitha palëve.

Për mua ishte privilegj që të jem në grupin nismëtar të gazetës. Ishte mundësi jashtëzakonisht e madhe për mua, që në moshë të re, si një 22-vjeçar, të bëhesha kryeredaktor i një gazete. Besoj kryeredaktori më i ri në moshë i një të përditshmeje. "Epoka e re" ishte shkollë gazetarie për dhjetëra, qindra studentë gazetarie e gazetarë të rinj, që patën mundësi të punojnë në një ekip të ri e të shëndoshë, përtej paragjykimëve të çfarëdo lloji. Vitet e kaluara në "Epokën e re" mbeten vitet më të dashura, të mbushura plot sfida, punë e

angazhim, por edhe kënaqësi. Mbeten vite të përpjekjeve për ta nxjerrë të vërtetën në sipërfaqe, për ta thënë atë që duhej thënë, pa censurë e pa frikë.

"Epoka e re" vërtet solli frymë të re në median shqiptare si për nga mënyra e raportimit, ashtu edhe për nga ndjekja e trendëve të rinj të të bërit gazetari. Pavarësisht prej shumë sfidave, "Epoka e re" vazhdon tutje. I uroj edhe shumë vjet në treg, ndërkaq nuk dyshoj se do të mbetet përgjithmonë në mbamendjen e atyre që ua ka dhënë rastin t'i futen zanatit të gazetarisë dhe të dhjetëra mijëra të tjerëve që ia kanë falur dhe vazhdojnë t'ia falin besimin duke e lexuar çdo ditë.



Driton Lajçi, një ndër udhëheqësit e Lëvizjes Studentore 1997/99: "Bota e re" e "Epokës së re"

Të shkruash për 20-vjetorin e "Epokës së re" duhet filluar me "Botën e re" të vitit 1996/97/98 kur u bënë ndryshimet e politikave redaktuese. Kjo ishte koha kur ndërtoheshin hapat ndër më domethënës të përpjekjeve tona për liri, universitet të lirë dhe çlirim nga okupimi. Nga këtu e tutje "Bota e re" në krye me gazetarin legjendar, kryeredaktorin Z. Muhamet Mavraj (siç e quan miku ynë i përbashkët Ismet Sylejmani), bëri hapa gjigantë në shërbim të çlirimit të fjalës së lirë shqiptare dhe ishte pjesë e aktiviteteve të përbashkëta për organizmin e protestave studentore të 1 tetorit 1997 dhe të tjerave në vijim në vitin 1998. Pas çlirimit "Bota e re" mbetet e studentëve të Universitetit të Prishtinës për të vazhduar me "Epokën e re" e cila lindi në zyrat e Qendrës së Studentëve të UPS-së. Nga "Bota e re" e brezit të studentëve të guximshëm ajo e merr rolin e guximshmja shqiptare, duke trajtuar tema të cilat ishin në shërbim të fjalës së lirë dhe tema të guximshme sidomos nga fusha e drejtësisë, aktualiteti politik dhe nga shpallja e pavarësisë. Andaj ju uroj që këtë 20-vjetor ta festoni më ballëhapur. Ky jubile ka d o m e t h ë n i e shumë dimensionale. Po ashtu, bëj apel që, pavarësisht prej ndryshimeve globale në fushën e medieve, "Epoka e re" të vazhdojë

ta luajë rolin e vet cilësor në shërbim të lexuesve dhe opinionit publik.



Arsim Sinani: "Epoka e re", një brez me doktrinë shqiptare

Muhamet Mavrajn e kam shok nga koha kur ai bashkë me shokët e tjerë e drejtonin Lëvizjen Studentore të Kosovës e që njihet me emrin UPSUP, e cila luajti një rol kyç në atë që sot e quajmë Republika e Kosovës. Nga ajo ditë nuk jemi ndarë as me Mavrajn, as me shokët e Lëvizjes Studentore. T'i kthehem "Epokës së re" që, për mendimin tim, në gazetarinë shqiptare do të mbahet mend për kundërshtimin e hapur që ia bëri administratës së UNMIKU-ut e cila na lodhi me paqartësinë e saj vite më parë. Si gazetar fillimisht, pastaj edhe si redaktor, përpjekjet tona kanë qenë që ta sjellim të vërtetën para publikut dhe për t'i nxitur proceset që ndodhën si lumë më pastaj. Shpesh kryeneçësia e gazetës "Epoka e re" është keqkuptuar nga publiku, por e vërteta është se pa rolin tonë Kosova nuk do të mund të ecte para.

Në çdo proces "Epoka e re" ka kryer detyrën kryesore që është informimi, por edhe komentimi i ngjarjeve dhe zhvillimeve, duke i vënë në situatë të vështirë politikanët dhe aktorët e politikës në Kosovë. Por, qëllimi i këtij brezi duhet të kuptohet drejt se jemi brez i cili kurrë nuk ka bërë kompromise në dem të vendit të vet, pavarësisht nga kërcënimet dhe nga situatat e turbullta që i kaluan dhe kalojnë shqiptarët. S'do mend se për këshërinë e lexuesit duhet thënë edhe ndonjë detaj interesant që publiku nuk i di prapaskanat e asaj që ndodhte jashtë rreshtave të gazetës, sepse jo gjithmonë dalin në gazetë të gjitha. Në një intervistë që po e zhvilloja me Ombudspersonin Novicki, në pyetjen time se Han Hekerupi ish-kryeadministrator i Kosovës, a i shkel të drejtat e njeriut në Kosovë duke e demonizuar UÇK-në? Ai, Novicki, u përgjig me "po, se i shkel të drejtat e njeriut". Ndërsa kolegu im, Burim Etemaj, duke marrë shtytje nga përgjigja pozitive, ia parashtrroi sërish pyetjen dhe ai u përgjig "jo". Për fatin e mirë, incizimin e kisha ruajtur dhe Novicki u hidhërua me mua pasi që titullin ia nxorëm

me përgjigjen po dhe jo, por e vërteta është se titulli ishte qasja e ndërkombëtarëve ndaj demonizimit të luftës sonë për çlirim nga zgjedha serbe.

Në raste të tilla shkruhen dhe rikujtohen gjëra interesante që nuk janë thënë në gazetë. Po e kujtoj një intervistë timen me Koço Danajn dhe titullin 'Maqedonia do të ndahet', e cila doli me dy pjesë e që i shqetësoi ambasadat dhe u bë një rrëmujë e madhe derisa reagoi asokohe Vuk Drashkoviqi si ministër i Jashtëm i asaj Jugosllavisë së mbetur dhe deri tek implikimi me Qeverinë e Shqipërisë që asokohe ishte Sali e Berisha, duke ngatërruar Danajn si këshilltar të Qeverisë e që ishte një pështjellim i kohës. E vërteta ishte se titulli e kishim nxjerrë nga konteksti, për të mbajtur hapur një çështje që edhe sot mbetet e pazgjidhur, shqiptarët e Maqedonisë sot të veriut nuk e meritojnë këtë gjendje që është e imponuar nga maqedonasit dhe nga ndërkombëtarët që po na flijojnë për interesa gjeostrategjike.

Dhe, së fundmi, them se brezi i "Epokës së re" mbetet një përpjekje e vazhduar për fjalën e lirë, paçka se pak e dinë se cilat janë rreziqet e gazetarëve përballë politikanëve, të cilët shpesh dinë të përpiqen ta përvetësojnë dhe betonizojnë, se vetëm ata kanë të drejtë në mendimin e tyre, që në rastin e "Epokës..." është parë se gazetari di ta dridhë opinionin me të vërtetën e cila shumë i duhet shoqërisë shqiptare gjithandej. Gëzuar!



Lulëzim Etemaj: Guximi dhe profesionalizmi ishin e gjithë pasuria e "Epokës së re"

Gazeta "Epoka e re", e themeluar nga një prej liderëve kryesor të Lëvizjes Studentore në Kosovë, njëherësh kryeredaktor i fundit i gazetës studentore të luftës, "Bota e re", Muhamet Mavraj, e kishte që në fillim të qartë misionin e vet si në rrafshin profesional, ashtu edhe në atë qytetar e kombëtar. Guximi dhe profesionalizmi, këto ishin e gjithë pasuria e saj. Fatkeqësisht, pikërisht këto të dyja, do t'ia parashkruanin edhe ecjen dhe rritjen tepër të vështirë. Prandaj, përpjekjet për t'ia thyer dhe

ndërprerë ecjen dhe mbijetesën, jo vetëm ekonomikisht, kanë qenë të pareshtura dhe shumë të egra, që nga numri i parë. Ato kanë ardhur nga të gjitha anët. Jo vetëm nga ata që pritej. Jo vetëm nga penguesit dhe kundërshtarët e llojllojshëm të çlirimit dhe lirisë së Kosovës dhe bartëses së tyre kryesore - Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Themeluesi i "Epokës së re", në radhë të parë, por edhe kryeredaktorët, redaktorët, stafi i saj i ngushtë dhe gazetarët, duke e kuptuar të qenit në shërbim të qytetarëve dhe mbrojtjes së vlerave të luftës, lirisë, shtetbërjes, shtetndërtimit dhe demokracisë, i mbijetuan të gjitha.

Tani gazeta "Epoka e re" është bërë 20 vjeçe.

Sot e boton numrin e 6000-të! Ka mbetur e re. Vazhdon të mbetet e guximshme. Gazeta më e guximshme shqiptare! Të tjerat, një mori e tyre, të hapura me porosi, jo për t'i shërbyer gazetarisë së lirë, por për ta goditur pikërisht atë, duke e goditur "Epokën e re", ka kohë që nuk frymojnë më.

Uroj që "Epoka e re" t'i përballojë edhe më tej me sukses sfidat e shumta që ka para vetes!

Vazhdoj të ndihem i privilegjuar për vitet sa isha kryeredaktor i saj, njëkohësisht të bashkëfrymtoj me të, jo vetëm në ditë suksesi apo feste!

Urime të gjithë stafit! Të gjithë atyre që ishin pjesë e saj gjatë këtyre dy dekadave! Lexuesve të saj besnikë. Posaçërisht ish-ushtarëve të lirisë!

Urim të posaçëm për botuesin, Muhamet Mavraj, robin e papërmirësueshëm të bindjeve, vizionit, guximit, jo vetëm në shërbim të lirisë së shtypit, por edhe të Kosovës dhe kombit. Në shërbim të Shqipërisë që pret të bëhet.



Xhevdet Fetahaj: "Epoka e re", e vetmja gazete shqiptare dhe shkollë e gazetarisë

Duke qenë pjesë e gazetës "Epoka e re" për gati dy dekada kam përjetuar të qenit pjesë e një familje të madhe me anëtarë nga vise të ndryshme të trojeve shqiptare.

Familja "Epoka e re" është përballur me shume sfida, por qëndrimi në kauzën e drejtë

kombëtare i ka përballuar të gjitha ato. "Epoka e re" është luftuar në të gjitha format e ndryshme vetëm që të mbyllej, por askush dhe asgjë nuk ia ka arritur qëllimit.

Mbaj mend sa e sa gazeta është hapur, jo si konkurrenca mediale, por si një luginë hienash për ta mposhtur gazetën tonë. Përkushtimi ndaj fjalës së lirë ka mposhtur të gjithë ata dashakëqij që familjen "Epoka e re" e donin të shkapërderdhur dhe të shuar njëkohësisht.

Ishte këmbëngulja e botuesit Muhamet Mavraj që këtë familje ta mbante në këmbë. Ai e dinte që "Epoka..." e cila ka bërë epokë pas luftës në Kosovë, do të mbijetonte dhe ja ku është sot: e vetme, pa ndihmën e askujt, feston 20-vjetorin e themelimit dhe plot 6 000 numra të botuar. Meritore për çdo lindje të nesërme (numër të ri të gazetës) ishim të gjithë, por më të dalluarit ishin botuesi Muhamet Mavraj, drejtori Sadik Zeqiri dhe shtylla kryesore e "Epokës...", redaktori teknik Shkëmbim Krasniqi.

Jam krenar që isha pjesë e kësaj familje që shkruan shqip, mendon shqip, frymon shqip dhe do çdo gjë shqiptare. Po ashtu, jam krenar që isha pjesë e kësaj familje, e cila ishte shkolla e vetme e gazetarisë nga e cila kanë dalë kryeredaktorë televizionesh, gazetash e portalesh, redaktorë të çdo lloji mediami, profesorë fakultetesh e shkollash të mesme, zëdhënës të institucioneve shtetërore e private. Ishte "Epoka..." kjo familje e madhe që i mbajti afër derisa u bënë të zotët që të ecin në këmbët e tyre. Gëzuar numri i 6000-të dhe 20-vjetori i "Epokës së re"! Pastë jetë të gjatë familja "Epoka e re"!



Burim Etemaj: "Epoka e re", pavarësisht prej sfidave, ka mbetur e njëjta: e re, e guximshme dhe profesionale, shkollë e gazetarisë!

Gazeta e përditshme "Epoka e re" sot botoi numrin e 6000-të. Super!

Si shumë djem dhe vajza të tjerë, edhe unë në "Epokë..." jam rritur edhe në moshë, edhe në profesionin e gazetarit. Jam pjekur, me kalimin e kohës, edhe në detyrën e redaktorit. Jam sfiduar qindra herë si dhe aty

kanë filluar të më zbardhen ngadalë flokët si kryeredaktor.

Në kushte të jashtëzakonshme, pa donacione, në mungesë edhe të kompjuterëve të mjaftueshëm, pa u shitur asnjëherë, pa u shantazhuar, "Epoka..." ka bërë e po bën gazetari të guximshme, para së gjithash profesionale.

"Epoka e re" me tërë qenien e ka mbrojtur dje kauzën e drejtë të popullit shqiptar të Kosovës për shtetformim. Sot po kontribuon për zhvillimin e shtetit dhe demokracisë.

"Epoka e re" përgjatë këtyre 20 vjetëve ka raportuar për krimet mbi popullsinë civile shqiptare të kryera nga forcat serbe gjatë luftës, ka mbrojtur luftën e drejtë çlirimtare, dhjetëra ushtarë të UÇK-së, duke nxjerrë në shesh montimet gjyqësore të UNMIK-ut e të EULEX-it, në bashkëpunim me disa shqipfolës që, si shpërblim për ta degraduar luftën çlirimtare, përveç të hollave të majme, zgjidhnin në hartë vendet evropiane për të jetuar; ka raportuar për raste të krimit e të korrupsionit; ka raportuar ndër të parat edhe për vëhabizmin dhe pasojat që do t'ia sjellë ai Kosovës në sy të ndërkombëtarëve; ka raportuar edhe për procesin negociator në Vjenë; edhe për marrjen e majme të mëditjeve nga të gjithë anëtarët e Grupit të Unitetit të Kosovës. Dhe, para se gjithash, pavarësisht prej presionit ndërkombëtar, me "urdhër të arsyeohej" botuesi Muhamet Mavraj, ka botuar ekskluzivisht Planin e Ahtisarit, mbi bazën e të cilit, më 17 shkurt 2008, Kosova është shpallur shtet i pavarur dhe sovran.

"Epoka e re", pavarësisht prej sfidave të shumta, përfshirë edhe ato të kohës, ka mbetur e njëjta: e re, e guximshme dhe profesionale, shkollë e gazetarisë! Dhe, pa fije dyshimi: meritat për këtë u takojnë lexuesve besnikë, botuesit Muhamet Mavraj dhe të gjithë atyre që ishin dhe janë pjesë e saj.

"Epokë...", gëzuar!



Ilir Kabashi: "Epoka e re" nuk bënte llogari për veten

Sot, 20 vjet më pas, prej fillimit të punës së gazetës së përditshme "Epoka e re", mbaj mend kur na bashkoi Muhamet Mavraj, një grup të rinjsh dhe të rejash.

Fillimisht ishim kryesisht ish-gazetarë të gazetës së studentëve "Bota e re". Z. Muhamet Mavraj (botues i "Epokës së re") ishte shumë entuziast, si gjithmonë në atë që donte ta bënte, por unë personalisht s'kam besuar se "Epoka e re" do t'i lidhte epokat dhe do të bëhej zë i veçantë i atyre që s'kishin zë. Ngase, përveç kushteve të rënda, "Epoka e re" nuk bënte llogari për veten. Edhe atëherë kur kjo gjë e ballafaqonte pa pardon me të tjerët.

Shumica nga ne ishim beqarë dhe gazeta "Epoka e re", përveçse vend pune, u bë edhe shtëpia jonë e dytë. Për tri vjet me radhë sa isha pjesë e kësaj gazete e kam njohur më mirë vendin tim. I kam njohur më mirë hallet, problemet dhe ëndrrat e popullit tim. Të gjithëve na ka pjekur më shumë për jetën kjo gazetë. Me kohë kjo gazetë u bë një lloj shkolle e gazetarisë. Gazetarët e saj që raportet, kronikat dhe shkrimet e para si gazetarë i kishin bërë në "Epokën e re", sot janë gjithandej medimeve dhe institucioneve më larta të Kosovës në pozita të ndryshme. Unë ruaj, pos shumë kujtimeve të përditshme, si kujtim të mirë edhe një shpërblim nga kjo gazetë për 'Intervistën e Vitit' të bërë atëbotë me ish-shefin e Zyrës Gjermane, Michael Shmuck, bashkë me kolegun Seman Shala.

Për këtë jubile të çmuar një falënderim i veçantë shkon për miqtë e mi, Muhamet Mavraj, botues, Shkëmbim Krasniqi, drejtor teknik dhe Sadik Zeqiri, drejtor, pa harruar këtu të gjithë gazetarët që kam punuar me ta dhe lexuesit besnikë.

Urime!



Ramize Murtezi-Shala: Ndihej e lumtur që isha pjesë e "Epokës së re"

Shumë urime 20-vjetori i gazetës! Ndihej shumë e lumtur që për një kohe isha pjesë e saj, madje aty nisa hapat e parë të gazetarisë. Gjithkund me krenari flas për atë kohë se si me dashuri të madhe kemi punuar për të dalë në dritë diçka e mirë. Uroj shumë që kurrë të mos ketë fatin e disa gazetave të tjera! Urime!



Shqipe Hetemi: "Epoka e re" për më shumë se 12 vjet ishte shtëpia ime e dytë

Dy dekada jetë, me probleme e vështirësi, por e pandalshme. Kjo është gazeta "Epoka e re" që, për më shumë se 12 vjet, ishte shtëpia ime e dytë. Vetëm ne që kemi qenë pjesë e saj dhe disa të tjerë që vazhdojnë ta mbajnë gjallë e dinë se sa sfiduese është përgatitja e secilit numër, çdo ditë dhe mbijetesa në tregun medial në Kosovë. Me të mirat dhe të këqijat e saj, pa "Epokën" unë nuk do të isha këtu ku jam. Prandaj, faleminderit për vitet që i kaluam së bashku! Gëzuar 20-vjetori! Qofshim krenarë për rrugëtimin e mëtutjeshëm të gazetës tonë!



Afet Bela: Sa isha në "Epokën e re" kujtoj vetëm çaste të mira

Këtë vit gazeta "Epoka e re" po shënon 20-vjetorin e daljes në treg dhe numrin e 6000 të gazetës. 'Epoka e re' për këto vite ka qenë zë dhe sinonim i fjalës së lirë për shoqërinë kosovare, por pa dyshim si pasqyrë e rëndësishme për vlerat e luftës që shpeshherë ishin në tendencë të njollosjes nga aktorë të ndryshëm. Unë në "Epoka e re, isha gati një dekadë gazetar dhe për ato vite sa isha aty kujtoj vetëm çaste të mira të bashkëpunimit me të gjithë. Sa isha gazetar në gazetën "Epoka e re" pata mundësinë të isha pjesëmarrës në shumë vende si në Kosovë ashtu edhe jashtë. Po ashtu, vlen të ceket se gjatë kohës sa isha gazetar në gazetën "Epoka e re", isha fitues i Fellowship të Fondacionit Thomson Reuters nga Anglia dhe Robert Bosch Stiftung nga Gjermania në programin për gazetarë të Evropës Juglindore. Dua t'i falënderoj të gjithë ata që pata bashkëpunim, në veçanti botuesin e gazetës "Epoka e re",

Muhamet Mavraj, për përkrahjen. Uroj 20-vjetorin e daljes në treg dhe numrin e 6000-të të gazetës, me dëshirën që të vazhdojë të botohet edhe në të ardhmen, si dhe të zhvillohet edhe më shumë.



Lirije Klaiqi: Një dekadë në "Epoka e re"

Një dekadë jetë e kam kaluar në "Epoka e re". Kam pasur fatin të punoj në atë redaksi e rrethuar me shumë kolegë profesionistë dhe me vlera njerëzore. "Epoka" për mua mbetet shkolla e vërtetë në të cilën i mësova mjeshtritë e zanatit. I mbaj mend të gjitha momentet prej ditës së parë e deri tek e fundit. Shumë punë, sfida, stres, ditë të rënda, por e rrethuar me kolegë që çdo gjë e bënin më të lehtë. Pa mëdyshje mund të them se në atë ambient kam përjetuar ngrohtësinë si në familje.

Muhameti, Shqipja, Sadiku, Koci, Mali e shumë të tjerë vazhdojnë të mbeten në rrethin e miqve më të mirë që kam. Jam rritur edhe vetë me "Epokën". Kam nisur punën shumë e re dhe aty kam mësuar shumë për gazetarinë dhe për jetën. Jetë të gjatë "Epokës..." së shumë epokave!



Ahmet Bilalli: Të tjerat ndalen, "Epoka e re" vazhdon

Rrugëtimi im me "Epokën e re" nisi që nga dhjetori i vitit 1999, kur së bashku me ideatorin dhe botuesin, Muhamet Mavraj, me shumë shokë e shoqe nisëm misionin e vështirë për ta nxjerrë një gazetë ditore, që qëllimi parësor ishte informimi i drejtë dhe pa anime. Në bisedime me shumë gazetarë të medimeve të shumta të Kosovës, thënia ime ishte: "Të gjitha gazetatat mund të mos i rezistojnë kohës, 'Epoka' nuk mbyllet, nuk ndalet". Dhe "Epoka e re" nuk do të ndalet. Tani i mbushi 20 vjet jetë dhe si ish-redaktor, uroj që "Epoka e re"

të festojë edhe shumë numra jubilarë. Gëzuar!



Lulzim Sahiti, korrespondent nga Shtimja: "Epoka e re", pikë referimi për gazetarinë e Kosovës

Gazeta e përditshme "Epoka e re" që nga fillimet e saj është bërë një pikë referimi për gazetarinë në Kosovë në veçanti, për atë shqiptare në përgjithësi. Në të dhe për të kanë shkruar një numër i madh gazetarësh me emër të Kosovës dhe një pjesë syresh vijojnë të shkruajnë. Së këndejmi, ajo, krahas lajmeve të përditshme që sjellë për opinionin e gjerë, është edhe një dritare e fuqishme për mbrojtjen dhe kultivimin e vlerave të luftës sonë të lavdishme. Përndryshe, mund të themi lirisht se gazeta "Epoka e re" gjatë këtyre njëzet vjetëve të veprimtarisë së saj ka qenë një shkollë e gazetarisë së shkruar, e cila ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm për hapërimin e shumë gazetarëve të rinj, të cilët sot kanë bërë emër në medime të ndryshme vendore dhe të huaja.



Gazmend Morina: Për mua "Epoka e re" ishte shumë më shumë se punë

Për mua "Epoka e re" ishte shumë më shumë se punë, ishte mundësia që më është dhënë për fillimin e karrierës në media. Asokohe si student ishte kënaqësi dhe përgjegjësi të punoja në "Epoka e re", nga e cila, në fakt, shpeshherë jam frymëzuar për proceset politike nëpër të cilat po kalonte Kosova, sidomos për demaskimin e rolit të UNMIK-ut. Kur e shoh që edhe sot, mbi 20 vjet pas luftës, "Epoka e re" po arrin të qëndrojë në tregun kosovar si medium i pavarur, kjo më bën të ndihem

jashtëzakonisht mirë. Suksese stafit të "Epokës së re"!



Agim Muhaxheri: "Epoka e re" dhe unë...

Vjeshtë 2002. Pa fajin tim e ndërpres bashkëpunimin në gazetën "24 orë". Kryeredaktori i kësaj gazete, Rasimi (Selmanaj), ma ulë pagën nga 400 në 350 euro. Këtu i them: Natën e mirë, nxirre gazetën pa mue...

Të nesërmen e takoj në zyrë botuesin e gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj. Pasi merr vesh ajo çfarë më ka ndodhur më drejtohet:

- Agim, nisja punës në gazetën time.

Nga ajo ditë këtu punoj deri më 2008.

Mavrajt i kisha thënë: - Më duhet ta gjej një banesë me qira që të mos vonohem në punë...

- Jo more pse të shpenzohesh, e ke zyrën time, këtu e bën gjumin. Ashtu edhe ndodhi. Unë, bos, bëja gjumin në zyrën e shefit... kushtet e banimit ishin ideale, kolltukët, televizori, frigoriferi...

Gjithashtu, Mavraj më luti që t'i ndihmoja redaktorit teknik Shkëmbim Krasniqi - "Dajës" në radhitjen e faqeve. Të kem kujdes në titujt e shkrimeve...

Në një rast, te kthina e "Dajës", ngjit me dhomën e gazetarëve, vjen Mavraj të interesohet për komentin e vet autorial.

"Dajës" i them:

E ke paralajmëruar në faqen e parë komentin e shefit?

Po, shef, më tha mue.

Ku është fotografia e Mavrajt.

Nuk ka fotografi.

Komenti pa fotografi s'del, i them. Nxirre fotografinë e tij menjëherë.

- Jo bre Agim, ndërhy Mavraj.

Unë vetna këtu, i them.

Muhameti ia plasi gazit, ra barkas...

Komenti doli me fotografinë e tij...

"Epoka...", kjo gazetë zeher, bënte përpjekje të jetë e para. Gazetarët e kapnin lajmin 'në ajër'...

Raportoj për një proces të ndjeshëm, dy orë para mesnate. Kryeredaktorit i them: - Ma lë vendin në gazetë, tash vij e bëj shkrimin...

Të nesërmen, për atë ngjarje, gazetarja e "Kohës ditore" vajti te zyra e avokatit Nikë Shala që t'i marrë të dhënat. Ky i thotë: Atë çfarë po kërkon e ka publikuar "Epoka...". Ajo ofshantë: - Eu ç'na paska kall Agimi!



Nebi Behluli: "Epoka e re" la gjurmë në gazetarinë e shkruar në Kosovë

Krenar që isha pjesë e një epoke, që kontribuoi në procese dhe la gjurmë në gazetarinë e shkruar në Kosovë. Gazeta që shquhej për guxim dhe profesionalizëm. "Epoka e re" ishte shkollë e gazetarisë për të gjithë ne! Urime përvjetori i 20-të. Respekt për stafin e "Epokës..." dhe botuesin e nderuar Muhamet Mavraj.



Arsim Lani, redaktor në T7: "Epoka e re" ishte një ambient familjar i punës

E mbaj mend si sot ditën e parë të punës në gazetën që ishte e vetmja që ua hapte dyert dhe ua jepte mundësinë gazetarëve të rinj. Unë isha një nga ta. Që në ditën e parë kryeredaktori Imer Mushkolaj më angazhoi gazetar. Të nesërmen teksti që kisha shkruar doli kryesori në gazetë. Atëherë nuk ia kam ditur peshën sa ia di sot këtij vlerësimi që iu bë një artikulli të një gazetari fillestar. Ishte një ambient familjar i punës, me kushte jo shumë të mira, por me një dashuri për punën dhe për "Epokën".

Në atë kohë (2003) ambienti i të bërit gazetar nuk ishte aq i sigurt, por ka qenë një vullnet, përtej frikës, që na ka motivuar për punë. Slogani "Epoka e re - gazeta më e guximshme", sikur na jepte edhe më shumë kurajë, ndjenjë kjo që ka përcjellë "Epokën" edhe pasi jam larguar. Uroj që guximi dhe profesionalizmi ta përcjellë gjatë këtij medium, që nuk e ka ndryshuar politikën as atëherë kur politika ka ndryshuar ndaj saj.



Besart Krasniqi: "Epoka e re" ia hapi dyert rinisë

Punësimi ka qenë sfidë para më shumë se një dekade, për rininë, studentët, po ashtu të gjithë qytetarët. Me kujtohet si sot, kur unë në moshë të re fillova punën në gazetën e përditshme "Epoka e re". Pavarësisht që isha i papërvojë, stafi i gazetës, në veçanti disenjatori profesionist, Shkëmbim Krasniqi "Daja", më ndihmoi ta fitoj përvojën e duhur për ta kryer punën e disenjatorit. Koha prej tre vjetësh sa kam punuar në "Epokën e re" ishte një gjë e mirë që më kishte ndodhur mua, sepse më kishte kalitur si në aspekt profesional, po ashtu edhe në atë intelektual, për shkak që kam pasur të bëj me njerëz që janë marrë me analiza, hulumtime, opinione etj.

Duke mos e zgjatur më shumë, edhe pse kam çfarë të them, gazetës "Epoka e re" i dëshiroj shumë numra të tjerë dhe plot suksese! Urime nr. 6000 lexuesve të saj, stafit dhe botuesit të gazetës kombëtare, Muhamet Mavraj! Gëzuar!



Musa Sabedini: I ruaj kujtimet më të mira nga kjo gazetë

Në gazetën "Epoka e re" punohej me shumë përkushtim. Motoja e saj e dikonte edhe fuqinë e shkrimeve. Për mua personalisht ishte një përvojë e mirë angazhimi si korrespondent në gazetën "Epoka e re". Edhe pse punoja nga Gjilani, temat e trajtuara i punoja me shumë përkushtim dhe përgjegjësi profesionale.

"Epoka e re" e kishte një moto interesante: "Gazeta më e guximshme shqiptare" dhe sipas motos duhej të realizoheshin edhe temat e ndjeshme, temat aktuale e të guximshme. Kështu edhe ndodhi, në fillim "Epoka e re" shihej si gazetë e afërt me krahun e luftës, por shpejt u kuptua roli i saj konstruktiv. Me

angazhimin e Muhamet Mavrajt, i cili në çdo çast ka përkrahur generatat e reja, ka fuqizuar korrespondentët dhe gazetarët nga terreni, e bëri gazetën të lexueshme dhe të besueshme njëkohësisht.

Falë temave të mëdha dhe të guximshme unë edhe jam shpërblyer dy herë me çmimin "Korrespondenti i vitit". I ruaj kujtimet më të mira nga kjo gazetë sepse kishte një kuadër profesionistësh të cilët pas luftës dhanë maksimumin e tyre për të qenë më afër lexuesve dhe problemeve e halleve të qytetarëve. "Epoka e re" u dha zë të gjithë atyre që mendonin se po u shkeleshin të drejtat politike, sociale, kulturore dhe fetare. Thjesht, ishte një përçues i mirë i guximit gazetar, sepse pas luftës ishte bukur problematike të trajtoje tema që lidheshin me vrasjet e luftës, që lidheshin me jetën e njerëzve kyç të politikës, para dhe gjatë kohës së luftës. Gazetës "Epoka e re" dhe stafit të saj i uroj shumë suksese të tjera dhe jubilarë të tjerë, me rezultate edhe më të mëdha në fushën e gazetarisë hulumtuese.



Emine Rushiti-Haxhijaj: Gjërat që kam mësuar në "Epokën e re" nuk kanë të paguar

Urime përvjetori i gazetës "Epoka e re" të gjithë gazetarëve që punojnë dhe që kanë punuar, themeluesve, redaktorëve, kryeredaktorëve, në veçanti lexuesve që e kanë bërë të mundur të shënohet ky përvjetor. Shtatë vjet si gazetarë në "Epokën e re" përbëjnë një periudhë punë të cilën e kujtoj me mbresat më të mira, ashtu siç e kujton njeriu rininë e vet më të mirë.

Dinamika në "Epokën e re" ishte e madhe, s'kishte pushim fare. Më pëlqente puna që e bëja, më pëlqente mënyra e punës. Gazeta kishte një emër që mua më pëlqente. Emri "Epoka e re" ishte simbolik për periudhën që po jetonim. Gjithmonë më ka tërhequr synimi për të, për t'i bërë gjërat më mirë dhe më të mira. Duke bërë punën time prej gazetarëve, njoha edhe dhimbjen, vuajtjen, sakrificën, skamjen, mbështetjen e dashurinë e njerëzve që takoja ditë pas ditësh. Gjërat që kam mësuar në "Epokën e re" nuk kanë të paguar. Shoqëritë kanë nevojë për

informacionin e shpejtë dhe me vlerë. Shoqëria kosovare ka nevojë për zërin e "Epokës së re". "Epoka e re" ishte mundësi për ta bërë ndryshimin dhe konsiderojmë se fakti që po e shënojmë këtë përvjetor dikur si gazetarë dhe tani si lexues tregon se "Epoka" i ka shërbyer qëllimit për çka ishte themeluar. Shpresoj kështu të jetë edhe në të ardhmen.

Edhe një herë, urime përvjetori i 20-të!
Suksese!



Demir Reshiti: "Epoka e re" ishte porta e shpresës ku trokita

Në vitin 2001, kur kisha ngelur pa punë, "Epoka e re" ishte porta e shpresës ku trokita, portë të cilën ma hapi pa hezitim pronari i saj Muhamet Mavraj. Pas një periudhe të shkurtër të angazhimit tim si korrespondent nga Sharri e Prizreni, u ngarkova me detyrën e redaktorit. Ky besim i dhënë ishte njëherësh edhe obligim imi që të punoja me përkushtim. "Epoka e re" për mua nuk ishte vetëm një vend pune, por edhe një shkollë e ngritjes sime profesionale. Aq shumë isha familjarizuar me kolegët e punës sa asnjëherë nuk e kam ndier veten i huaj. Pavarësisht se udhëtimi im në profesionin e gazetarisë ka vazhduar në medime të tjera, unë vazhdoj ta ndiej veten pjesë e "Epokës" sepse për një periudhë të gjatë emri im është identifikuar me këtë gazetë. Ndiem krenar që kam qenë pjesë e "Epokës" kur kjo gazetë bënte epokën! Rrugëtimi i "Epokës", si zë i shpirtit të lirë e të guximshëm qytetar, me të drejtë mund të krahasohet me rrugëtimin e historisë së shtetndërtimit të Kosovës. Gjatë gjithë këtyre viteve "Epoka" ka treguar forcën dhe gatishmërinë për ta vazhduar luftën për të vërtetën, madje edhe në çastet kur ka mbetur e vetme në pasqyrimin e realitetit, që shpeshherë ka ditur të jetë i hidhur. Duke ju përgëzuar për këto dy dekada pune të suksesshme, sinqerisht uroj dhe dëshiroj që "Epoka" të mbetet dhe të mbijetojë edhe në rrethanat kur media e shkruar po sulmohet nga ato elektronike dhe, pse jo, të përshtatet me format e reja të tregut medial. Urime "Epokë"! U bëfsh 128!



Shqiponjë Osmanaj: "Epoka" ishte vendi ku unë njoha profesionistë të fushave të ndryshme

Ndonëse është jo e lehtë të shkruash për emra historikë, për vepra që me dekada u mbijetuan stuhive që lëkundin vlerat, për një fabrikë që me finesë përgatiti për prodhim makinerinë e saj e cila tanimë përdoret në të gjitha institucionet me etikë e profesionalizëm.

Edhe pse në kohën kur u themelua gazeta e përditshme "Epoka e re", më 15 dhjetor 1999, e që numri i saj i parë ka dalë më 25 janar 2000, isha fëmijë, por e kujtoj kohën kur në shtëpinë time kjo gazetë frymonte me motivin e idealit për Kosovën e lirë e të pavarur, për shtetndërtim mbi bazën e vlerave dhe edukimin e gjeneratave. Si për çudi, do të rritem edhe unë me "Epokën" dhe në përfundim të studimeve në atë kohë, Muhamet Mavraj vlerësoi shkrimet e mia analitike të studimeve në Shkenca Politike, duke ma dhënë mundësinë për të punuar në "Epokën e re".

"Epoka" ishte vendi ku unë njoha profesionistë të fushave të ndryshme, kolegë e miq, me të cilët me dashamirësi mund të flas e të shkruaj për secilin veç e veç. Mbledhjet, propozimet për tema dhe përcjellja e ngjarjeve ditore si njeri ambicioz që sheh Ajsbergun në punën që do me zemër ishin meritë e Muhamet Mavrajt, i cili hapi portën prej së cilës hynin e dilnin me krenari gjenerata e gjenerata. Viti 2010 për mua ishte viti kur kuptova rëndësinë që hapi i parë në gazetari çdo ditë është hap i parë drejt lajmit, por jo i fundit edhe kur bënë hulumtime, kur kalon rreziqe vetëm që e vërteta të pasqyrohet siç është dhe besueshmëria të ngritët në atë nivel sa mediumi për ty ka rëndësi paralelisht me emrin tënd.

Kujtimet për "Epokën e re" janë krenaria e çdo dite kur emri lexohej nga mijëra lexues, dhe lajmi besoj ashtu siç ishte faktik. Qendresa, Muhameti, Lira, Koci, Geci, Mali, Burimi, Arjeta, Fatoni, Shqipja, Sadiku... edhe sot janë ata kolegë aq të mirë që "Epoka..." na bëri emra e me "Epokën..." rrugëtojmë. "Epoka e re" u mbijetoi sfidave, pushteteve e palëkundur në

informim të drejtë, të shpejtë, të paanshëm. Guximin për hulumtime e fitova në "Epokë..." dhe me atë synoj të bëj epokë. Muhamet Mavraj është vetë enciklopedia, dhe një njeri i tillë s'bën tjetër veç enciklopedi. Ai është një Google, siç e quaja në studimet master të Marrëdhënive Ndërkombëtare. Ai i kompleksonte edhe profesorët dhe për ne ishte modeli më i mirë i një njeriu, i një shqiptari, i një intelektual plot vlera, dije dhetribute.

Një shtet demokratik ka media të lira e me plot të drejtë konsideroj se "Epoka e re" është sinonim i të drejtës.

Në "Epokë..." nuk ka tituj për klikime e as tendenciozë. Në "Epokë..." nuk ka anime të asnjë partie. Në "Epokë..." nuk ka tekste me porosi... "Epoka..." bëri epokën me guxim ashtu siç është motoja e saj: "Gazeta më e guximshme shqiptare". Fakti që shumë prej gazetarëve dhe redaktorëve të saj në të gjitha medimet ku janë raportojnë dhe mbrojnë lajmin e saktë, tregon se kjo gazetë ishte, është dhe do të mbetet më shumë se gazetë. Kjo është akademi për gazetarinë. "Epoka..." lirshëm mund t'i konkurojë çdo shkollë të gazetarisë!

Në "Epokë..." nuk bëhesh vetëm gazetar, redaktor, kryeredaktor, apo edhe drejtor në medium të caktuar. Po dole nga "Epoka..." bëhesh profesionist, opinionist e syçelë. Etika t'i paraprinë çdo situatë, qoftë ajo edhe kundër teje, ngaqë ashtu ke filluar hapat e parë të ecjes në gazetari dhe nuk ecet ndryshe.

Njerëzit e "Epokës..." janë motivues për kolegun e tyre kur bënë shkrime e hulumtime që i ndihmojnë vendit, arsimit, shëndetësisë, kulturës e ekonomisë, raportimet kundër krimin, korruptonit e nepotizmit ishin kyçe ngaqë e dinim se lajmi i saktë është lufta më e drejtë përballë të ligave.

Misioni i "Epokës së re" edhe në këtë përvjetor shënohet me dashurinë, përkushtimin e dinjitetin e ditës së parë për saktësi dhe profesionalizëm.

"Epoka..." me shumë të drejtë edhe nga kritikët cilësohet si gazeta që renditet me besueshmërinë më të madhe krahas mediave të tjera, si privilegji i secilit nga ne që ecëm në filtrat e saj.

"Epoka..." ka marrë merita edhe nga shteti shqiptar, Shqipëria, Maqedonia e rajoni. Të shohim ku janë institucionet tona që u formuan, u rritën e qëndrojnë në këmbë falë kritikës e raportimit të "Epokës...", ku janë liderët tanë në mbështetjen e një gazete prestigjioze, apo "portalet" dhe lajmet e rreme u konvenojnë më

shumë?!

Muhamet Mavraj gjithmonë u përqendrua te suksesi. Atë asnjëherë nuk e ke dëgjuar të merret me të tjerët. Ai është udhërrëfytesë më i denjë se si arrihet suksesi, se si punohet me përkushtim e durim, se si nuk duhet dorëzuar edhe atëherë kur pritet rrëzimi yt. Edhe nëse gjithçka është kundër duhet ecur tutje që të arrihet vlera. “Këmbëngulja dhe qëllimi janë shtyllat bazë që të jeni aty ku dëshironi”, shtonte Mavraj kur pinim kafe në bufe.

Si sot më kujtohen shembujt me erën, por me fuqinë e drejtimit të rregullimit të velave të anijes, andaj për çdo shkronjë, për çdo meritë në gazetari i dedikohem Muhametit dhe “Epokës”.

Duke dashur që ta shoh “Epokën...” si kështjellë në këtë kohë klikimesh, cezurash e tendencash, uroj që “Epoka e re”, e cila ende gëzon besueshmëri të madhe në Kosovë, të mbetet lidere e profesionalizmit me mbarë stafin. Ju lumtë ju botues, Muhamet Mavraj, drejtor Sadik Zeqiri, kryeredaktor Mal Qorraj, redaktor teknik Shkëmbim Krasniqi, gazetarë, si dhe lexues besnikë të “Epokës së re”! Sukseset mos ju ndalshin kurrë! Gjithmonë krenare që isha pjesë e “Epokës së re”. Do ta vazhdoj punën me moton e saj për guxim dhe profesionalizëm, etikë dhe paanshmëri!



Arjeta Gashi: “Epoka e re” u bë pasqyrë e halleve të publikut

“Epoka e re” gjithmonë ka zgjuar kureshtjen te lexuesit dhe është një mjet i fuqishëm informacioni. “Epoka...” është një medium i shkëlqyer i njohurive për gazetarinë profesionale dhe lexuesit e saj. Që në numrat e parë “Epoka e re” u bë një pasqyrë e halleve të publikut, duke ofruar informacion për të qenë sa më pranë tyre.

“Epoka e re” që në nismën e saj ka qenë një shkollë profesionale për gazetaret e vitit 2000 e tutje dhe vazhdon të jetë imazh i një gazete që na mëson të japim informacion të saktë dhe pa koment. Shkurt, “një gazete e fuqishme shqiptare”, e cila me këtë slogan na ka identifikuar kudo edhe neve gazetarëve të saj, e që për lexuesin krijoi zakon leximin.



Dr. Nexhat Çoçaj: “Epoka e re”, ruajtësja më besnike e lirisë së Kosovës

Gazeta “Epoka e re” që në ditët e para të pasluftës ka qenë zëdhënëse e çlirimtarëve, njëherësh edhe mbrojtëse e vlerave të luftës, duke prezantuar jetën dhe veprat e dëshmorëve dhe të çlirimtarëve. Gjithashtu, ka raportuar për të gjitha ngjarjet në Kosovë, duke qenë e paanshme dhe shumë e sinqertë në raportimet e saj. Për mua kjo gazetë ka qenë dhe mbetet gazeta që ka bërë përpjekje të vazhdueshme për ta prezantuar realitetin e ri në Kosovë, duke u ballafaquar me realitetin e shoqëruar me shpifje e akuza të paqena për çlirimtarët. Ndërsa sa i përket bashkëpunimit tim si gazetar me këtë gazetë, do ta veçoja raportimin nga gjykata për rastin “Drini”, ku pa të drejtë akuzoheshin çlirimtarët. Dhe unë, i bindur në pafajësinë e çlirimtarëve, me pëlqimin e kryeredaktorit, z. Mavraj, kishim vendosur që të raportoj çdo deklaratë të atyre që akuzoheshin për një vepër që s’e kishin bërë dhe në anën tjetër akuzën e ndërtuar në shpifje që e kishte dezinformuar opinionin për vite me radhë. Si rasti “Drini” ka pasur edhe shumë raste të tjera dhe për këtë roli i kësaj gazete ka qenë i madh në bindjen e opinionit se çlirimtarët janë vetëm çlirimtarë e në asnjë mënyrë nuk mund të jenë vrasës dhe mbjellës të urrejtjes, siç përpiqeshin ta prezantonin varrmihësit e lirisë së Kosovës. Gazeta “Epoka e re” mund të them se është ruajtësja më besnike e lirisë së Kosovës. Ka qenë tabelë qitje e të gjithë atyre që lirinë nuk e panë e vazhdojnë të mos e shohin përmes luftës së lavdishme, të cilët edhe sot, mjerisht, në 12-vjetorin e pavarësisë, i sulmojnë çlirimtarët dhe vlerat e luftës për motive të ulëta. Gazetës “Epoka e re” i dëshirojmë jetë të gjatë dhe kërkoj që ta vazhdoj qëndrimin e paanshëm në aspektin politik, sepse vetëm e tillë siç është do t’i shërbejë Kosovës, do t’u shërbejë brezave dhe ardhmërisë së Kosovës!



Musli Krasniqi: Nuk do ta tjetërsoja asnjë ditë nga periudha sa isha gazetar i “Epokës së re”

Nëse do të kisha mundësi të kthehesha prapa në kohë, ndoshta edhe shumë gjëra do të bëja ndryshe. Por, një gjë është e sigurt: nuk do ta tjetërsoja asnjë ditë nga periudha sa isha gazetar i “Epokës së re”. Sot, gazeta të ndryshme në botë, në jetëgjatësinë e tyre numërojnë shekuj. Përkundër trendëve të zhvillimit teknologjik, një të ardhme të tillë padyshim se do ta ketë edhe “Epoka e re”. Sepse, ka një mision për ta përmbushur.



Hysni Syla: Të mbijetosh 20 vjet dhe t’i botosh 6 000 numra është një sukses i jashtëzakonshëm

Fillimisht dua që t’ju uroj 20-vjetorin e fillimit të punës së suksesshme të gazetës tuaj të çmuar!

Të mbijetosh 20 vjet dhe t’i botosh 6 000 numra të një gazete në një shoqëri me sfida dhe probleme të shumta në të gjitha fushat e jetës dhe të punës, është një sukses i jashtëzakonshëm, të cilin nuk ka mundur ta arrijë çdokush. Kjo mbijetesë e suksesshme flet vetvetiu për punën e madhe e me përkushtim që keni bërë ju drejtuesit e gazetës, bashkë me të punësuarit e tjerë. Unë pata nderin dhe mundësinë që të punoj për gazetën tuaj për rreth dy vjet, si korrespondent nga Mitrovica. Mund të them se gjatë këtyre dy vjetëve bëra përpjekje maksimale që të shkruaj për gazetën tuaj për të gjitha ngjarjet që ndodhnin në Mitrovicë, me qëllim që lexuesit tuaj të informohen sa më mirë e realisht për gjendjen e përgjithshme në qytetin buzë lbricit, i cili kishte dhe ende ka probleme të shumta. Gjatë kësaj kohe vëreja edhe mënyrën dhe qasjen e gazetës

tuaj ndaj pasqyrimin dhe raportimit për ngjarjet politike, shoqërore, ekonomike, kulturore e të tjera në vend. Koha vërtetoi se redaksia kishte një politikë të drejtë redaktuese, e cila i ndihmoi gazetës që të mbijetojë me sukses plot 20 vjet, e besoj se do të vazhdojë edhe më tutje me sukses. Gjithsesi se unë ndihesha mirë gjatë kohës që punoja për gazetën tuaj, sepse nuk pata asnjë problem me redaktorët e as drejtuesit tuaj. Madje dua të theksoj se te ju gjeta një njeri me vlera të veçanta, një burrë të mirë e të ndershëm, një atdhetar të devotshëm, me të cilin pata një bashkëpunim dhe mirëkuptim të shkëlqyeshëm. Ai është zotëri Sadik Zeqiri, për të cilin kam një respekt të veçantë e të jashtëzakonshëm. Dhe krejt në fund, të nderuar drejtues dhe kolegë të gazetës “Epoka e re”, edhe një herë ju uroj këtë jubile të rëndësishëm të punës suaj të suksesshme dhe ju dëshiroj gjithë të mirat në jetë.



Beqir Beqaj, drejtor në Radio Sharr: Ishte fat që karrierën prej gazetari e nisa në “Epoka e re”

Për mua ishte fat që karrierën prej gazetari e nisa në gazetën “Epoka e re”, e cila në atë kohë drejtohej nga ajka e gazetarisë sonë. Prandaj, edhe sot e kësaj dite kultivoj gazetari profesionale dhe aspak atë gazetari servile që drejtohet nga grupe të caktuara interesi. Fakti që kjo gazetë vazhdon veprimtarinë dëshmon se vlerësimi im për të është i drejtë dhe real. Ndryshe, po të ishte gazetë misionare, do të shuhej dhe do të harrohej tashmë. Prandaj, i lumtur që isha pjesë e kësaj gazete, në filllet e saj dhe në filllet e mia si gazetar, dua t’i uroj pavdekësi dhe profesionalizëm edhe në të ardhmen.

P. s. Njeriu që krijon dhe lë vepra pas vetes, ai njeri mbetet i pavdekshëm. Këtë e ka arritur edhe botuesi Muhamet Mavraj.



Enver Maloku: Epoka e “Epokës së re”

Para dy dekadave, kur në Kosovë akoma ndihej erë baruti, e lufta kishte lënë pasojë të mëdha, nisi punën gazeta “Epoka e re”, për ta shënuar epokën e saj në informimin e pas luftës dhe të gazetarisë përgjithësisht. Gazeta e përditshme “Epoka e re” në këto rrethana ishte një e përditshme më se e nevojshme, me një qasje të re ndaj realitetit që na rrethonte. Kam pasur nderin që të jem pjesë e kësaj gazete, në cilësinë e korrespondentit nga Komuna e Klinës. Ajo që më ka lënë përshtypje dhe më ka nxitur që të jem pjesë e “Epokës së re”, ka qenë trajtimi i ngjarjeve dhe fenomeneve në mënyrën më objektive dhe profesionale, sidomos të luftës së lavdishme të UÇK-së. Në këtë gazetë, për kohën sa kam punuar aty, kam përshtypjet më të mira si në aspektin e punës profesionale, po ashtu edhe në atë kolegjale. Ndonëse isha me një përvojë të gjatë në gazetari, si gazetar e redaktor në Televizionin e Prishtinës, por edhe në gazetat e tjera të pasluftës, përshtypjet më të mira i kam në gazetën “Epoka e re”. Ajo çfarë më ka lënë përshtypje është trajtimi i temave në këtë gazetë nga terreni, në bazë ku zhvillohet e vlon jeta. Në këtë gazetë kam raportuar për të gjitha zhvillimet në Komunën e Klinës dhe kjo ka bërë që “Epoka e re” të jetë ndër gazetatat më të lexuara dhe më të kërkuara në komunën tonë.



Afërdita Maliqi: “Epoka e re” vazhdon t’i rezistojë zhvillimit të hovshëm të teknologjisë

“Epoka e re” ka qenë një frymëzim dhe pothuajse synim i shumë kolegëve të mi, të punojmë në gazetën, që atëkohë ka qenë gazeta më e guximshme në Kosovë. Sikurse edhe për shumë të tjerë, “Epoka e re” ka

qenë një derë për secilin për t'iu qasur profesionit dhe për ta dashur gazetarinë si profesion dhe shumë nga ta sot janë gazetarë shumë të njohur dhe kanë pasur shumë fat në karrierë. Ka lindur në kohë të vështira, por të lavdishme, dhe ka arritur të mbijetojë në një kohë furtune. Sot, në 20-vjetorin e saj, "Epoka e re" vazhdon t'i rezistojë zhvillimit të hovshëm të teknologjisë, duke vazhduar të jetë gazetë e shtypur dhe duke pasur në krahë lexuesit besnikë. Uroj që "Epoka e re, ashtu siç e ka emrin, të jetë gjithmonë një epokë e re, për gjeneratat e ardhshme, një adresë besueshmërie për lexuesin e epokës së re!



Qendresa Mustafa: Le të festojë edhe shumë jubile e pandryshueshmja "Epoka e re"

Gazeta "Epoka e re" është shtëpia mediale ku kam shkelur për herë të parë dhe ku gjeta dhe mora profesionalizëm, paanshmëri dhe korrektësi. Kjo gazetë për tërë këto vite ka bërë epokë mediale, duke informuar drejt, mbijetuar fuqishëm, vetëm për t'i mbrojtur dhe promovuar vlerat nacionale. Dy dekada shtyp do të thotë dy dekada zë për fjalën e lirë. Gazeta "Epoka e re" le të jetë shembull për gazetarinë dhe mediat në Kosovë, për profesionalizëm ndër këto vite. Le të festojë edhe shumë jubile e pandryshueshmja "Epoka e re"! Gëzuar dhe faleminderit 6000 herë!



Sarandë Geci: Për aq kohë sa kam qenë pjesë e "Epokës..." kam mësuar shumë

Hapat e parë në profesionin e gazetarisë, kur ende isha studente, i kam bërë pikërisht në "Epokën e re" dhe për mua edhe sot ky medium mbetet shtëpia ime e dytë. Fillimisht si

praktikante, mandej si gazetarë e rregullt, duke e mbuluar Komunën e Prishtinës. Sado që në fillim puna e gazetares për mua ishte sfiduese, ishin këshillat dhe sugjerimet e redaktorëve dhe kolegëve gazetarë, veçmas të botuesit dhe njëherësh kolegut tonë Muhamet Mavraj, ato që na e lehtësonin angazhimin tonë. Për aq kohë sa kam qenë pjesë e stafit kam mësuar shumë. Kam mësuar se për të qenë e suksesshme në profesionin e gazetares duhet të kesh vullnet, guxim dhe ndershmëri, dhe se paanshmëria dhe informimi i drejtë mbeten misionet, sado sfiduese që janë. Duhesh ta kesh kurajën që këtë mision ta çosh deri në fund. Këtë më së miri e tregon puna e gjithë atyre gazetarëve dhe redaktorëve që për dy dekada nuk kanë reshtur së punuari me zell dhe përkushtim. Andaj, sot, në botimin e numrit 6000, stafit të gazetës "Epoka e re" i uroj shëndet dhe suksese në misionin e shenjtë!



Muhamet Jahiri: "Epoka e re" mbetet fytyra më e ndritur e gazetarisë nacionale në Kosovën e re

E konsideroj veten me fat që për disa vjet kam qenë pjesë e gazetës së përditshme "Epoka e re" dhe për kontributin që kam dhënë brenda kësaj gazete në shërbim të informimit të publikut. Gazeta "Epoka e re" mbetet fytyra më e ndritur e gazetarisë nacionale në Kosovën e re, e cila për dy dekada rresht i ka shërbyer këtij vendi, kësaj shoqërie dhe këtij shteti, duke informuar drejt dhe duke i promovuar vlerat e identitetit të saj shqiptar. Siç thoshte Walter Lipmann, shtypi i lirë nuk është një privilegj, por një domosdoshmëri organike në një shoqëri të madhe, prandaj "Epoka e re", një e përditshme e një vendi të vogël për dy dekada ka promovuar vlera të mëdha. Uroj që kjo e përditshme të ketë jetë të gjatë në botën e sotme të trazuar nga informacioni dhe nga ndryshimet që i ka sjellë teknologjia.



Zymber Osmani: Në "Epokë të re" mësova ABC-në e gazetarisë

Si gjeneratë e parë e Degës së Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, kushtet për ta praktikuar zanatin e gazetarit atëbotë në fakultet nuk ishin as për së afërmi, andaj ishte gatishmëria e botuesit Muhamet Mavrajt (që njëherësh ishte kolegj me ne në fakultet), që praktikën ta kryenim në "Epokën e re". Unë me një grup kolegësh fillimisht për një kohë përgatitëm një shtojcë javore, që e patëm quajtur "Gazetaria". Atë çka në teori e mësonim në fakultet, e zbatonim në praktikë këtu. Këshillat dhe sugjerimet që na i jepte Mavraj ishin të ngjashme me ato të profesorëve në fakultet. Me sugjerimin e redaktorëve unë kalova si gazetar i rregullt në sektorin e politikës. Gjatë punës gati dyvjeçare në këtë gazetë mësova shumë. Me një fjalë, në "Epokë të re" mësova ABC-në e gazetarisë. Andaj, përjetësisht u jam mirënjohës dhe falënderues Mavrajt, redaktorëve, kolegëve dhe gjithë stafit të gazetës. Sot kur "Epoka e re" nxori numrin 6000, tregon më së miri se sa guximshëm ka ecur për dy dekada ky medium, nëpër një mishmash medial, duke e kryer me ndershmëri misionin e shenjtë: informimin e drejtë dhe të paanshëm të qytetarëve. Ndihej krenar që isha pjesë e stafit tuaj. Gëzuar dhe suksese!



Alban Zeneli: "Epoka e re" do të dalë fitimtare edhe përballë ndryshimeve të reja teknologjike

"Epoka e re" ka hapur dyert për mua dhe një grup të kolegëve të mi që nga koha kur ishim studentë të vitit të dytë në Departamentin e Gazetarisë në UP. Ne publikonim një shtojcë javore në kuadër të gazetës, që

ishite dritarja e parë në profesion për shumicën prej nesh. Historia e gazetës "Epoka e re" është ngushtësisht e lidhur me ndihmën për gazetarët e rinj dhe guximin e paepur në raportimet për të cilat në shumë raste politikanët vendorë e ndërkombëtarë nuk kanë dashur që të botoheshin kurrë. Duke u nisur nga kjo trashëgimi, mund të them se baza e kësaj gazete do të shërbejë kurdoherë si një shtytje e fortë për krijim të opinionit publik. Identiteti i saj është i lidhur ngushtë me vlerat e pjesës më të madhe të popullsisë në Kosovë. Prandaj, përkundër luhatjes së tregut të shtypit si trend, besoj se "Epoka e re" do të dalë fitimtare edhe përballë ndryshimeve të reja teknologjike që kanë sfiduar gazetën anembanë botës.



Fatmir Bytyqi: "Epoka e re", tempulli i pathyeshëm

Ndihej jashtëzakonisht i lumtur që kam qenë pjesë e gazetës "Epoka e re". Nga themelimi i kësaj gazete dhe për më shumë se dhjetë vjet isha pjesë e këtij "tempulli" të pathyeshëm. "Epoka e re" ka kaluar shumë sfida, por asnjëherë e për asnjë çast nuk i ka harruar vlerat e larta kombëtare. Unë bashkë me shumë kolegë që sot jemi nëpër medime të ndryshme të Kosovës jemi produkt i "Epokës së re". Dua të falënderoj pronarin e këtij mediumi që tashmë është një nga mediumet e fuqishme në vendin tonë, Muhamet Mavraj, për mundësinë që më ka dhënë të bëhem gazetar. Faleminderit Muhamet Mavraj!



Faton Polisi: Viti 2009 në "Epokën e re" do të mbetet gjithmonë një nga momentet më të bukura të jetës time

Kanë kaluar 11 vjet nga dita e parë e punës time si gazetar i sportit në "Epokën e re", që ishte

edhe nisja e një epoke të re për mua si gazetar. Atë ditë të parë e kam ende të freskët dhe dua ta ndaj me ju. Në mbledhjen e mëngjesit propozova temën, mblodha deklaratat dhe u ktheva në zyrë për ta shkruar tekstin. Hapa Wordin, por nuk dija si ta nisja shkrimin. Por, me ndihmën e të gjithëve në "Epokën e re", mësova gjithçka. I jam falënderues në veçanti Muhamet Mavrajt, me të cilin ka qenë nder të bashkëpunoj. Viti 2009 në "Epokën e re" do të mbetet gjithmonë një nga çastet më të bukura të jetës time. Me shumë respekt urime 20-vjetorin e "Epokës së re"!



Driton Bublaku: Edhe sot e kujtoj ditën e parë të punës në "Epokën e re"

20 vjet "Epoka e re". Nga këto 20 vjet, katër vjet isha pjesë e këtij mediumi si fotoreporter. Edhe sot e kujtoj ditën e parë të punës në këtë medium, ku unë me shumë kolegë filluam një epokë të re në gazetari. Kontributin tim në gazetë e kam dhënë me përkushtim të madh. Në atë kohë isha i ri në profesion, por aty mësova e u njoftova me shumë njerëz që edhe sot kam shoqëri me ta. Mësimet që i morëm nga gazeta më nevojiten edhe sot. Gazeta "Epoka e re" është një mediumet e para në vend e cila ka thyer shumë tabu të mediave vendore. Ajo ishte gjithëherë në përkrahje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Vazhdon ta përkrahë dhe ruajë vlerat e saj edhe sot. Uroj që ky medium të mbijetojë e të presë edhe shumë gjenerata të reja! Urime Muhamet Mavraj! Urime Sadik Zeqiri!



Minire Berisha-Tërbunja: Në "Epoka e re" mësova profesionin e gazetarisë

Me rastin e 20-vjetorit dhe botimit të numrit 6000 të gazetës "Epoka e re", uroj që ta vazhdojë këtë rrugëtim edhe për shumë e

shumë dekada të tjera. Jam krenare dhe e lumtur që për dhjetë vjet isha pjesë e stafit të gazetës, e cila ishte dhe mbeti një dritare e rëndësishme e informimit në Republikën e Kosovës.

“Epoka...” na dha mundësinë të ndihemi si në shtëpinë tonë dhe shërbeu edhe si një shkollë e gazetarisë për shumë të rinj që gjetën mundësi të punojnë në këtë gazetë.

Në “Epoka e re” mësova profesionin e gazetarisë.

Është shembulli më i mirë i gazetarisë në Kosovë. “Epoka e re” le ta vazhdojë rrugëtimin e saj edhe për shumë dekada të tjera.



Fehmi Ajvazi: “Epoka e re” ia ka dalë...

Një grup entuziastësh të fjalës së lirë, pak kohë pas mbarimit të luftës në Kosovë, u organizuan me vetëmohim rreth një projekti: nisjen e botimit të një të përditshmeje që s’e kishim pasur asnjëherë në mesin tonë, të atillë çfarë edhe na duhej. Djem dhe vajza në moshë relativisht të re, por të përkushtuar, disa me përvojë e disa edhe pa të, ia arritën ta bëjnë hapin e parë duke i dhënë lexuesit më shumë hapësirë informimi pa censurë e në shërbim të mendimit dhe shprehjes së lirë. Por, si lindi kjo gazetë? Si e mbaj mend unë fillim e saj?

Implementuesit kryesorë të këtij projekti, Muhamet Mavrajn e Driton Laçin, i njihja qysh nga aktivitetet e Unionit Studentor, para lufte. Prandaj, ata e diskutuan me mua idenë e tyre. Më kujtohet një takim në lagjen “Bregu i Diellit” rreth inicimit të këtij projekti, e aty u diskutua edhe emri i gazetës. Muhameti e Dritoni ishin pajtuar që gazeta të quhej: “Epoka”. Ishte i pëlqyeshëm ky emër, padyshim, por në rrethanat që ishin krijuar në Kosovë, s’kish pse të mos shtohet edhe fjala - pjesa “e re”! Propozova me kënaqësi që gazeta të quhej “Epoka e re”. Kurrë s’kish pasur në Kosovë dhe në hapësirat shqiptare një epokë më të re, më të ndritshme se epoka e Kosovës së lirë, në kapërcyell të një shekulli! Natyrisht, s’pati asnjë dilemë në këtë drejtim, përkundrazi! Dhe gazeta e re, e lirë, demokratike “Epoka e re”, hyri në rrjedhat tona informative - mediale me

konsekuencë, me guxim dhe, mbi të gjitha, me një mision fisnik që ta përhapë mendimin dhe fjalën e lirë. Unë, pata kurajën, vullnetin dhe dashurinë për fjalën e lirë, shkrimin etj., që ta jap kontributin tim në hapat e parë të kësaj gazete, me të cilën herë pas here bashkëpunoj edhe sot. Po, ama, aso kohe, para dy dekadave, kush ka besuar që “Epoka e re” do të mbijetojë kaq gjatë? Askush. Po “Epoka e re” ia ka dalë...!”



Nexhmije Ahmeti: Periudha sa kam punuar në gazetën “Epoka e re” ishte periudha më e mirë e punës sime në gazetari

Periudha sa kam punuar në gazetën “Epoka e re” (2003-2004) ishte periudha më e mirë e punës sime në gazetari. Jo vetëm se ma mësoi ABC-në e këtij profesioni, por se në “Epokë...” kam parë profesionalizëm, shprehje të fjalës së lirë, korrektesisë dhe saktësisë. Në këtë gazetë kam mësuar shumëçka se si duhet të jesh një gazetar profesional, i paanshëm, i drejtë e, mbi të gjitha, se si ta duash vendin dhe kombin. “Epoka e re” ishte, edhe tani vazhdon të jetë, sinonim i profesionalizmit, korrektesisë dhe paansisë. Kjo dëshmon edhe me faktin se janë bërë dy dekada të themelimit dhe po vazhdon ende. Uroj që “Epoka...” të vazhdojë edhe dekada të tjera. Urime numri i 6000-të! Respekt për ata që vazhdojnë ta mbajnë gjallë “Epokën...”!



Ahmet Pllana: Gazeta e përditshme “Epoka e re” për dy dekada ishte dhe mbeti gazeta më e guximshme

Urime të përzemërta për 20-vjetorin e themelimit dhe punës aktive të gazetës së përditshme “Epoka e re” dhe numrit 6000. Gjithë stafit dhe lexuesve të saj!

besnikë dhe mbarë qytetarëve të Republikës së Kosovës! Urime për sukseset e arritura të “Epokës së re” për dy dekada pa u ndalur asnjëherë së botuari duke tejkaluar sfidat, pengesat dhe vështirësitë nëpër të cilat kaloi. Gazeta e përditshme “Epoka e re” për dy dekada ishte dhe mbeti gazeta më e guximshme e shkrimeve të saj me kritika konstruktive në dobësitë që ekzistonin në politikë, ekonomi, kulturë, jetën e përditshme, problemet sociale etj. Jam i lumtur dhe krenar që isha staf i gazetës “Epoka e re”, përkatësisht gazetar i ekonomisë, ku bashkë me kolegët dhashë kontributin tim. Ishte kënaqësi e madhe të punoja në gazetën “Epoka e re” bashkë me drejtorin e gazetës Muhamet Mavraj, me drejtorin financiar Sadik Zeqiri, me redaktorët Demir Reshiti e Xhevdet Fetahaj, me gazetarët Mal Qorraj e Shqipe Hetemi e shumë të tjerë. I falënderoj të gjithë për respektin kolegial. Ishte kënaqësi kur për çdo mëngjes pinim kafën e mëngjesit bashkë dhe pas kafes fillonim punën me plot elan dhe entuziazëm, me vullnet rinor të pashoq. Edhe njëherë i uroj gazetës “Epoka e re” suksese të mëtejshme në rrugëtimin e saj!



Lulzim Ahmeti: Ka qenë një përvojë e jashtëzakonshme me “Epokën e re”

Në gazetën “Epoka e re” kam punuar gjatë periudhës 2008-2010. Të punoja në këtë gazetë për mua ka qenë nder, kënaqësi dhe privilegj. Edhe pse puna në gazetën “Epoka e re” nuk ishte puna e parë në media, por të jem pjesë e kësaj gazete ka qenë një përvojë e jashtëzakonshme, profesionale dhe një kalitje në profesionin e gazetarit, për ta vazhduar suksesshëm misionin për t’i informuar qytetarët drejt, saktë dhe guximshëm. Stafit aktual, por edhe gjeneratave të reja, të cilat do të bëhen pjesë e gazetës në të ardhmen, u dëshiroj suksese bashkë me “Epokën e re” dhe asnjëherë të mos heqin dorë nga e vërteta dhe informimi i drejtë i qytetarëve! Gazetës “Epoka e re” i uroj 20-vjetorin e themelimit! Sukseset e përcjellshin në rrugëtimin e saj!



Naim Zeqiri: “Epoka e re” solli një frymë të re në mediat e shkruara

Gazeta ditore “Epoka e re” shënon përmbylljen e dekadës së dytë të punës si një nga mediat e shkruara më alternative, që u themelua në rrethanat e reja të krijuara pas çlirimit të vendit, duke u bërë një zë më shumë në diversitetin medial të Kosovës. “Epoka e re” solli një frymë të re në mediat e shkruara si një medium nëpër të cilin kaluan gazetarë të shumtë, të gjeneratave dhe profileve të ndryshme, që dhanë kontribut të çmuar në informimin e drejtë të opinionit, si një nga të drejtat themelore të njeriut. “Epoka e re” për 20 vjet udhëtoi krahas ndryshimeve sociale e teknologjike që përcollën vendin duke ruajtur vlerat e medias tradicionale.

Urime dhe suksese!



Jeton Rushiti: “Epoka e re” ka qenë dhe mbetet përvojë me kujtime të mira

Jo vetëm një periudhë kohore që kam përcjell te lexuesi ngjarjet dhe zhvillimet e asaj kohe, por të qenit pjesë e njëjës prej gazetave me më emër në tregun medial, siç është “Epoka e re”, ka qenë dhe mbetet përvojë me kujtime të mira. Kam pasur shumë shkrime që kanë zënë vend në ballinë të gazetës, por “qershia mbi tortë” ka qenë numri i 17 shkurtit të vitit 2008. “Bac, u kry” mesazhi i famshëm i shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ishte edhe shkrimi im në ballinë, që përshkruante vizitën e kryeministrit të asaj kohe, Hashim Thaçi, në Prekaz, vetëm një ditë para se Kosova ta shpallte pavarësinë. U uroj jetë të gjatë “Epokës së re” dhe të gjithë gazetarëve, stafit dhe atyre që kontribuojnë për ta mbajtur gjallë këtë gazetë.



Fidajete Geci: Në “Epokën e re” kam mësuar se si duhet bërë gazetari të mirë dhe pa censurë

Gazetaria është mision i shenjtë. Unë e studiova gazetarinë, ndërsa zanatin e mësova në gazetën “Epoka e re”. Koha sa kam punuar në këtë gazetë ka qenë një ndër periudhat më të mira në jetën time deri më tani. Këtu kam mësuar se si duhet bërë gazetari të mirë dhe pa censurë. “Epoka e re” gjithmonë ka dhënë hapësirë për ta pasqyruar të vërtetën, për të informuar drejt dhe në mënyrë profesionale. Në “Epokë...” kam mësuar se misioni i vetëm dhe më i rëndësishëm i gazetarit është informimi i drejtë, i paanshëm dhe korrekt. Pavarësisht prej sfidave, “Epoka e re” ishte zëri i gjithë shqiptarëve anekënd botës. Krenare që kam qenë pjesë e saj për një kohë të gjatë. Shpesh kam mall për gjithë ekipin që kemi punuar bashkë dhe për atë redaksi që më ka ofruar emocionet më të mira. Urime 20-vjetorin! Stafit, shëndet, ndërsa gazetës, jetë të gjatë sa të ekzistojë njerëzimi!



Bajram Lani: “Epoka e re” u bë simbol i gazetarisë së guximshme

Para njëzet vjetësh në Kosovë nisi një epokë e re e gazetarisë. Një epokë e pagëzuar “Epoka e re”, që u bë simbol i gazetarisë së guximshme dhe rezistente ndaj klisheve që e karakterizonin medien në masë të madhe. Një gazetë alternative, që ishte dhe është dritare informimi për çdo kategori të shoqërisë dhe mundësi për secilin të ri që synon të bëhet gazetar. Pra, “Epoka e re” ishte epokë e re për shumë gazetarë që sot kanë përfunduar në mediat e tjera apo edhe në institucionet shtetërore. Ishte fillim i një epoke të re edhe për mua. Ishte viti 2003 kur nisa punën në këtë gazetë. Ishte koha

kur vullneti i paraprinte pagës. Ishte koha kur përtej çdo profesionalizmi kërkohej guxim. Karakteristikë kjo që ia dha 'Epokës...' edhe moton "Gazeta më e guximshme shqiptare". E guximshme për ta thënë të vërtetën edhe kur ajo dhemb. E guximshme për ta pasqyruar realitetin edhe kur ai realitet përpriqej të tjetërsohej deri në utopi. Para së gjithash, e guximshme për t'ua dhënë mundësinë gazetarëve të rinj që ta mësojnë abc-në e gazetarisë, pa qenë të kufizuar nga politikat redaktoriale. Duke lejuar secilin që të jetë vetvetja dhe ta ndërtojë identitetin e vet profesional, pa korniza. Nëse një medie në Kosovë mund të konsiderohet shkollë e dytë për gazetarët e rinj, atëherë ajo është "Epoka e re". Sigurisht që gjatë këtyre viteve as "Epoka..." nuk ka shpëtuar pa gabime, që janë të natyrshme, por që ka ditur që nga kjo të mësojë dhe para se të hedhë hapin para, ka shikuar nga prapa për të qenë e sigurt në ecjen e saj. Dhe, si medium tradicional, të ecë vertikalisht krahas zhvillimit të mediave, sidomos atyre online, duke e ruajtur aromën e këndshme të ngjyrës mbi letër.

Me këtë aromë edhe unë e nisa karrierën si gazetar te "Epoka e re", ku për tri vjet u përpoqa të jap kontribut, për të kaluar në media të tjera, por duke e bartur gjithmonë pas identitetin e "gazetarit të Epokës". "Epoka e re" dydekadeshe, uroj të bëjë edhe shumë dekada të tjera, por duke e ruajtur identitetin e saj dhe duke qenë gjithnjë epokë e re, që e lufton atë që është e tejkualuar për shoqërinë.

Urime dhe suksese!



Jeton Musliu: "Epokës së re" i dëshiroj të jetë aq jetëgjatë sa ta mbërrijë edhe mileniumin e ri

Isha i hutuar, pak i trembur, por shumë i lumtur kur në vitin 2003, pas një e-maili që dërgova në

redaksinë e "Epokës së re", përgjigjja që mora ishte se mund të shkoja të punoja. Artikulli i parë ishte për rritjen e shitjes së generatorëve për shkak të mungesës së rrymës. Paradoksisht ende vazhdon ky problem. Sidoqoftë, ajo që më ka bërë përshtypje ishte gatishmëria e botuesit dhe të tjerëve që secilit t'ia hapin dyert, pavarësisht se kushtet në atë kohë, vetëm katër vjet pas luftës, ishin të rënda. Nuk do ta harroj kurrë ndihmën e kryeredaktorit në atë kohë, Imer Mushkolajt dhe të tjerëve. Kjo përkrahje më ka bërë që edhe më shumë ta dua këtë profesion dhe tash pas 17 vjetësh, kur mendoj se jam i lodhur, mendoj për ditët e para të punës në këtë gazetë që ishin edhe më të vështira, por shumë të paharruar. Andaj "Epokës së re" i dëshiroj të jetë aq jetëgjatë sa ta mbërrijë edhe mileniumin e ri.



Qëndresa Fazliu: Dy fjalë për "Epokën e re"

"Epoka e re" ka qenë në kuptimin e plotë të fjalës një epokë e re për karrierën time në gazetari. Ka qenë medium i parë i shkruar, në të cilin unë kam punuar. Kam mësuar të mirat e këtij profesioni në një vend që parimet dhe të mirat e gazetarisë profesionale kanë qenë kusht për t'u publikuar një shkrim i yti. Andaj munda im për të punuar një tekst i cili do të më aprovohej për publikim nga kryeredaktori ishte i madh, por ishte pikërisht ai mund që më ka perfeksionuar parimin gazetaresk. Për këtë gjë i jam mirënjohës pafundësisht stafit të "Epokës së re" për rrugën në të cilën e ka drejtuar karrierën time.



Arbisa Shefkiju: Në "Epoka e re" fillova për herë të parë rrugëtimin drejt gazetarisë

Në gazetën "Epoka e re" fillova për herë të parë rrugëtimin drejt gazetarisë. Në këtë medium gjithmonë parim kemi pasur informimin e saktë, të drejtë dhe cilësor për të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht prej rrethanave që ndodhnin në vend. "Epoka" ma dha mundësinë dhe hapësirën për çdo temë që kam dashur ta trajtoj, duke më ndihmuar gjithmonë redaktorët dhe kryeredaktori Mal Qorraj me këshillat e tyre që t'i ndjek standardet më të larta të gazetarisë. Ato edhe tani më qëndrojnë në kokë, kurdo që filloj të shkruaj një lajm. "Epokës" do t'i jem gjithmonë mirënjohës!

6 000 DITË DHE 6 000 NETË



**Berat ARMAGEDONI
(alias Dakaj)**

Gazeta "Epoka e re" më 25 janar 2020 shënoi 20-vjetorin e themelimit. Unë, më 9 shtator 2019, pata shënuar 13-vjetorin e punësimit në këtë gazetë. Prandaj, duke punuar kaq gjatë në të, kam çfarë t'ju rrëfej sot për të, për kolegët e mi të sotëm, por edhe për disa ish-kolegë - kryeredaktorë dhe gazetarë, posaçërisht për botuesin Muhamet Mavraj dhe për drejtorin e përgjithshëm të gazetës, Sadik Zeqiri, me të cilët jemi mbledhur sot këtu, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, për çlirimin e hapësirave të të cilit, para njëzet e tre-katër vjetësh, si

asnjëherë tjetër e si askush tjetër, ka kontribuar, ka dhënë mund dhe mend, ka derdhur djersë dhe ka dhënë ide dhe ka vepruar për çështjen kombëtare dhe të universitetit e të arsimit shqip, ish-kryetari i Kuvendit të Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës, njëherësh kryeredaktor i gazetës studentore "Bota e re", Muhamet Mavraj.

Këtë njëzetvjetor të gazetës ne donim ta kremtonim më ndryshe. Ta bënim më madhështor dhe sa më të bukur. Donim të kishim përreth vetes edhe miq e jo vetëm ish-staf dhe staf gazete. Donim t'i kishim përreth edhe disa njerëz të politikës dhe disa rapsodë. Disa analistë dhe disa politikanë. Donim, po ashtu, që këtë takim ta organizonim tjetërkund, në ndonjë sallë më luksoze, më të madhe dhe më komode. Donim, po ashtu, ta kremtonim së bashku me monografinë për "Epokën e re", e cila e ka pasur kohën ta shihte dritën e botimit këtë vit sepse janë bërë shumë vite punë, janë botuar shumë numra gazete, mijëra faqe e janë regjistruar shumë rrëfime e botuar shumë

fotografi nga e gjithë bota. Kishim në mendje, për njëzetvjetorin e saj, edhe shumë ide të tjera, të cilat, sa herë që na shkrepnin kujt më shpejt, mbledheshim t'i diskutonim brenda hapësirës së redaksisë së gazetës, kur Mavraj s'ishte aty. S'është as sonte. S'ishte as mbrëmë. Gjithë javën s'ka qenë. Gjithë muajin. Ka kohë që, së bashku me kuletën, na ka dorëzuar edhe besimin dhe lënë në dyer të redaksisë etikën e punës që për çdo vit, në semestrin veror dhe në atë dimëror, ua mëson dhe përsërit studentëve të gazetarisë dhe të komunikimit: "Ndershëm, korrekt, paanshëm. Ngadalë dhe mirë". Dhe kur një natë, më në fund, në një fushë futboll biseduam me të për kremtimin e njëzetvjetorit të gazetës dhe për tubimin tonë të përbashkët diku në një sallë restoranti, ai na thirri e na tha: "Djem, sa më thjesht, sa më thjesht, sa më thjesht organizojeni. Meqë ju dëshironi ta festoni numrin 6000 dhe njëzetvjetorin e gazetës, unë dua që ju t'i ftoni vetëm gazetarët dhe ish-gazetarët e gazetës, bashkëpunëtorët tanë, ata

afaristë që s'na kanë harruar kurrë, që kanë ndarë fitimet e veta për ta vazhduar publikimin e gazetës dhe mbajtur në punë dhjetëra veta, për të cilët më ka marrë malli fort, me të cilët dua ta ndërroj nga një cigare, t'i falënderoj për bashkëpunimin e gjatë dhe për kontributin e madh e shumë të çmueshëm e të njerëzishëm që na kanë dhënë hëm kur kemi qenë shumë në zor e pasur nevojën e tyre, hëm sot kur e kemi përkrahjen e tyre". Atë natë jo, por të nesërmen hoqëm dorë nga restorantet. Na mbeti të zgjedhnim, për këtë takim të sotëm, Bibliotekën Kombëtare të Kosovës ose Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. E zgjedhëm të dytin për arsye se, siç thashë në paragrafin e parë, për universitetin Mavraj ka kontribuar më shumë sesa për bibliotekën. Pastaj, se aty ka shokun e vet më të mirë, shokun e Lëvizjes Studentore të vitit 1997 - Bujar Dugollin, por edhe ish-gazetarin e vet, sot profesor në këtë fakultet, Arsim Sinanin, edhe disa bashkëpunëtorë të gazetës, me të cilët, ndër temat e përditshme, edhe kur jemi në

fushë futboll, ka cilësinë sa më të mirë të arsimit dhe të arsimimit në universitet, të studentëve të universitetit publik dhe të atij privat. E morëm parasysh kërkesën e tij dhe që nga ajo ditë po shkonim kah thjeshtësia, kah dukja e sotme e këtij organizimi. Por, para se të bëheshim sot bashkë, kishim punë të tjera për të bërë. Numri 6000 i gazetës, pas 25 janarit, vinte më shpejt sesa që kishin shkruar të kaluarit. Presionin e numrave e përjetonte më shumë drejtori i përgjithshëm, Sadik Zeqiri, i cili merrej me punët më të imëta e deri tek ato më të mëdhatë. Natyrisht, e kishte edhe përkrahjen e kolegëve, posaçërisht të Arsim Sinanit, me të cilin, po ashtu edhe me Mavrajn, u takuam në fillim të shkurtit aty përkrah Fakultetit të Filologjisë dhe hartuam skenarin e sotëm, kaq të thjeshtë: takimin e sotëm këtu, me këta që kanë ardhur e me të tjerët që s'kanë mundur të vijnë për shkaqe të ndryshme, për ta pirë nga një kafe ose lëng frutash, për ta ndërruar nga një cigare, për të shpalosur ndonjë kujtim, për t'i dhënë

dikujt ndonjë mirënjohje, dikujt tjetër ndonjë falënderim, ndonjë laps e numër gazete e për t'ia kujtuar secilit të pranishëm, se koha kalon, se ne plakemi dhe mplakemi, por s'harrojmë kontributin tuaj në gjithë këta numra të gazetës e në historinë e saj njëzetvjeçare, të cilën punë të përbashkët e kujtuam nëpërmjet paraqitjes së dhjetëra ballinave të gazetës botuar ndër vite, që nga koha e gurthemelimit, pastaj që nga koha dhe nga goditjet e mëdha financiare nga të cilat "Epoka..." shpëtoi disa herë, por simotrat e saj, fatkeqësisht, ranë përtokë dhe nuk u çuan kurrë më. Po u jap shpirt dhe po u shpreh ngushëllime për to, themeluesve të tyre: Ndjesë paçin!

Kur ato ranë u pa sa e rëndësishme është media fizike, njëkohësisht sa është e vështirë për t'u mbajtur gjallë. Kur ranë edhe disa të tjera ndërkohë, u pa se media e shtypur nuk mbahet pa lexues, pa publikime dhe pa përkrahje nga institucionet qendrore dhe lokale, të cilat, sa për ta paraqitur punën e vet dhe për t'ia treguar publikut dhe arkivuar në institucione të kujtesës kombëtare, shtypit po i japin nga një shtyrje të lodhshme nëpërmjet ndonjë njoftimi, nëpërmjet ndonjë shpalljeje, nëpërmjet ndonjë reklame ditëshkurtër ose javëgjatë. Por, jo edhe ndonjë grant nga qeveria, e cila, historinë e këtyre mediave të shkruara, me traditë njëzetvjeçare, duhet ta ruajë sikurse dokumentet më të rëndësishme të vetat ose sikurse që i ruan dhe i mbështet materialisht revistat për letërsi dhe kulturë Ministria e Kulturës. Po, duhet t'i mbështetë shumë, sepse këtyre mediave, qeveria, institucionet kulturore dhe arkivore, do t'ua dinë rëndësinë shumë më vonë, kur punën e vet s'do të mund ta gjejnë në median elektronike.

Dhe meqë në 5 999 numra kemi shkruar e trajtuar tema nga A deri në Zh, numrin 6 000, në vend të botimit të një monografie në këtë njëzetvjetor, e rezervuam për vete. Idenë, për këtë numër tematik të gazetës, meqë në këtë takim nuk fituam as analistë dhe as politikanë, e dhashë unë dhe e tumirën Mavraj, Sadiku dhe Arsimi. Edhe kryeredaktori, Mala. Për ta botuar kështu si është botuar sot, duhej ta shpalosnim kujtesën personale dhe atë kolektive publikisht, pa fshehur gjë dhe për t'i rrëfyer ndodhitë sa më natyrshëm. Kështu na ka porositur edhe Noli para shtatëdhjetë vjetësh. Duhej t'i pyesnim bashkëpunëtorët çfarë kujtime individuale keni dhe çfarë kolektive në kohën sa keni qenë (ju që më nuk jeni) dhe ju që jeni në gazetë. Ftesës, për këtë numër tematik, iu përgjigjen shumë kolegë gazetarë. Kur i mblodhëm shkrimet e tyre dhe po i faqosnim me "Dajën" (Shkëmbim Krasniqin), unë

ngula këmbë që shkrimin më të gjatë ta shkruaja unë, ani pse, disa vjet më parë, dy a tri shkrime të tilla, po kaq të gjata, i pata shkruar me rastin e ditëlindjes jo të gazetës, por të punës sime në gazetë.

Nga "Epoka" vij në "Epokë" kthehem

Në vitin 2006 erdha të punoja në gazetën "Epoka e re", gazetar kulture dhe lektor. Punova vetëm nëntë ditë. Asnjë ditë dhe asnjë natë s'u takova me botuesin, se unë dilja nga redaksia në orën 21.00 e ai vinte më vonë. Ditën e dhjetë të punës e vazhdova në gazetën "Infopress". Nuk vajta në këtë të fundit sikurse kishin pas vajtur disa para meje, pa paralajmërim. Shkova me paralajmërim. I bëra me dije botuesit nëpërmjet e-mailit tri herë, edhe drejtorit në një takim për vajtje atje. Edhe njëri edhe tjetri heshtë. Unë veprova. Shkova në "Infopress". Shtatëdhjetë për qind e stafit të saj ishte i "Epokës së re". Por, kishte edhe pak gazetarë të mediave të tjera. Ishte një gazetë e re dhe korrite, si kombajna grurin, të hyra të shumta nga reklamimi nga institucione dhe kompani. Punova aty shtatë muaj, fillimisht lektor, bashkë edhe me dy lektorë të tjerë, pastaj përgatitja edhe një vitrinë libri, një shtojcë të vogël kulture e cila kurrë nuk dilte e plotë sepse sa herë që vinte një faqe reklamë a shpallje pas orës 20.00, hiqej një faqe kulturë, e sa herë që vinin dy faqe reklamë a shpallje tenderësh, hiqej edhe një faqe sport. Me kalimin e muajve mua më shtohesh puna, por jo edhe paga. Botuesi, Rexhep Hoti, në muajin e dytë të punës bërë aty, më pati premtuar, pos pagës së lektorit, edhe 150 euro të tjera shtesë në muaj për shkrimet për kulturë (për atë vitrinë libri, për ato poezi që i përzgjidhja dhe i komentoja). Në muajin e tretë, kur shkova ta merrja pagën e muajit të dytë te zonja Sheki (më duket kështu quhej ose e quanim), e mora vetëm të lektorit, pa shtesë. Ajo u arsyetua se botuesi nuk i ka thënë të bëjë pagesë më të madhe se 280 euro. Mund të ketë harruar, mendova. Do të ma kompensojë në muajin tjetër, ndoshta! E muaji i tretë erdhi shpejt. Prapë e njëjta pagë dhe prapë i njëjti premtim për shtesën. Kështu vazhdova të punoja edhe katër muaj të tjerë, me të njëjtën pagë e me të njëjtin premtim nga botuesi. Në fillim të muajit të tetë, kur u bë boll, një natë botuesi erdhi në redaksi. Zbrita në katin e parë, kur gazeta vlonte nga paratë dhe iu futa në zyrë që t'i merrja paratë e mia. "Shef, ka nisur muaji i tetë dhe deri më sot, prej që jam këtu, asnjëherë nuk më është dhënë shtesa e premtuar prej 150 eurosh për shkrimet për kulturë". Ai bënte diçka në kompjuter dhe

heshtte, unë rrija në këmbë duke pritur këtë përgjigje të tij: "Car, puno, se t'i jap". "Që shtatë muaj po punoj. Që shtatë muaj po pres shtesën për punën. Duhet të m'i japësh sonte sepse më duhen dhe m'i ke premtuar". U përgjigj shpejt duke fërkuar kokën: "Hajt bre car se t'i jap..." E fërkova kokën edhe unë dhe i thashë: "Nëse nuk m'i jep sonte unë nesër nuk vij në punë". Qeshi dy a tri herë dhe tha: "Vjen, vjen". Dola nga zyra, u ngjita në katin e dytë, e vazhdova punën e lekturës dhe kolegëve, atyre tre-katër vetave që kishin mbetur ende në redaksi, u thashë se nesër nuk do të vija në punë. Ekremit dhe Mimosës (lektorëve), të cilët nuk ishin aty, u shkrova letër dhe u bëra me dije që nesër duhej të dilnin më herët në punë sepse kishin punë më shumë, se duhej ta bënin edhe punën time. Ekrem Kryeziu dhe Bedri Halimi nuk bindeshin se po e lija punën sepse më thoshin se Rexhën e ke jaran. Por, jaranit ia ngulte, se kinezët s'i kishte aty!

Ende pa e kryer punën mirë, kolegu i studimeve në Degën e Gazetarisë, Demir Reshiti, nëpërmjet MSN-së 8.00 më pyet nëse do të merrja pjesë nesër në ligjëratën e Milazim Krasniqit në Hyrje në gazetari. I bëra me dije se do të vija. Kur u interesua si po ia kaloja në "Infopress", e njoftova se deri sonte mirë, e që nga nesër duhet të gjej një punë tjetër. "Eja në 'Epokë', shoq! Kemi nevojë për lektor. Fol me Padishahun (kështu e quante Mavrajn)". "Jo, jo, do të këqyri të bëj një punë tjetër" - i thashë Demës. Përtoja t'i shkruaja një ish-shefi që s'e kisha takuar asnjë natë prej atyre nëntë ditëve e nëntë netëve. Pas pak minutash, sigurisht pas propozimit të Demirit, më shkroi vetë Mavraj. Ma nisi vetëm një pikëpyetje që më dukej se vallëzonte dhe bënte gjimnastikë në ekranin e kompjuterit. Kurrë një të tillë nuk e kisha parë më parë. U përshëndetëm me Mavrajn. S'më kishte harruar. Ai më pyeti për punë dhe unë i thashë se që nga sonte jam pa punë, se nuk e kam shumë për ngutë punësimin. Por, ai më tha:

- "Nëse do, eja te ne".
- "Kur?"
- "Sonte".
- "A bën nesër?"
- "Bën edhe pasnesër, por na duhesh sonte".
- "Në rregull. Tash vij".

Në një usb i futa disa prej dokumenteve që i kisha në kompjuter, e ndala kompjuterin, u përshëndeta me kolegë dhe dola nga redaksia e "Infopress"-it dhe në orën 21.43 shkela pragun e redaksisë së "Epokës së re".

- "Mirë se erdhe, shoq!" - më uroi Demiri, pastaj "Daja" karshi tij. Në fund të redaksisë, i vetëm, me një çaj a kafe të zezë përpara e cigare e libra përplot tavolinën, më pristë Muhameti, çehrerëndë, i cili, para se të më urojë mirëseardhje dhe

mbarëvajtje, më tha: "Ke ardhur ke punuar këtu, tetë muaj më parë, vetëm tetë a nëntë ditë. Nëse ke plan afatshkurtër, mos ia nis punës, mos na mundo as neve e as veten. Nëse pranon të punosh, mos të shkojë mendja të dalësh nga këtu, të paktën dy vjet". U pajtuam për kushtet e punës dhe për pagën dhe lidhëm marrëveshje gojore, burrërisht: "Të paktën dy vjet". Atë natë ia fillova punës. Kur e mbaruam përgatitjen e gazetës dhe pasi i shtypëm faqet në pause dhe i dërguam në shtypshkronjën "Rotoprint", me "Dajën" ndenjëm në restorante të Prishtinës derisa u zbritë.

Të nesërmen, rreth orës 13.00, më telefonoi Bedri Halimi:

- "Tarnakop, ku je?"
- "Në qytet, axhi Bedro".
- "Hajde n'punë se ky tarnakopi tjetër [Rexha] është ba shumë nervoz".
- "E kam la punën. I kam kallëzu pramë shefit, edhe ty e Ekremit dhe të tjerëve".
- "Hajde more tarnakop, se t'i jep paret, mos ta nin".
- "Jo, jo, asht kry kjo punë. Është dashtë me m'i dhanë pramë. Tash kam fillu punën në 'Epokën e re'".
- "Po a?"
- "Po, po".

Pas kësaj bisede me Bedri Halimin, pak minuta më vonë më telefonon edhe Ekrem Kryeziu, pastaj edhe Rexhep Hoti, i cili, i mllëfosur, murmuron me gojë dhe e ndërpret telefonin. Pavarësisht prej premtimeve të tjera e raporteve shoqërore e të mira që kishim krijuar ndër muaj, tashmë kisha marrëveshje me një tjetër njeri. Të paktën, për dy vjet. Në ditën e dytë të punës në vend pune dola më herët. Doja t'i njihja kolegët që s'i kisha takuar. "Epokën e re" vazhdonin ta redaktinin Burim Etemaj dhe Xhevdet Fetahu, ta korrektonte Xhema me një tjetër e të shkruanin Rabie Bala, Minire Berisha, Mal Qorraj, Veton Zymberi, Albulena... erdhën ndërkohë edhe Jetliri, Shqipja, Muhameti, Qëndresa, Albani, Bublaku, Afeti, Lira, Arsimi, Fatoni, Geci, Koci e sa e sa të tjerë. Disa, ndërkohë shkuan e disa, ndërkohë, erdhën. Para këtyre, po edhe para meje, duke hulumtuar arkivin e "Epokës së re", më dilnin para emra gazetarësh të njohur, drejtues të mediave të mëdha dhe publike, të cilët mësimet e para të gazetarisë i kishin marrë në "Epokë". Gjeja, në përbërjen e redaksisë së gazetës, emrin e Imer Mushkolajt, të Lulëzim Etemajt, të Arben Atashit, të Ernest Lumës e në faqe të gazetës atë të Mentor Shalës, të Ramize Murtezi-Shalës e shumë e shumë të tjerëve, të mbi 100 vetave. (Një listë, me emrat e gazetarëve dhe ish-gazetarëve të "Epokës së re" e stafit të saj, gjatë njëzet vjetëve të saj, po ia bashkëngjis këtij shkrimi. Ndonjë mund ta kem harruar).

Kujdestari i punës sime

Botuesin e gazetës, Muhamet Mavraj, para se të vija në "Epokë" e njihja pak. Më shumë më kishin folur për fytyrën dhe karakterin e tij të tjerët sesa që isha interesuar ta njihja vetë. Ai, në vitet 2007, 2008, 2009, edhe para këtyre viteve, vinte vonë në gazetë dhe rrinte deri në mëngjes. Hapat dhe frymën e tij i dëgjonim dhe ndienim tekta ngjitej shkallëve, tekta kalonte korridorit të ngushtë dhe të gjatë. Kishte net që nuk bënte asnjë sy gjumë. Sa rrinte aty pinte çaj, pinte kafe, pinte cigare. Ujë, rrallë. Bukë hante edhe më rrallë. Kotej në karrige. Lexonte në karrige dhe në dyshe. Kur vinte mbrëmja, pasi redaktorët i redaktinin tekstet e unë i lekturoja, hynte edhe një herë në to vrap dhe gabimet që i kishin lëshuar ata dhe i kisha lëshuar unë i përmirësonte. Në vitin e parë punës sime i ka ndenjtur gati shumë. Kam mësuar shumë nga ai për gjuhën shqipe. Unë punoja shpejt, por s'bëja lekturë aq të mirë sa ai. Pak, po arsyetohem tash për atë kohë, më dukej ngarkesë t'i lekturoja 32 faqe për tri-katër orë në vitin e parë. Por, me përkrahjen e përcdonatshme të tij, për rreth një vit e gjysmë bashkëpunim dhe vendosmëri, pa hatërmbetje, u bëra më i mirë sesa ai sepse ia nxora nga zyra "Fjalorin e shqipes së sotme", "Fjalorin e drejtshkrimit", revistën "Gjuha shqipe", disa vëllime të materialeve për gjuhën paraqitur dhe botuar në Seminarin e Gjuhës Shqipe e disa libra të tjerë, kryesisht për gjuhën, të cilët i kishte lexuar dhe nënvizuar me laps dhe ngulitur në mendje rregullat e tyre. Dikur, kur kishte tjetër çfarë të bënte, kur i shkruante dy punimet e diplomës së masterit e dy të doktoratës e punimet e seminarit, nuk e bënte me punën e kujdestarit të gjuhës shqipe. Sa herë që s'i kontrollonte tekstet aq herë ndiheshia i pasigurt për punën e bërë. Ma besoi dhe ma la në duar redaktuarën gjuhësore të gazetës për 13 vjet, hu kalli vetëm! Të tjerëve, menaxhimin e saj dhe publikimin e saj. Mavraj, si sot, si në ditët e para kur e njoha, është i njëjti njeri: i thjeshtë, i ndershëm, i vendosur. Kur më zë në ndonjë qoshe, pasi unë i zë të tjerët në qoshe dhe përplasem me ta me shkrime për probleme, më porositë: "Mos i godit njerëzit kur rrezohen përtokë. Po pate mundësi ndihmoju". Kam mësuar edhe nga këto fjalë. Edhe nga kjo rregull jete, e lindur nga përvoja e tij. Nuk ka dalë një gazetar nga kjo medie të ketë shkruar diku tjetër e të ketë thënë "ai na ka nxitur të shkruaj keq për ju". Problemeve të mëdha dhe temave të mëdha u ka rënë me emër të vet. Me buxhet të vetin, kur s'ia jepnin mundësinë mediat e tjera, ia ka shtrirë dorën edhe shokut të vet më të ngushtë - atij të kauzës së përbashkët - Albin Kurtit, Lëvizjes së tij Vetëvendosje, së cilës i publikonte një herë në

javë një shtojcë me reagime dhe kundërshtime të fuqishme ndaj pushtetit. Këto nuk harrohen. Këtë rebelizëm të Albinit dhe të Vetëvendosjes, po ritheksoj, për shkak të ruajtjes së bashkëpunimit me institucione shtetërore dhe drejtues të tyre, nuk e shprehin në hapësirën e vet gazetave të tjera. "Epoka", po.

Vakitë me "Dajën"

Pjesën më të madhe të kohës, prej 13 vjetëve të mia punë, e kam kaluar me Shkëmbim Krasniqin - "Dajën". "Dajën" dajë nuk e ka pasur dhe as nuk e ka kush në gazetë. Shok, të gjithë. Nja pesë vjet shpeshherë bashkë kemi fjetur në një shtrat. Dhe meqë ishte djalë i mirë dhe i familjes së mirë u bëra mesit dhe të vëllait të tij i nxora për grua çikën e xhaxhit të babait. Meqë "Daja" udhëtonte për çdo ditë me një veturë "Golf 3" (GTI) nga fshati Tërrpezë në Prishtinë dhe anasjelltas, doja që ndonjë ditë, kur ishte i dërrmuar fort nga lodhja në punë dhe për gjumë, sepse rrimin bashkë deri në mëngjes duke pritur daljen e gazetës nga shtypi, të flinim në banesën që kisha marrë me qira. Binim herët, kur zgjoheshin të tjerët e zgjoheshim vonë, kur binin të tjerët. Këtë punë të vonë e bënim shkak i vonës së punëve të Demirit në redaksi dhe të Mavrajt që s'i bëhej kurrë vonë sepse ishte i bindur, siç është edhe sot, se kurrë, për asnjë gjë, nuk bëhet vonë. As për shtypjen e gazetës.

Me "Dajën", gjatë pesë vjetëve të para të punës, shkonim në restorantin "Gizi" në Veternik. Rrogën e shpenzonim për qira, për të ngrënë, për të pirë birra dhe "Coca Cola", për të pirë cigare dhe kafe dhe për të blerë rroba. Edhe pse merrnim shumë para nuk dinim të kursenim aspak. Jeta e natës ishte më e kushtueshme se jeta e ditës. Por, jeta nuk planifikohet. Mund të ndodhë ndonjë e papritur që ta prish krejt planin. Prandaj ne shpenzonim shumë, por nuk shpenzonim para për drogë dhe për kurva. "Daja" as për dashnore, se e kishte gruan e nja dy fëmijë, kurse unë shpenzoja edhe ndonjë para për dashnore, se ende isha "free". Pastaj, pasi e bleva veturën e tij të shpejtë "Golf 3", e zura një vajzë dhe e bëra grua dhe e lashë me barrë. Jeta ime mori kthesë tjetër dhe rrëfim tjetër. Po një prej rrëfimeve të "Dajës" e kam të regjistruar në mendje. Ai shpeshherë e përmend sepse shpeshherë ia kërkoj. Ai tregon se një ditë paratë për shtypjen e gazetës botuesi i kishte shpenzuar. Megjithatë, ai punonte edhe për numrin e nesërm pa e pasur asnjë metelik në xhep. Veresi gazetën s'e shtypte askush. Kursime shefi nuk kishte. Pasuri të patundshme jo. Teshat e trupit veshur, një orë dore, libra dhe fletore e lapsa, me bollëk, të cilat mund t'i kushtonin shumë



Shkëmbim Krasniqi: Urime, Mavraj, 20-vjetori i gazetës dhe të 6000 numrat e saj! Kemi bashkëpunuar shumë dhe gjatë për këtë shtëpi mediale të përbashkët, në kohë shumë të vështira, për të cilën, siç ke thënë jo pak herë, unë kam bërë shumë punë, por punën më të madhe dhe problemet i ke pasur mbi kokë e në lëkurë më së shumti vetë. Ti je arkitekti i saj dhe për sa kohë që ti je gjallë, mua do të kesh mbrapa, si deri më sot, edhe 60 000 numra të tjerë. Vetëm lutem të kesh shëndet të mirë e jetë të gjatë. Secilit koleg, urime ditëlindja e "Epokës së re"!

pak po qe se do t'i nxirrte në ankand. E kishte edhe veturën "Opel Omega" e cila edhe nuk punonte mirë, edhe shpenzonte shumë. Për ta botuar gazetën në ditën e premte, Mavraj e kishte porositur "Dajën" ta nxirrte veturën në shitje dhe ta shiste sa për t'i botuar pesë-gjashtë numra të gazetës. Të enjten, pasi e kishte dorëzuar gazetën në shtyp dhe kishte pritur, deri në orën 4.30 të mëngjesit, derisa të ngarkoheshin ekzemplarët në kombit e rrjetit shpërndarës të "Rilindjes", ia kishte mësyre tregut të madh të Malishevës që hapej të enjten. Kishte mbërritur në treg herët. "I treti, - thotë, - kam hi në parkingun e pazarit". Pasi e ka lënë veturën aty dhe i ka mbyllur dyert, ia ka krisur një gjumi të rrallë e të gjatë. "Kam hi n'pazar, i kam mshel dyert e kerrit dhe ia kam fut gjumë. M'ka dalë gjumi n'pesë n'mbramje. Kur jam qu, asni njeri n'pazar. Krejt dy-tri kerre e trekatër njerëz. E kam dhezë kerrin dhe ia kam msy Prishtinës. Halli tash, çka me i tha shefi! Nëse më thotë a veti kush për kerr, çka me i tha? Erdha n'redaksi dhe pas pak kohe erdh shefi. Më veti: 'Dajë, a e shite kerrin?' Duke u rrëqeth i thashë: 'Jo vallai shef, se kërkush s'më ka vet'. Dhe nime s'më ka vet kërkush. Nashta ka ardh najkush te kerri, po njerin e lemë ni s'e kam. Isha kanë ba qull. U nisha keq tash për gazetë. Shefi dojke me e shit edhe kerrin veç për me shtyp gazetën. Po, ma në fund, ai prapë ia nisi me punu për gazetë dhe unë me faqos dhe i bamë paret dhe e çumë gazetën në shtypshkronjë dhe e shtypëm".

Doja të hapja portal, e botova një revistë

Dy vjet më parë fort me që mbushur mendja të hapja një media elektronike. I numëroja në gishta të dorës e të këmbës disa "askusha", disa ish-nxënës,

disa ish-studentë dhe disa ish-gazetarë të dobët që, nëpërmjet portaleve, por nëpërmjet servilitetit të pashoq, ishin bërë "dikusha", ndonjëri prej tyre duke u tërhequr si zvarranik përballë të pasurve dhe të pushtetshmëve, ndonjëra duke zgatur duart e gjithë trupin drejt tyre, duke shkelur parimet njerëzore dhe gazetareske! Natyrisht, nuk doja të bëja një media të tillë, as të punësoja zvarranikë dhe parazitë. Njerëz të ndershëm, të mençur dhe punëtorë, po. Por, ato ditë sa mendoja për këtë media, u çua dhe erdhi afër gazetës së vet, "Epoka e re", botuesi i saj dhe në prani të profesor Ekrem Kryeziut, në restorant "Mexicano", na thotë mua dhe "Dajës": "Sa të jem gjallë unë do të jetë gjallë edhe 'Epoka e re'. Dhe sa të jetë gjallë 'Epoka e re' do të jeni ju këtu, me këto kushte pune e me këto paga si deri sot. Nëse gjeni ndokund tjetër më mirë, kallëzomëni". As unë e as "Daja", edhe pse atë qenë përpjekur ta merrnin punëtor shumë vite më parë disa botues gazetash, edhe mua më patën ardhur disa oferta ndër vite nga media të tjera, s'kemi provuar të shkojmë tjetërkund. Të bëja një medie timen, po. Dhe e bëra, e fillova botimin e revistës "Akademia", për të cilin përkrahje më kanë dhënë botuesi dhe drejtori, të cilët ka kohë që nuk i kam më shefa. I kam familjarë. U kam dhënë dhe më kanë dhënë bukë. Kam ndarë gëzime dhe pikëllime me ta. Jam familjarizuar. Jemi bërë një. Jemi bërë grusht. Dhe jemi bërë më të fortë. Rrofshin! "Epoka e re" dhe Muhameti paçin shëndet të mirë dhe jetë të gjatë, edhe ju kolegë të mirë e të sjellshëm! E festofshim 100-vjetorin e saj! Nëse ne jo, trashëgimtarët gjithqysh! Gëzuar!

EPOKA E RE (2000-2020)

(Gazetarët dhe ish-gazetarët e "Epokës së re" gjatë njëzet vjetëve. Ndonjë mund ta kemi harruar)

- | | |
|------------------------|-------------------------|
| 1 Afet Bela | 86 Jasemina Mulaku |
| 2 Aferdita Maliqi | 87 Jehona Veliu |
| 3 Agim Muhaxheri | 88 Jetlir Zyberaj |
| 4 Ahmet Bilalli | 89 Jeton Kelmendi |
| 5 Ahmet Tmava | 90 Jeton Musliu |
| 6 Alban Zeneli | 91 Jeton Osmanaj |
| 7 Albert Ademi | 92 Jeton Rushiti |
| 8 Albert Shala | 93 Jeton Mazrekaj |
| 9 Albulena Mavraj | 94 Kimete Islami |
| 10 Arben Atashi | 95 Kimete Krasniqi |
| 11 Arben Mlinaku | 96 Kreshnik Sylejmani |
| 12 Arbenita Kamberi | 97 Kujtim Shala |
| 13 Arbër Grabovci | 98 Liridon Ibërdemaj |
| 14 Arbert Abdyl | 99 Lirije Klaiqi |
| 15 Arbresha Baftiu | 100 Lirim Geci |
| 16 Argjin Kelmendi | 101 Lulzim Ahmeti |
| 17 Arieta Gashi | 102 Lulzim Etemaj |
| 18 Arizona Dibra | 103 Lulzim Sahiti |
| 19 Arlinda Sejdiu | 104 Mal Qorraj |
| 20 Arsim Lani | 105 Malsore Llapashtica |
| 21 Arsim Osmani | 106 Mangji Gashi |
| 22 Arsim Sinani | 107 Marin Kelmendi |
| 23 Arta Sylejmani | 108 Melisa Demiri |
| 24 Artan Mustafa | 109 Mentor Gjoni |
| 25 Astron Mahmutaj | 110 Mentor Shala |
| 26 Avdullah Hoxha | 111 Mihrije Krap |
| 27 Avni Azemi | 112 Milaim Syl |
| 28 Avni Makolli | 113 Milazim Kadriu |
| 29 Aziz Bytyçi | 114 Mimoza Hoxha |
| 30 Bajram Lani | 115 Minire Berisha |
| 31 Bajram Smakaj | 116 Miradije Aliu |
| 32 Behram Krasniqi | 117 Miradije Gashi |
| 33 Bekim Ademi | 118 Muhamet Jahiri |
| 34 Beqir Beqaj | 119 Muhamet Koci |
| 35 Berat Dakaj | 120 Muhamet Mavraj |
| 36 Besart Krasniqi | 121 Musa Ramizi |
| 37 Besim Muhadri | 122 Musa Sabedini |
| 38 Besnik Dema | 123 Musli Krasniqi |
| 39 Besnik Krasniqi | 124 Myrvete Haxholli |
| 40 Bislim Berisha | 125 Naim Zeqiri |
| 41 Blerim Çoçaj | 126 Naim Behluli |
| 42 Blerina Veseli | 127 Nexhat Çoçaj |
| 43 Burim Etemaj | 128 Nexhat Krasniqi |
| 44 Daut Gashi | 129 Nexhmije Ahmeti |
| 45 Demir Reshiti | 130 Ngadhjim Ademi |
| 46 Donika Bunari | 131 Nijazi Ramadani |
| 47 Driton Bubaku | 132 Prend Buzhala |
| 48 Driton Hajrizi | 133 Qemajl Krasniqi |
| 49 Driton Kamberi | 134 Qëndresa Fazliu |
| 50 Driton Lajçi | 135 Qëndresa Mustafa |
| 51 Driton Leku | 136 Qëndresa Rama |
| 52 Driton Paqarada | 137 Qerim Rexhaj |
| 53 Ekrem Kryeziu | 138 Ragip Guraziu |
| 54 Elmedina Ballazhi | 139 Ragip Gjoshi |
| 55 Emine Rushiti | 140 Ramize Murtezi |
| 56 Enver Maloku | 141 Rexhë Hasani |
| 57 Eranda Nepravishita | 142 Rexhep Tërshnjaku |
| 58 Ernest Luma | 143 Ridvan Berisha |
| 59 Fahri Axhalena | 144 Rifat Buzuku |
| 60 Fatma Restelica | 145 Rifat Sadikaj |
| 61 Fatmir Bytyçi | 146 Rinor Beka |
| 62 Faton Dermaku | 147 Rrahman Jasharaj |
| 63 Faton Polisi | 148 Rrushe Haxhaj |
| 64 Fazli Muharremi | 149 Sabahate Shala |
| 65 Fehmi Ajvazi | 150 Sadete Bajrami |
| 66 Fehmi Baftiu | 151 Sadik Zeqiri |
| 67 Fehmi Gegaj | 152 Safete Makolli |
| 68 Fehmi Sylejmani | 153 Sali Beqiraj |
| 69 Fehmi Maloku | 154 Saranda Geci |
| 70 Fidajete Geci | 155 Seman Shala |
| 71 Florije Ademi | 156 Sheribane Hashani |
| 72 Ganimete Muli | 157 Shkelzen Çoçaj |
| 73 Gazmend Morina | 158 Shkëmbim Krasniqi |
| 74 Gëzim Pozhegu | 159 Shpend Çoçaj |
| 75 Haki Hysenaj | 160 Shqipe Hetemi |
| 76 Hamdi Miftari | 161 Skender Idrizi |
| 77 Heset Zymberi | 162 Tomor Grabovci |
| 78 Hysni Syl | 163 Uran Krasniqi |
| 79 Igballe İmeraj | 164 Valdete Elshani |
| 80 Ilir Kabashi | 165 Veton Zymberi |
| 81 Imer Mushkolaj | 166 Xhavit Nura |
| 82 Islam Haxhiu | 167 Xhevdet Fetahu |
| 83 Ismail Gagica | 168 Yllidje Sulka |
| 84 Ismail Rexhepi | 169 Zanë Zyba |
| 85 Jahja Tmava | 170 Zymer Osmani |

Zoti Grenell, mos doni rastësisht t'ju dërgojmë edhe për pushime në det!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Mjerë i ligu, sa i fort është: Dikush ka vendosur ta bëjë një marrëveshje përfundimtare midis Kosovës dhe Serbisë, pa e pyetur fare Kosovën. Dikush që llogaritet të jetë shumë i fuqishëm ka vendosur ta bëjë marrëveshjen sipas modelit Izrael - Palestinë e në rastin konkret Serbia po trajtohet sikur të ishte Izraeli kurse Kosova sikur Palestina. Dikush po bënë përpjekje që tokat e okupuara palestineze nga Izraeli t'ia kalojë në pronësi të Izraelit sikur që tokat e Kosovës e që janë okupuar pas përfundimit të luftës nga Serbia, t'ia kalojë Serbisë. Në Kosovë, më herët lëshuarja e dokumentit mbi pronësinë e tokave të okupuara nga Serbia kamuflohej si korrigjim i kufijve, herë i lehtë e herë i rëndë!

Për këtë duket të ishin marrë vesh Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiqi. Ishte caktuar edhe koha dhe vendi kur dhe ku do të nënshkruhej marrëveshja sikur që ishte caktuar edhe përmbuesi e ai ishte Donald Tramp, president i ShBA-ve. Hashim Thaçi, pasi ta kishte bërë punën m.t me korrigjimin e kufijve, do të parfumohej në Uashington në Parkun me Trëndafila ku llogaritej të përmbylej procesi i funeralit të tërësisë territoriale të Kosovës. Taksa 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja e Dodikut e ndërpreu këtë masakrim të territorit të Kosovës dhe kjo është merita ekskluzive e Ramush Haradinajt dhe Kadri Veselit, që e vendosën taksën, më vonë Ramushi e mbrojti taksën përkundër presioneve që ajo të hiqej. Besoj, se pas një kohe, kur të hapen letrat do të vlerësohet roli i taksës 100 për qind, e cila duket vetëm përkohësisht e ndali copëtimin e territorit të Kosovës. Edhe bisedimet, ato publike midis Kosovës dhe Serbisë u ndërpreën kurse ato të nëntokës politike asnjëherë nuk u ndërpreën. Serbia e kushtëzonte vazhdimin e bisedimeve me largimin e taksës dhe këtë e

kërkonin me këmbëngulje, edhe armiq të sikur edhe "miqtë" e Kosovës. Derisa Qeveria Haradinaj ra nga pushteti! U mbajtën zgjedhjet e 6 tetorit 2019 pas së cilës u krijua një gjeografi e re politike. Ende pa u formuar institucionet e reja bëhej presion mbi Albin Kurtin që ta largojë menjëherë taksën 100 për qind dhe të vazhdojë bisedimet me Serbinë për një arritje të një marrëveshjeje përfundimtare me ç'rast përmendej dhe ende vazhdon të përmendet një kompromis i dhimbshëm thuaja se Kosova paska bërë pak kompromise, në dem të saj, pa asnjë dyshim. Edhe Aleksandar Vuçiq, një kriminel luftë po kërkon gjithashtu kompromis duke deklaruar se: "nëse nuk bisedohet për kufij, atëherë nuk ka pse të bisedohet...". Në ndërkohë, presidenti Tramp caktoi dy emisarë: Metju Palmer për Ballkanin pjesë e së cilës janë Kosova dhe Serbia dhe Riçard Grenell, ambasador i ShBA-ve në Gjermani, emisar për bisedime midis Serbisë dhe Kosovës. Riçard Grenell, gjatë vizitës së parë në Kosovë u portretizua si "buldozher diplomat" apo si "Holbruk diplomat" për të frikësuar këta që po bëjnë përpjekje të bëjnë politikë në Kosovë. Pastaj tha se është i mbijetuar nga kanceri me porosi se: "nëse e kam hëngër kancerin, juve as që ju llogarisë si kundërshtarë...". Politikanët në Kosovë, edhe ashtu e pranojnë çdo propozim që vjen nga ShBA, pa e lexuar fare prandaj Grenell nuk ka nevojë të na kërcënojë, as me arte marcialle, as me "buldozher diplomat", as me mundje të kancerit e as me bllokim të fondeve..."

Kosova është vend i vogël për ta kërcënuar aq shumë dhe aq ashpër. Se Grenell e ka mundur kancerin është fat i mirë për të dhe familjen e tij dhe është rast interesant për mjekësi por kjo nuk nënkupton se kjo mund dhe duhet të përdoret si mjet presioni dhe kërcënimi për largimin e taksës 100 për qind dhe arritjen e çfarëdo marrëveshjeje me Serbinë pikërisht në vitin kur në ShBA mbahen zgjedhjet presidenciale ku, edhe pa Kosovën duket se Trampi do ta fitojë edhe një mandat. Jam i sigurt se do ta fitojë edhe një mandat! Albin Kurti dhe LV-ja gjatë fushatës

elektorale kanë premtuar se do ta largojnë taksën 100 për qind dhe se këtë do ta zëvendësojnë me masën e reciprocitetit. Nëse Serbia dhe bashkësia ndërkombëtare e kanë kundërshtuar taksën 100 për qind shumë herë, reciprocitetin do ta kundërshtojnë 1000 herë! Kryeministri Kurti, bashkë me partnerin qeverisës do ta largojë taksën por duket se kjo për Grenellin nuk mjafton; ai kërkon largimin e taksës 100 për qind sikur që e kundërshton vendosjen e reciprocitetit ndaj Serbisë. Nëse Kurti, si drejtues i Qeverisë së Kosovës është deklaruar për reciprocitet, partneri LDK-së ka hezitime në këtë drejtim, duket se është më afër qëndrimit të Grenellit, se të kryeministrit. Do ta shohim, shumë shpejt! Grenell është arrogant dhe shpërfillës ndaj politikanëve kosovarë; e përkrah kryeministrin për largim të taksës kurse e kundërshton për reciprocitet! Në fakt, ai, Grenelli nuk bashkëbisedon, ai urdhëron dhe ai kërcënon. Shiheni nivelin e komunikimit me kryetarin e PDK-së, ish-kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli! Me të sillet sikur Grenelli i ka caktuar të lexojë Bagëti dhe Bujqësi por të mos i dhënë asnjë mundësi apo të drejtë ta bëjë një ese për këtë. Kështu sillet dikur edhe ambasadori Dell, një kusar në diplomaci që nuk ka lënë gjë pa bërë në Kosovë, që nga përpilimi i rendit të ditës e deri te ndarja e tenderëve për ndërtimin e autorregës kombëtare përmes konsorciumit Beht Dell Enka, çmimi i së cilës ishte sikur autostrada të shtruhej me tepihë dhe ngrohje nën të! Uroj që çështja e Kosovës të mos zgjidhet sipas projektit të Tramp dhe Grenell duke e imponuar modelin Izrael - Palestinë! Grenell, në këmbim të largimit të taksës 100 për qind dhe mosvendosjes së reciprocitetit, për Kosovën nuk ofron asgjë përveç një marrëveshjeje të dyshimtë, që nuk e zgjidhë çështjen fare, që do të bëhet me kompromis të dhimbshëm ku mbase, Kosovës do t'i merrej një pjesë e territorit apo do t'i hiqej mundësia për ushtrim të sovranitetit përmes Zajednicës dhe, në të njëjtën kohë Zonat e Mbrojtura do të përdorehin si mekanizëm kurdisës të një bombe që do të shpërthente çdoherë kur për këtë Beogradi do të ketë nevojë!

Pozita dhe opozita, bashkëpunimi dhe kundërshtimi: Në Kosovë, pas zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 kemi përmbysje të pushtetit, opozita u bë pozitë kurse pozita u bë opozitë! Partitë opozitare PDK-ja dhe AAK-ja, ende pa u certifikuar rezultatet e zgjedhjeve u deklaruan se pranojnë rezultatit dhe se kalojnë në opozitë e që ishte, sa e papritur aq edhe pozitive për një mjedis të kontaminuar politik ku kundërshtarët konsideroheshin si armiq. Pozita aktuale kaloi nëpër "vuajtjet e Tantalit" deri te marrëveshja për bashkëqeverisje dhe ndarje të posteve. I dha shije të hidhur një idili të deklaruar gjatë dy viteve të fundit midis LV-së dhe LDK-së. Nëse opozita e ndërmori në fillim një hap shumë pozitiv dhe gjerë, pastaj bëri gabime që e kundërshtonin hapin e parë, sidomos gjatë seancës së parë të Kuvendit të Kosovës. Është një rregull i pashkruar se çdo qeveri dhe qeverisje duhet t'i ketë 100 ditë besë e që, pastaj do të mund t'i nënshtruhej një kritike eventuale. Në rastin konkret nuk janë respektuar as 100 sekonda për ta sulmuar qeverinë dhe qeverisjen, ende pa u formuar dhe pa ndërmarrë asnjë veprim. Është krejtësisht normale që qeveria që vjen, si rezultat i zgjedhjeve, e ka programin qeverisës që e dallon nga qeveria e mëparshme, ndryshe pse do të mbaseheshin zgjedhjet! Qeveria Kurti ka dhënë shumë premtime dhe zotime e që, në disa raste janë në kundërshtim të plotë me mundësitë dhe rrethanat kur përmbushja e këtyre premtimeve varet edhe nga faktori i jashtëm dhe Serbia që ka kapacitet të madh bllokues. Opozita ende nuk po vepron si opozitë sepse është e ndarë. Mbase është fillimi dhe më vonë do të veprojë më e koordinuar. Edhe Qeveria është ende e pakompletuar, pa kapacitet të plotë veprues. Pozita duhet ta ketë shumë të qartë se edhe disa premtime elektorale të cilat janë të një interesi strategjik dhe kombëtar, nuk mund të përmbushen pa një konsensus politik dhe partiak. Kryeministri Kurti ka filluar ta bëjë një distancim të lehtë nga të vepruarit si opozitar dhe, në këtë kontekst po tregohet më i butë dhe më i "mëshirshëm" ndaj opozitës. Ndryshe edhe nuk bënë sepse nëse nuk do të sillet

në këtë mënyrë edhe në të ardhmen, situata do të përshkallëzohej deri sa edhe do të dali jashtë kontrolli. Deri më tani, kryeministri Kurti ka një fjalor të ekulibruar ndaj opozitës e që është në rregull në ndërkohë që opozita po përdorë një fjalor fyes. Vendimet që i merr qeveria Kurti e të cilat mund të kontestohen ligjërisht, opozita duhet t'i përdorë si argument siç bënë çdo opozitë duke i dërguar edhe në Gjykatë Kushtetuese. Lojërat që po bëhen rreth fotografisë së presidentit aktual nuk meritojnë vëmendje sepse aspak nuk i ndihmojnë pozitës por e dëmtojnë atë ndërsa e forcojnë presidentin sikur që përdoren edhe si municion për opozitën. Kosova ka probleme shumë më të mëdha se vendosja apo zhvendosja e fotografive të presidentit aktual. Shiheni transformimin e kryeministrit Kurti, nga kërcënimi për burgosje të presidentit Thaçi, tash e thërret për bashkëpunim dhe ndërtim të konsensusit për politikë të jashtme. Pozita dhe opozita duhet të ndërtojnë një raport bashkëpunimi për disa çështje që dodmosdoshmërisht duhet të bashkëpunojnë ndryshe do ta kemi një situatë sikur në Shqipëri. Albin Kurti nuk mund ta përjashtojë presidentin Thaçi nga roli i tij kushtetues e as nga bisedimet me Serbinë ku kërkohet një konsensus i gjerë shoqërorë, politik dhe jopolitik! Kosovën e presin shumë sfida dhe shumë probleme për t'i mbuluar me një eufori të çastit apo ndonjë veprim kozmetik! Së pari duhet të miratohet Buxheti dhe kontributi i opozitës është i domosdoshëm. Pastaj, pastaj fillon llogaridhënia për mospërmbushje të premtimeve eventuale. Është pozitive se nuk ka qasje hakmarrëse të pozitës ndaj opozitës, së paku në nivele të larta. Këta që e luajnë rolin e zhurmuesit, janë të përkohshëm dhe nuk kanë ndonjë peshë në vendimarrje. Opozita duhet të pajtohet me situatën e re dhe duhet të jetë konstruktive, të përkrahë qeverinë kur punon mirë dhe t'i rrijë mbi kokë kur dështon! Opozita duhet të lirohet nga fjalori fyes duke gjetur mënyra krejtësisht të reja të të bërit opozitë. Nëse opozita përpiqet të riciklojë metodat e të bërit opozitë siç bëri LV-së atëherë, që tani e them se do të dështojë. Ato ishin kohëra tjera,

tash janë procese dhe projekte tjera. Po, është shumë herët dhe e pandershme të nxirren përfundime dhe të jepen vlerësime, si për punën e Qeverisë Kurti ashtu edhe për opozitën. Të presim, së paku nja 120-160 ditë! Ashtu patëm vepruar me të gjitha qeveritë e mëparshme, mos të bëjmë as tani përjashtim! Deri atëherë mendoj se Qeveria e Kosovës, as nuk duhet ta largojë taksën 100 për qind as të vendosë reciprocitetin!

Kameleonizmi politik dhe prostituiimi praktik: Në çaste të krizave martesore më së lehti tradhetojnë, edhe burri, edhe gruaja. Kur uji është i turbullt më së lehti peshkohen peshqit e mëdhenj. Ku ka mjegull, ujku e bënë kërdrinë dhe kur bëhet përmbysja e pushtetit, në sipërfaqe dalin prostitutat politike dhe jopolitike. Gjatë votimit për Qeverinë Kurti, opozita nuk votoi përjashtuar dy deputetë të AKR-së. Behgjet Pacolli e dha arsyetimin se këtë e bënë për shkak se është pozitiv (mbase mendon se nëse jeni Rh pozitiv ajo automatikisht ju bënë person pozitiv), se është konstruktiv (ndërtues) në kohën kur Ministrinë e Jashme e ka shkatërruar duke e shndërruar në një Çernobil diplomatik. Këtë nuk e konsideroi si vardisje ndaj pushtetit në ardhje e që unë mendoj se është pikërisht një vardisje e nivelit më të ulët apo vardisja e parë. Së dyti, gjatë dorëzimit të detyrës ministrit në ardhje të Ministrisë për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Glauk Konjufcës por edhe kryeministrit Kurti ua vuri në dispozicion aeroplanin e tij privat, jo për të shkuar në kanaxheqe dhe dasma por për të lobuar për njohje të pavarësisë së Kosovës. Kjo ishte, brenda një kohe të shkurtër vardisja numër tre dhe më e ulët se ajo e para. Vardisja e tretë apo hat-tricku i vardisjeve ishte përkrahja e tij që ia bënë kryeministrit Kurti për propozimin e këtij të fundit drejtuar presidentit Thaçi për koordinim dhe veprim të përbashkët për të ndërtuar një politikë të jashtme unike! Këtë e arsyetoi me faktin se, pikërisht për shkak të mungesës së një koordinimi të tillë, ai, Pacolli nuk ka mundur të jetë efikas në kryerjen e detrave si ministër për Punë të Jashtme. Në një mënyrë po bënë përpjekje t'ia hedhë Hashim Thaçit i cili e bëri edhe president, edhe zëvendëskryeministër dhe Ministër në kundërshtim të plotë me normat morale, interesin shtetërorë dhe kombëtar. Arsyetim shumë i ulët, të mos them, kanalizim fare! Për një njeri që respekton edhe kodeksin minimal moral, miqtë mbesin miq edhe kur mbesin pa pushtet, edhe kur janë në pushtet!

Makroshengeni shqiptar apo minishengeni ballkanik



Bedri ISLAMI

Të martën në Tiranë u takuan dy shefat e qeverive, të Shqipërisë dhe të Kosovës, Rama dhe Kurti. Ishte një takim i paralajmëruar, nga i cili, ashtu si pritej, nuk kishte asgjë të re, veç një linje protokollare, që ka ndodhur thuajse me të gjithë liderët qeveritarë. Si për t'i treguar Kurtit se pak gjë ka ndryshuar në qëndrimin e tij, Rama, në radhën e ministrave që prisnin të shtrëngonin duart me kryeministrin e Kosovës, kishte nxjerrë edhe dy prej tyre që vinin nga Kosova, dhe që më parë kishin qenë pjesë e Lëvizjes së tij, LV-së. Mëria politike shqiptare zgjat më tepër se sa zakonisht mëria njerëzore.

Rama dhe Kurti janë dy figura politike që kanë të përbashkëtat dhe të veçantat e tyre. Rama, megjithëse me një fillësë politike nacionaliste dhe kundër së majtës, sot drejton forcën politike më të madhe të së majtës në Shqipëri dhe përshtafja e tij është bërë tashmë kozmopolite.

Kurti, megjithëse drejton një forcë politike të së majtës, përshtafja e tij politike është thellësisht nacionale. Rama drejton një forcë politike, të cilës i dëshironte fundin në vitin 1991, por që e gjeti të strukturuar, Kurti, nga ana tjetër, e ngriti Lëvizjen e tij, duke qenë njeriu rreth të cilit u mbledhën militantë të rinj. Rama njihet si mik i afërt i presidentit të Kosovës, Thaçi, që është kundërshtari kryesor i Kurtit, ndërsa Kurti mbështet kundërshtarët më të njohur të Ramës në Shqipëri, Berishën dhe Metën. Koha kur shefi i qeverisë Rama, e konsideronte Albin Kurtin politikanin më të çmuar në Kosovë, apo kur Kurti pritej krahëhapur në kabinetin e Ramës, ka përfunduar.

Të dy, duan apo nuk duan, janë të detyruar të takohen. Të dy, shpesh herë, duke folur me tonin e lirisë, zgjojnë autoritarizmin. Takimi i djeshëm, ndër më të shkurtrët në kohë që ka pasur një kryeministër i Kosovës, vendosi përballë njëri tjetrit dy figura politike, të cilët, edhe pse mund të duken se kanë nisur një bashkëmarrëveshje të rëndësishme dhe në konferencën e përbashkët për mediat kërkuan të mos zbulojnë këmbët lakuriq, përsëri i nxorën gishtat.

Fytyrat e ngurosurat të dy shefa qeveritarë treguan më shumë se sa fjalët e tyre. Duke bërë një detyrë shtetërore, për të cilën paguhen, ata nuk e lanë mënjatë mërinë, e cila, si duket, do të zgjatet. Edi Rama, edhe pse nuk e

përmendi si një të drejtë ekskluzive të tij minishengenin, trajtesa që ende askush nuk e di se si lindi dhe pse ishte kjo ngutje në lindje, dëgjoji homologun e tij, në të njëjtën gjuhë, të fliste për makroshengenin shqiptar, si një nisje paraprake e minishengenit ballkanik.

Është jo vetëm një përbashkësi fjalësh. Është më shumë se kaq: është përbashkësi idesh, vizionesh dhe qëndrimesh për një çështje të rëndësishme që ka të bëjë me kombin, qëndrimin ndaj fatit të tij, prioritetet e një kohe të caktuar dhe, mbi të gjitha, me radhën e punëve që duhen zgjidhur.

Kontradiktat mes Ramës dhe Kurtit janë të njohura. Ende nuk dihet se çfarë është folur në kabinetin qeveritar, ku me siguri nuk është luajtur basketboll, por ajo që u përshfaq në pak minuta, është e mjaftueshme për të kuptuar se, edhe më tej, në këtë hapësirë, kundërshtitë për një çështje madhore, si ajo e vendosjes së idesë së kombit mbi kozmopolizmin; e të përbashkëtës ndaj së veçantës, e fillësës ndaj përfundimit, e mendimit të qartë ndaj ngutjes, do të kenë një vend të mëtejshëm dhe do të vazhdojnë të jenë hendek që nuk do të mbushet lehtësisht.

Shqiptarët, qofshin në shtetin amë, apo në Kosovë dhe vise të tjera të banuara prej tyre, nuk identifikohen lehtësisht me shtetin. Kjo mund t'i mvishet rrethanave se, në këto vende shqipfolëse, pavarësisht se nën cilin regjim, qeveritë kanë qenë zakonisht të këqija ose shumë të këqija, ose faktit se nocioni shtet është ende një abstragim, i papërceptueshëm, i panevojshëm, që nuk ka pasur staturën e tij në vetëdijën tonë. Shqiptarët e kanë pasur më të lehtë të jenë një individ, se sa një nënshtetas.

Koha e tashme i ka vënë ata përballë dy ideve, të cilat, edhe e kundërshtojnë, edhe e qarkojnë njëra tjetrën. Partitë politike në Kosovë, thuajse njëzëri, kanë qenë kundër Minishengenit, pasi e ndjenin veten të përjashtuar në këtë lëvizje apo staturë të re politike, por si gjetje e vjetër. Përdallimi në qëndrim mes Kurtit dhe Ramës nuk është thjeshtë mes individit dhe shtetarit, por edhe mes përfaqësimit të atij grupimi shqiptar që ka vuajtur një periudhë të gjatë nga shteti serb, makineria pushtetore e tij, dhe të grupimit tjetër, i cili e ka përjetuar nga larg, sado me dhimbje.

Kurti e di fare mirë se pa rolin e shtetit shqiptar Kosova nuk do e kishte fituar luftën dhe as paqen, por nuk do që të humbasë në paqe pikërisht atë që është fituar në luftë: të drejtën e vetëvendosjes! Politika e tij kalon përmes makroshengenit shqiptar, pra, përfaqësimit të kombit në një zë të vetëm, edhe pse përmes dy a

tri figurave politike në shtete të ndryshme, por, me të njëjtin zë; ndërsa Rama e shikon ndryshe: ai e paracakton rolin e Kosovës së zë në vete, që ka të drejtë të kundërshtojë, të mosmiratojë, të vendosë veton e tij, të ketë mendim ndryshe nga sa mund të ketë shteti shqiptar, në fund të fundit, si dy njësi të mëvetme.

Kjo, sa mund të duket përparësi politike, aq është edhe veçim politik. Vizioni i Kurtit duket romantik, ndërsa i Ramës paraqitet si praktikizëm politik, por në fund të fundit, ajo që përjashtohet është shumë më e madhe dhe më jetike, se sa ajo që bëhet pjesë. Takimi Rama - Kurti nuk kishte kohë të rrokte tema të tjera, të cilat prej kohësh janë hedhur si dorashka politike në tryezat e ardhshme.

Rama, ndoshta nuk kishte kohë të sqaronte homologun e tij shqiptar, përse ndërlidhet mes dy vendeve nuk kanë rriten që ishte menduar; përse ai, Rama, aq befasisht dhe naivisht, deklaroi se kush është kundër Hashim Thaçit është një gomar; përse idetë e tij, të Ramës, për të ardhmen e Kosovës janë ende të pasqaruara, nëse është apo jo për lëvizjen e kufijve me shtetin serb, ashtu si mund ta ketë përgëzuar që Kurti po i kthehet idesë së vjetër të Ramës për heqjen e taksës ndaj produkteve serbe dhe boshnjake, për të cilën krijoi një përplasje me Haredinajn dhe është në pritje të një gjyqi?

As Kurti nuk ka pasur kohën e duhur për të sqaruar se çfarë do të thotë reciprocitet me një shtet që nuk të njeh, që të lufton me të gjithë forcën e tij, që ka vënë në dispozicion të Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës mijëra e mijëra dëshmi, shumë prej të cilave të rreme, si mund të ketë reciprocitet me një shtet që nuk të tregon se ku janë varret e të zhdukurve, që nuk të ka kërkuar ende falje për gjenocidin në Kosovë? A është reciprocitet vetëm ndalimi i fushatës serbe për ç'njohjen e Republikës së Kosovës?

Kurti, pas një vonese thuaj katërmujore për krijimin e qeverisë, ku mbisundoi ndarja e tortës së pushtetit, përmes lëvizjeve nganjëherë naive dhe deklarave jo serioze, e di fare mirë se tek një pjesë e elektoratit shqiptar nuk ka aureolën e pas 6 tetorit dhe se kthesa e tij ndaj së djathtës, nuk është rruga më e duhur e gjetur nga ai.

Rama, në Kosovë, është në pikiatën e mbështetjes së tij politike. Ai nuk është më njeriu që foli mes Beogradit për Kosovën e pavarur dhe as që mund të mendohet se në një kohë të shkurtër mund të ketë rishtas popullaritetin që nuk zgjati shumë. E keqja është se, përmes tij, njësohet edhe e majta shqiptare, e cila ka luajtur rolin e saj të jashtëzakonshëm gjatë

luftës në Kosovë, në përbashkëtimin e eksodit të shqiptarëve të Kosovës dhe ndërtimin e strukturave të paqes, për të cilën, Kurti kryeministër, duhet të kishte gjetur një fjalë falënderimi!

Këto dy njerëz, burra shteti, inteligjentë dhe të kundërt, tani janë të detyruar të punojnë me njëri tjetrin ose të largohen nga politika. Nuk kanë rrugë tjetër dhe as që mendohet se mund të ketë. Ata drejtojnë të dy, në dy anët e kufirit, republika presidenciale dhe, sado që të dy kanë një mëri të papërbalueshme ndaj presidentëve të tyre, barra e së ardhmes bie në shpatullat e tyre. Përpara vetes kanë një mori të problemeve që duhen zgjidhur dhe që, metoda e deritashme, me mbledhje të përbashkëta qeveritare, kudo që janë bërë, me plane pafund që mbesin në arkiva, duhet ndërruar urgjentisht.

Njerëzit, para se të prekin me duar të mirat e makroshengenit shqiptar apo ato që premtohen me minishengenin ballkanik, duan lëvizjen e lirë të tyre; lëvizjen e mallrave dhe fuqizimin e ndërlidhjeve tregtare, të cilat u rriten papërfillshëm edhe pse ndaj produkteve serbe u vendos taksa e njohur si e 100 për qindëshit, duan zgjidhje të menjëhershme të rritit të përbashkët energjetik, heqjen e kufirit, si një masë e domosdoshme e makroshengenit shqiptar, ndërtimin e politikave të përbashkëta arsimore, kulturore, në fushën e shëndetësisë dhe sidomos në ndalimin e zbrazjes së vendit nga gjeneratat e reja.

Pas vitit 1990 në politikën shqiptare, sidomos të Tiranës, ka pasur mendësi të mbivendosjes së mendimit politik shqiptar të Tiranës mbi atë të Kosovës, çka është e tejkualuar tashmë, por kjo nuk duhet të ketë fushëpamjen tjetër të saj: braktisjen dhe mos koordinimin politik e kombëtar.

Rama është në mesin e vitit të shtatë të qeverisjes së tij. Albin Kurti në ditën e shtatë të qeverisjes. Ata që kanë para vetes janë më të mëdha dhe më të rëndësishme se sa meritë politike, por edhe pa zemërimin e duhur politik nuk mund të zgjidhen problemet e mëdha që, ose i kanë vendosur vetë, në këtë rast, Rama, ose i kanë gjetur të tilla, në këtë rast, Kurti.

Droja e vetme është se, ndërsa nuk do të mund të merren vesh në gjuhën shqipe, të cilën të dy e flasin shkëlqyeshëm, do të mund të sjellin në një mendje në një gjuhë tjetër, si ndodh shpesh herë me politikanët shqiptarë. Për to, për politikanët shqiptarë, më e rëndësishme e ndoshta më e frikshme, është tundja e një gishti përtej Atlantikut, se sa gjetja e një zgjidhje serioze. A do e bëjnë në të ardhmen këtë Kurti dhe Rama?

E rrallë

Vendi më i qetë në botë! Jeta në shkëmbin e lartë 40 metra

E gjithë hapësira në krye mbulon vetëm 150 metra katrorë, dhe duke qenë se nuk ka ashensor, mund të arrihet vetëm me ndihmën e duarve, këmbëve dhe me pak fat. Shtylla e jetës, ose Shtylla Katskhi, është një monolit natyror gëlqeror në një fshat me të njëjtin emër në Gjeorgjinë perëndimore, i cili është i rrethuar nga Lugina e lumit Katskhura. Është rreth 40 metra i lartë dhe në krye të saj janë mbetjet e kishës së Shën Maksim, që daton nga shekulli i 9-të apo i 10-të, ka një kriptë, një bodrum vere dhe mbetjet e një



fortese të dikurshme. Në pamje, ajo kujton manastiret në retë: Kishin jetuar murgj që do të vdisnin më me qejf nga uria sesa të merrnin ushqim nga një grua. Ngjitja e parë e regjistruar ka ndodhur në vitin 1944, kur alpinistët Alexander Japardze dhe Levan Gotua e kishin gjetur trupin e një banori të mëparshëm në krye. Banori aktual në këtë vendbanim është prifti 67-vjeçar Maxim Qavtaradze, i cili ka bërë shkallët e improvizuara që zbresin dhe ngjiten në Shtyllën e Jetës dy herë në javë.

FOTO E DITES



Helikopteri i qeverisë siriane qëllohet nga një raketë në provincën Idlib të Sirisë. /AP/

E jashtëzakonshme

Roboti që nxjerr gjak, së shpejti kjo do të jetë e mundur

Testimi i parë i një roboti prototip për nxjerrjen e gjakut ka rezultuar të jetë mjaft i suksesshëm. Në të ardhmen, procedura e nxjerrjes së gjakut mund të jetë krejtësisht e ndryshme nga sot, procedura në të cilën stafi mjekësor largon gjakun me një gjilpërë të lehtë në një venë. Si shumë gjëra të tjera që janë zëvendësuar tashmë dhe që do të



zëvendësohen në të ardhmen, robotët gjithashtu mund të zëvendësojnë infermierët dhe, kjo falë teknologjisë së përparuar dhe inteligjencës artificiale, të nxjerrin gjak nga njerëzit. Pas provave të para nga shkencëtarët në spitalet Rutger dhe Mount Sinai, rezultatet janë më se pozitive.

BARSOLETA E DITËS



Pacienti: Doktor, jam shumë i shqetësuar!
Doktori: Qetësohu dhe më thuaj çfarë ke?
Pacienti: Një kinez ma ka dërguar kërkesën në "Facebook" për shoqëri. Çfarë të bëj?
Doktori: Mua mos më shkruaj më, ndërsa kinezit bëja bllok, se shkuam poshtë!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan




Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.

 <p>DASHI Do jeni me të dëshirueshëm se kurrë sot na partneri juaj dhe do kaloni momente të paharueshme pranë tij. Dita do jetë si një ëndërr e mrekullueshme. Beqarët nga ana tjetër do kenë takime pa fund.</p>	 <p>DEMI Ndjenjat për partnerin do jenë edhe më të thella sot. Do dashuroheni në pafundësi dhe çdo gjë do shkojë për mrekulli. Edhe beqarët nga ana tjetër do kenë dashuri me shikim të pare, megjithatë nuk duhet të nxitohen për asgjë.</p>	 <p>BINJAKËT Do të grindeni kot se kot me partnerin tuaj sot dhe dita do jetë e paqëndrueshme. Mos i kaloni limitet sepse do futeni në një tunel të errët. Beqarët edhe pse do kenë mundësi të shumta për takime nuk duhet të bëjnë asnjë çmenduri.</p>	 <p>GAFORRJA Asnjë planet nuk do ndikojë tek jeta sentimentale e çifteve sot, prandaj çdo gjë do varet nga sjellja juaj. Mos u tregoni impulsive dhe të paduruar. Beqarët do jenë gjithë kohës në kërkim, por nuk do e gjejnë atë që kanë ëndërruar gjatë gjithë kohës.</p>	 <p>LUANI Sot duhet të merrni në dorën fatin e jetës suaj në çift dhe duhet ta përforconi lidhjen që keni krijuar. Partneri do bëjë të njëjtën gjë dhe gjithçka do shkojë më së miri. Beqarët do kenë shumë mundësi të gjejnë personin ideal.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Do ndiheni mirë sot pranë atij që dashuron dhe nuk do tregoheni me tolerantë dhe më të kuptueshëm se disa ditë më parë. Beqarët më shumë gjasa do e gjejnë personin ideal dhe do ndihen të plotësuar në këtë plan.</p>
 <p>PESHORJA Ata që janë në çift do e adhurojnë personin që kanë në krah dhe do ndihen të gatshëm të bëjnë çdo lloj sakrifice për të qëndruar gjithë kohës me të. Beqarët do takojnë shumë persona që do i ngjajnë me atë që kanë ëndërruar, por në të vërtetë nuk do jenë të njëjtë.</p>	 <p>AKREPI Ditë e shkëlqyer për të dashuruarit. Momentet e lumtura do jenë të shumta gjatë kësaj dite kështu që shfrytëzoni sa më shumë që të mundeni. Beqarët do jenë mjaft tërheqës dhe do arrijnë ta bëjnë për vete personin që do pëlqejnë.</p>	 <p>SHIGJETARI Edhe pse partneri është shumë kokëfortë, sot do arrini të rivendosni bashkëpunimin në çift. Do tregoheni pak më tolerantë dhe të kuptueshëm me atë që keni në krah. Nëse zemra juaj është ende e lirë mundësitë për të gjetur personin e duhur do jenë të pakta.</p>	 <p>BRICJAPI Mos kërkoni gjatë gjithë kohës të jeni në qendër të vëmendjes dhe partneri të qendrojë gjithë kohës me ju sepse nuk do iu plotësohen dëshirat. Çdo gjë e ka një kufi, mos e tejkaloni atë. Beqarët ka mundësi të fillojnë një aventurë shumë të bukur dashurie.</p>	 <p>UJORI Nëse kohët e fundit jeni përballur me vështirësi dhe debate të forta në jetën sentimentale, sot ka ardhur koha t'i zgjidhni ato dhe të qetësoheni. Ai që keni në krah do kërkojë falje për gabimet që ka bërë. Beqarët do kenë takime joshës.</p>	 <p>PESHQIT Duhet të tregoheni më të sinqertë me partnerin tuaj gjatë kësaj dite nëse doni që emocionet të jenë edhe më të mëdha më vonë. Nëse nga ana tjetër jeni beqarë duhet të luani me sharmin dhe aftësinë tuaj joshëse.</p>

Mbretëresha kërkon që Harry dhe Meghan të kthehen për një ngjarje mbretërore



Princa Harry, Meghan Markle dhe Archie ndoshta do të udhëtojnë për në Britani së shpejti. "Sunday Times" ka raportuar se Mbretëresha Elizabeth II ka kërkuar që Sussexes të bashkohen me pjesën tjetër të familjes mbretërore për Ditën e Commonwealth në Westminster Abbey në Londër muajin tjetër. Kjo

ditë është vendosur të festohet më 9 mars. Çifti ka ndjekur të njëjtin shërbim vitin e kaluar së bashku me Princin William dhe Kate Middleton, kur Meghan ishte në tremujorin e tretë të shtatzënisë. Që nga largimi i tyre nga familja mbretërore dhe dorëheqja nga titujt mbretërorë, ata pritet të kthehen për angazhimet e tyre të fundit.

51 vjeçare dhe joshëse! Jennifer Aniston: Tani dua fëmijë



Ka mbushur 51 vjeç, por bukuria dhe joshja e Jennifer Aniston duket se nuk duan t'ia dinë. Në një set fotografik për revistën "Interview" në të cilën intervistohet nga mikja dhe kolegia Sandra Bullock, aktorja ka pozuar, duke shpalosur linjën e saj pa të meta dhe "marramendëse". E veshur me një xhakë të lëkure të zezë, pa pantallona, këmbët e gjata të ekspozuara dhe çizmet mbi gju, ylli i

"The Morning Show" është vajza që pushton kopertinën e revistës për muajin mars, e bukur, sensuale dhe jashtëzakonisht joshëse. "Jam ndjerë gjithnjë e pasigurt në fëmijërinë time. Jam rritur në një familje të destabilizuar në të cilën kam parë të rritur jo të sjellshëm ndaj njëritjetrit, dhe kjo më ka bërë të mendoj: nuk dua të bëhem kështu", ka thënë Aniston, duke iu përgjigjur pyetjeve të mikes.



Modeluesja shqiptare pozon pa sytjena

Modeluesja shqiptare, Françeska Jaçe, ka publikuar një foto të re në llogarinë e saj në "Instagram". Me imazhin e postuar si zakonisht edhe kësaj radhe ka marrë gjithë vëmendjen pasi ka vendosur të vishet në mënyrë tejet provokative. Në pjesën e sipërme të trupit shihet se nuk ka veshur fare sytjena madje ka zbuluar pothuajse gjithçka. Françeska njihet si një ndër emrat që nuk e ka problem asnjëherë të shfaqet e tillë



Khloe Kardashian vë në pah linjat trupore



Motrat Kardashian, njihen për linjat e tyre trupore më të cilat marrin vëmendje pothuajse çdo herë dhe arrin edhe të komentohen. Ajo që zë vend më shumë kur flitet për linja të theksuara është Kim Kardashian, por këtu edhe motra e saj Khloe nuk përjashtohet. Së fundi, ajo ka postuar

në "Instagram" imazhe e veshur me fustan të bardhë e cila ka ekspozuar pasuritë trupore. Me fustanin e bardhë, Khloe ka treguar gjoksin dhe krahët në pjesën e sipërme. Po ashtu, 35-vjeçarja i ka dhënë edhe më shumë hijeshi pamjes duke venë në pah edhe këmbën e djathtë në të çarën e fustanit.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Feronikeli arrin në gjysmëfinale, synon ta mbrojë Kupën

Pas Ballkanit, Prishtinës dhe Drenicës, Feronikeli është skuadra e katërt që ka arritur në gjysmëfinale të Kupës. Klubi nga Drenasi objektiv kryesor e ka të triumfojë sërish në këtë garë dhe më pas të marrë pjesë në Ligën e Evropës



uar se skuadra prizrenase nuk ka kapacitet të luftojë në të dy frontet. Megjithatë, ai është ndarë i kënaqur me paraqitjen e djelmoshave të tij. "Ishte një test i mirë për ne para fillimit të Ligës së Parë, duke ditur se kemi nisur me vonesë stërvitjet, por jam i kënaqur me ekipin. Liria do ta synojë inkuadrimit në Superligë këtë vit dhe nuk ka kapacitet të luftojë në dy fronte. Kemi qenë të vetëdijshëm për forcën e Feronikelit pasi ka lojtarë mjaft cilësorë, andaj i dëshiroj suksese në vazhdim. Gjithsesi, jam i kënaqur me angazhimin e futbollistëve të mi, ani pse kishim disa mungesa në këtë takim", ka thënë Shengyli. Feronikeli në gjysmëfinale u bashkohet tri skuadrave të tjera: Ballkanit, Prishtinës dhe Drenicës.

Feronikeli nderon kapitenin Rexhep Rexhepi

Në 21-vjetorin e rënies heroike, KF Feronikeli ka bërë homazhe te varri i kapitenit legjendar Rexhep Rexhepi. Rexhepi ishte kapiten i KF Feronikelit para se ai t'i bashkohej Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai ra heroikisht dëshmor më 12 shkurt të vitit 1999, për të mbetur i pavdekshëm në zemrat e tifozëve të KF Feronikelit dhe të mbarë qytetarëve të Kosovës. "Jemi krenar që stadiumi i klubit mban emrin e Rexhep Rexhepit, kapitenit që mes dashurisë për futbollin dhe aspiratës për liri, zgjodhi këtë të fundit, por arriti të mbesë në kujtimet tona për të dyja ëndrrat e tij. Shpresojmë që edhe ai është krenar me të arriturat e klubit të zemrës. I qoftë i lehtë dheu i Kosovës!", ka thënë Ramaj, president i KF Feronikeli.

ta rrisin konkurrencën në skuadër", ka thënë Sopi.

Loja e zhvilluar në stadiumin "Përparim Thaçi" ishte mjaft interesante. Nuk munguan edhe rastet për shënim, por pjesa e parë u mbyll pa gola 0-0. Duhet cekur se për vendasit në këtë pjesë rastin më të mirë e lëshoi sulmuesi Fatih Karahoda, kurse për mysafirët nuk u treguan të saktë Mevlan Zeka dhe Besmir Bojku. Në fillim të pjesës së dytë Memaj i Lirisë provon, por Troshupa ishte në vend. Më pas portën e prizrenase e kërcënoi Albert Dabiqaj por, pa sukses. Dy minuta para fundit të kohës së rregullt në skenë doli Besmir Bojku që realizoi për 0-1. Në minutën e parë shtesë, Mendurim Hoti realizoi për rezultatin final 0-2. Pas ndeshjes, trajneri i Lirisë, Skënder Shengyli, ka pran-

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRIZREN, 12 SHKURT - Kampioni dhe fituesi i Kupës, Feronikeli, ka arritur të kualifikohet në gjysmëfinale të Kupës, pasi të mërkurën e ka mposhtur Lirinë në Prizren (0-2). Këtë sukses trajneri i "Niklit", Agim Sopi, ia dedikon ish-kapitenit Rexhep Rexhepi. "Kjo fitore shkon për legjendarin, ish-kapitenin e kësaj skuadre, Rexhep Rexhepi. E kemi ditur që nuk do të jetë e lehtë, sepse edhe fusha nuk ishte e mirë. Patëm rastet tona, mirëpo nuk i shënuam. E rëndësishme është durimi që futbollistët kishin, pastaj më gëzon edhe mospesimi i golit. Përfundimisht, jam i kënaqur edhe me ardhjet e reja në ekip, të cilëve iu duhet pak kohë të ambientohen dhe

SHKURT

AS Prishtina kualifikohet në finale të Kupës

AS Prishtina është kualifikuar në finale të Kupës në Ligën e Parë pasi ka mundur Dritën me rezultat 96:71 (23:15, 16:7, 24:28, 33:21). Kreshnik Muqolli me 19 pikë dhe Don Polloshka me 18 ishin më të mirët tek AS Prishtina, kurse te Drita u dalluan Laurant Ibrahimimi me 20 pikë dhe Qëndrim Demi me 18. AS Prishtina në finale do të ndeshet me Vëllaznimin, sfidë që do të zhvillohet të enjten nga ora 14:00 në palestrën "Mizahir Isma" në Rahovec.

Ballack: Bayerni është favorit kundër Chelseat

Bayern Muncheni është favorit ndaj Chelseat në Ligën e Kampioneve kundër Chelseat për shkak se lojtarët i kanë të rinj dhe trajneri Frank Lampard nuk ka shumë përvojë. "Bayerni është favorit, për shumë arsye. Përvoja është në anën e tyre", ka thënë Ballacku. "Dënimi që Chelsea e kishte për të mos iu lejuar transferimi i lojtarëve bëri që ata të detyrohet t'u besojnë lojtarëve të rinj. Edhe trajnerin e kanë të ri dhe pa përvojë në këtë punë dhe kjo është një epërsi e madhe për Bayernin. Një plus i madh për Bayernin është edhe niveli i paraqitjeve të lojtarëve tani. Ata janë shumë më stabilë sesa që ishte gjatë vjeshtës së kaluar", ka deklaruar Ballack.

Eliminohen Partizani dhe Laçi

Kupa e Shqipërisë e ka mbyllur fazën e 1/16-ve teksa janë përcaktuar edhe tetë skuadrat që do të avancojnë më tej dhe do të përballen sipas shortit dhe rugëtimit të vendosur në fazën çerekfinale të saj. Befasia e madhe ka ardhur nga "Elbasan Arena", aty ku Partizani ka mundur Besëlidhjen 3-1 me tripletën e Telushit, por që nuk ka mjaftuar, pasi lezhjanët shënuan të parët me Hajdarin dhe duke u nisur nga fitorja e tyre 3-0 në Lezhë, kampionët e Shqipërisë braktisin kështu kompeticionin. Ndeshje e dyluftuar dhe e bukur edhe në Laç, aty ku kurbinasit gjetën dy gola që rihapën gjithçka pas humbjes 2-0 në Ballsh. Por, Bylis gjeti forcën për të reaguar dhe shënoi me Hidi dhe Guindo, ndërsa në fund kurbinasit realizuan edhe golin e 3-2, por që nuk mjaftoi për ta shmangur eliminimin. Fitore e lehtë për Tiranën, Kukësin, Skënderbeun, ndërsa Vllaznia pas 2-2 në shtëpi arriti sukses në Vlorë ndaj Flamurtarit, duke mundur kuqezinjtë 2-0 me golat e Silvio Rodrigues. Eliminohet edhe Luftëtari pas barazimit 0-0 ndaj Apolonisë. Teuta përmbysi Erzenin 2-1, pasi miqtë shënuan të parët. Edhe durrsakët avancojnë. Sa i përket fazës së ardhshme çerekfinale, ja çiftet e përcaktuara te Grupi A dhe B: Tirana-Besëlidhja, Teuta-Vllaznia, Skënderbeu-Bylis, Kukësi-Apolonia.

Ministrja Dumoshi viziton Departamentin e Sportit

Prishtinë, 12 shkurt - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, të mërkurën ka realizuar një vizitë pune në Departamentin e Sportit. Ministrja Dumoshi gjatë këtij

takimi ka kërkuar bashkëpunim me këtë departament në mënyrë që të realizohen të gjitha programet në fushën e sportit. "Vizitë pune e ministres Vlora Dumoshi në

Departamentin e Sportit. Ministrja Dumoshi takoi zyrtarët e këtij departamenti dhe theksoi se përmes bashkëpunimit, korrektësisë dhe zbatimit të programit të sportit, do të avancohet fusha

e sportit, e cila është një prej fushave më të suksesshme dhe e cila ka ngritur lart emrin e Kosovës në arenën ndërkombëtare sportive, por edhe në sferat e tjera", thuhet në njoftimin e MKRS-së.



Kobe dhe Gianna Bryant varrosen në një ceremoni mortore sekrete

KALIFORNI, 12 SHKURT - Legjenda e basketbollit, Kobe Bryant dhe e bija e të cilët humbën jetën në një aksident ajror më 26 janar të këtij viti, janë varrosur në një ceremoni tërësisht private, ku morën pjesë vetëm njerëzit e afërt dhe familjarët. Të gjithë detajet e ceremonisë janë mbajtur

sekret dhe në të nuk ka pasur asnjë fotograf të pranishëm, ndërsa gjithçka është zbuluar vetëm nga certifikata e vdekjes, e publikuar nga autoritetet vendase. Sipas dokumenteve ceremonia është mbajtur të premtën e kaluar, ndërsa trupat e Kobe dhe Gianna Bryant do të prehen në Pacific View

Memorial Park di Corona del Mar, në Kaliforni, aty ku edhe banonin. Përveç basketbollistit amerikan Kobe Bryant dhe të bijës Gianna Bryant, humbën jetën në aksident edhe John, Keri e Alyssa Altobelli, Sarah e Payton Chester, Christina Mauser dhe piloti 48-vjeçar Ara Zobayan. Bordi i

Sigurisë së Transportit Kombëtar ka mbledhur prova mjaftueshëm në vendin e ngjarjes për të zbuluar shkaqet e aksidentit, ndërsa paraprakisht mendohet se fushë-pamja e kufizuar për shkak të mjegullës mund të ketë luajtur një rol vendimtar për rrëzimin e helikopterit.



Klubet angleze shpenzuan me së shumti në janar

LONDER, 12 SHKURT - Pavarësisht blerjeve të bujshme të Eriksen nga Interi dhe Kulusevskit nga Juventus në Serinë A italiane, kampionët e merkatos së riparimeve janë sërish klubet e Premier Ligës në Angli, që gjatë muajit janar kanë shpenzuar plot 270 milionë euro. Sipas një raporti të publikuar nga FIFA, në vendin e dytë renditet Bundesliga gjermane, me klubet atje që kanë shpenzuar 189 milionë euro gjatë merkatos së janarit, ndërsa Seria A renditet vetëm e treta me 115 milionë euro dhe pesëshja plotësohet nga La Liga me 108 milionë euro dhe Ligue 1 me 69 milionë euro. Sa u përket të ardhurave nga shitjet gjatë merkatos së janarit, renditja kryesohet nga klubet gjermane me 93 milionë euro, të ndjekur nga La Liga me 82 milionë euro, Seria A me 72 milionë euro, Premier Liga me 60 milionë euro dhe Ligue 1 me 34 milionë euro. Ndërkohë



vlen të theksohet se sipas raportit të FIFA-s, transferimet e bëra nga klubet e 5 ligave kryesore evropiane zënë 14.1% të të gjithë transferimeve të botës së futbollit, por si vlerë lekësh kapin rreth 71.4 % të shifrës së shpenzuar. Kujtojmë që rekordin për shpenzime në

merkaton e janarit e mban Premier Liga në dimrin e 2018-ës, me 459 milionë euro të shpenzuara, ndërsa Seria A rekordin e pati dimrin e kaluar me 139 milionë euro, shifër kjo e ngritur ndjeshëm nga Milani që bleu Piatekun dhe Paquetan.

Clippersat dështojnë ndaj Philadelphias, Houstoni i rikthehet fitoreve

Houston, 12 shkurt - Një hap fals i ekipit të Clippersave, që pësoi humbje me rezultat 110-103 nga Philadelphia, duke humbur terren karshi Lakersave në renditje. Skuadra e Philadelphias e dominoi ndeshjen dhe meritoi fitoren, me Ben Simmons autor i një "triple double", me 26 pikë, 12 rebound e 10 asistim. Po 26 pikë realizoi edhe Embiid për Philadelphia, duke i bërë të pavlefshme 30 pikët e Leonard për miqtë. Pa probleme ka fituar Washingtoni, 126-114 ndaj Chicago, me Beal autor të 30 pikëve. Rikthehet te fitorja edhe Houstoni, që mundi me rezultat



116-105 Bostonin, sfidë e vendosur në pjesën e dytë më favor të ekipit teksan. Hardeni realizoi 42 pikë, ndërsa Westbrook 36 pikë e 10 rebound. Jashtë fushe fiton edhe skuadra e San Antonios, që mposhti 114-106

Oklahoman, ndeshje e komanduar nga Spurs. Më të mirët për miqtë ishin Leonard dhe Murray, me nga 25 pikë secili. Skuadra e New Orleans, falë 31 pikëve të Williamson, mundi 138-117 Portland.

REZULTATET

Philadelphia - Clippers	110-103
Washington - Chicago	126-114
New Orleans - Portland	138-117
Oklahoma - San Antonio	106-114
Houston - Boston	116-105

SHKURT

Casillas synon postin e presidentit në Federatën Spanjolle të Futbollit

Ish-portieri i Real Madridit, Iker Casillas u ka komunikuar organeve zyrtare, se do të kandidojë për kreun e Federatës Spanjolle të Futbollit, përballë Rubiales. Portieri ende nuk ka bërë publike diçka personalisht, por do të jetë i gatshëm për hapin e madh. Kjo iniciativë e spanjollit është folur edhe më parë, por sipas programit "El Larguero" të "Cadena Ser", bëhet me dije se janë bërë lëvizjet e para zyrtare. Ish-portieri, kampion Bote në 2010-ën me Spanjën, ka komunikuar në rrugë zyrtare qëllimin e tij dhe është gati të përballlet me Rubiales.

Pochettino: Dua të punoj sërish në Premier Ligë

Mauricio Pochettino e ka pranuar se do të dëshironte të kthehej në Ligën Premier. Trajneri argjentinas ka qenë i papunë që prej nëntorit, kur u shkarkua nga detyra e tij të Tottenham Hotspur. Është e paqartë ende se ku do të shkojë Pochettino në të ardhmen, por ai me sa duket po pret një mundësi për tu kthyer në Ligën Premier. "Për të qenë i sinqertë, unë do të doja të punoja në Ligën Premier. Do të jetë e vështirë, unë e di, dhe tani për tani është një moment për të pritur dhe ne do të shohim se çfarë ndodh", ka thënë Pochettino. "Është një moment rikuperimi, të mendoni pak për veten tuaj dhe të jeni gati sepse në futboll gjithmonë mund të ndodhë diçka dhe duhet të jeni gati. Jam gati dhe pres një sfidë të re. Kam besim te vetja dhe besim se sfida tjetër do të jetë fantastike", ka deklaruar Pochettino.

Fred: Nuk kemi unitet tek Unitedi

Mesfushori i Manchester United, Fred e ka përshkruar gjendja e brendshme të klubit si jo të mirë pasi që skuadrës po i mungon uniteti. "Djajtë e Kuq" po vuajnë në mungesë të rezultateve dhe sipas 27-vjeçarit janë disa probleme që po i pengojnë 20-herë kampionët e Premierligës të synojnë pozita më të larta në klasifikim. "Na duhet një figurë unifikuese edhe jashtë fushave. Kemi mungesë kreativiteti, veçanërisht në mesfushë. Duhet të qëndrojmë të bashkuar dhe të punojmë së bashku, ani se në radhët tona ka individë që duan shumë probleme t'i zgjidhin vetë", ka thënë braziliani. Paul Pogba është më i shigjetuari për klimën e krijuar brenda klubit, pasi që prej shumë shokëve të skuadrës konsiderohet si përçarësi i skuadrës.

Guardiola: Shkarkona nëse eliminohehem nga Reali

Trajneri Manchester Cityt, Pep Guardiola pranon se ai mund të pushohet nga puna nëse eliminohet nga kundërshtarët e Ligës së Kampionëve, Real Madridi. Këto dy skuadra përballen mes vete në raundin e 1/16-tës në garën më të madhe ekipore evropiane. "Kjo është arsyeja pse është kaq e vështirë ta fitosh atë. Dhe në 100 e më shumë sezone të historisë për Manchester Cityt, ishin 100 sezone të dështimit - kjo nuk është e vërtetë", ka thënë Guardiola. "Ka shumë lojtarë të pabesueshëm që i bënë të lumtur tifozët tanë, dhe tifozët tanë shijuan një pjesë të sezonit. Unë e di se njerëzit thonë 'Ju jeni i mirë' ose 'Ju nuk jeni mjaft i mirë'. Unë e pranoj atë. Dua të fitoj Ligën e Kampionëve, ëndëroj dhe do të shijoj ndeshjet kundër Real Madridit, për të parë se çfarë mund të bëj". "Nëse ne nuk i mposhtim ata, atëherë do të vijë kryetari, ose drejtori sportiv dhe do të thonë: 'Nuk është mjaftueshëm, ne duam Ligën e Kampionëve, unë do të të largojmë ty', ka shtuar Guardiola.

AUTOR: ISMAIL GAGICA	BOTUESI I "EPOKËS SË RE" (FOTO NR.1)	I BIRI I AEDONËS (MIT. GREKE)	ASTRONOMI POLAK NIKOLLAJ	GAZETË E PËRDITSHME KOSOVARE (FOTO)	LITERATURA (SHKURT.)	SHKRONJA E PARË	QË BËHET NË PËRPUTHJE ME ZHVILLIMIN E RREGULLT TË GJËRAVE	OBJEKT FETAR ISLAM	EGON ZEHNDER INTERNAT- IONAL	BËRA LEQE	OKSIGJENI	JAHA FUSHA	POETI YNË PODRIMJA	Numri EPOKA ERE 6000	LLAZAR TUNI	GAZETARI I "EPOKËS SË RE" MUSTAFA (SHQ.)	KARIKATUR- ISTI KOSOVAR DHE I "EPO- KËS SË RE" (FOTO NR.2)	
SKULPTORI I NJOHUR ITALIAN BUONAROTI (SHQ.)														BISEDË GAZETAR I "EPOKËS SË RE" TANI I T7 (FOTO NR. 6.)				
PËRFYTYRIM IDEAL I SHOQËRISË NJERËZORE						VENDI I GJELBËR NË SHKRETËTIRË LINDJE (ANG. OR.)						KRIHË TË SHPEZËVE LIQEN NË AMERIKËN VERIORE						
QË KA TË BËJË ME HIPOTERMINË												IRBARHIM REXHEPI SHTËT NË AMERIKËN QENDRORE			TOM HENKS TANTALI			
PRONAR I STUDIOS SË FILMAVE VIZA- TIMORË NË AMERIKË, ARNANUTI					SHOK (FR.) I LYER ME SILIC				OPTION INSTALLATION KEY LËSHIM NË QARKULLIM I DIÇKAJE				YLL FILMI PRINCE EDWARD ISLAND					
METRI		ISH-ZONJA E PARË GORBAÇOV SOLISTI YNË SUNAJ (LULJA E KUJTIMIT)						BANORI I KONTINENTIT TONË COPE ÇELIKU										
KRYERED- AKTOR I "EPOKËS SË RE" (FOTO NR. 3)												AKTORI NEILL (XHURASIK PARK) SILICON VALLEY BANK			IDRIZ AJETI LUMË NË AZI			
VARIANTI I EMRIN TAHIRI						ASTRONOMI BRITANEZ XHORXH BIDEL GRIMCOVA				MËNYRË E TË SHKRUARIT AUSTRIA						ABBHËTING- ËLLORE JONA DYSHE MISI FILIPINEZ NIKOL		
MËSUESI YNË TARABULLUZI (SHQ.)							KRYEQYTETI KANADEZ KËNGËTARJA ISTREFI						EMËR YNË FEMRE QYTET NË INDI (ANAGRAM: E VURA)					
LUMI AZIATIK ...? DARJA				KRYEREDAK- TOR "EPOKËS SË RE" MUSHKOLAJ (FOTO NR. 5) GAZ. SPORTIV I "EPOKËS ..."								AKTORI AMERIKAN LI, DJALI I BRUS LISË QYTET ÇAM						
GJASHTË (ROMAK)			ACARI I MADH VARIANT I EMRIN KASËM									DJALË, ÇUN TË BUKURIT			NEONI KRIMB DRURI, KËRRMI			
RADIUSI		KYUNG HEE UNIVERSITY DREJTORI I "EPOKËS SË RE" (FOTO NR. 4)				SHKRONJA E PARË FAMA, ZULMI		FQINJI I IRANI DHËNIA E PËRMBAJTJES SË NJË FJALE					PIKTORI YNË KODHELI ENVER ROBELLI					
KËNGË JONA POPULLORE "...? ASAMAN"							FOSFORI RUZHDI USHAKU			TRARI I MBËRTHYER MBI NJË TJETËR FLUORI								
UDHËHEQËS I NJOHUR PALESTINEZ													VEPËR MUZIKORE				Numri EPOKA ERE 6000	
Numri EPOKA ERE 6000	DIRECTORY INFORMATION TREE GUXIMTARI, HEROI				RRETHOJË ME GURË REGJION NË JAPONI EDHE LLOJ LULE (PASHQ)													
CILËSIA A NGJYRA E VEÇANTË E TINGULLIT							ANGSTREMI BËJ LUTJE											
RAMIZ KELMENDI			INDUSTRIA ELEKTRONIKE VLLAH			LUCAS FOX RILINDËSI YNË PANDELI												
QË I KA RËNË TË FIKËT, I ALIVANOSUR																		
BËRA ME MERAK																		
QË ËSHTË I LAGUR SHUMË							ZETI TITULL PRIFTI KATOLIK											
Numri EPOKA ERE 6000	PËREMËR PRONOR TEUTA SADIKU				DIKTATORI UGANDEZ AMIN KOMNINATI NDËRTIMOR													
MEND, DIJE				ELEMENT KIMIK ZERO														
FJALË A SHPREHJE ME KUPTIM TË NJËJTË																		





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim / Department of Education

Nr.1434/20
Dt: 12.02.2020

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Nenit 5 (shkronja c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Rep. së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 17 (shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Nenit 35 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar në Rep. e Kosovës Nr. 04/L-032, të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, të UA të MASHT 10/2018 si dhe në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore, Drejtoria Komunale e Arsimit në Skenderaj, shpall:

Konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2019/2020

Nr.	Niveli	Pozita	Institucioni	Vendi	Pensionim / Zëvendësim	Nr. i orëve	Nr. i pozitave
1	Shfmu	Mësimdhënës/e për lëndën Edukatë Muzikore	"Pavarësia" "Kuvendi i Drenicës" "Azem Bejta"	Krasaliq, Abri e Poshtme, Prekaz i Epërm	Vend i lirë	16 orë	1
2	Shfmu	Mësimdhënës/e për lëndën e Biologjisë	"Dëshmorët e Qyqavicës"	Qirez	Vend i lirë	Normë e plotë	1
3	Shfmu	Mësimdhënës/e për Biologji - Kimi	"Halit Geci"	Llaushë	Vend i lirë	14 orë	1
4	Shfmu	Mësimdhënës/e për lëndën e Kimisë	"Bashkim Sadiku"	Tushilë, Rakinicë	Vend i lirë	12 orë	1
5	Shfmu	Mësimdhënës/e për lëndën e Biologjisë	"Faik Dragaj"	Leqinë	Zëvendësim	10 orë	1
6	Shfmu	Mësimdhënës Mbështetëse	"Ahmet Delia"	Skenderaj	Zëvendësim	Normë e plotë	1
7	Shfmu	Mësuese klase	"Ahmet Delia"	Skenderaj	Zëvendësim	Normë e plotë	1

Kushtet: Për të gjitha vendet e punës, në të gjitha nivelet, kandidatët duhet t'a kenë të kryer fakultetin - drejtimi përkatës sipas Normativit 10/2018, Zgjedhja e kandidatëve për mësimdhënës do të bëhet në bazë të nenit 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, UA 10/2018 si dhe në bazë të rezultateve të panel-intervistës, me shkrim dhe me gojë.
Për intervistën me gojë dhe me shkrim do të ftohen vetëm kandidatët e listës së ngushtë, sipas nenit 4 të UA 17/2009.
Kandidatët e listës së ngushtë me shkrim dhe me gojë do të ftohen në telefon.
Për konkursin, kandidatët duhet të plotësojnë dokumentacionin:

- ✦ Diploma dhe një kopje e vërtetuar e diplomës;
- ✦ Kopja e letërvojës;
- ✦ Vërtetimin për punë nga gjykata;
- ✦ Certifikatën e sjelljes shëndetësore (në rast se pranohet);
- ✦ Certifikatë trajnimi - nëse koni;
- ✦ Përvoja e punës - nëse koni;
- ✦ Referencën e punës - ata që kanë përvojë punë;

 Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e Komunës, kati i parë, sporteli nr. 13.
Kandidatët mund të konkurrojnë me së shumti në dy shkollat.
Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomën e nostrifikuar nga MASHT.
 Fillimi i punës për vendet e lartçekura, nuk do të jetë domosdoshmërisht me datën e shpalljes së rezultateve, por varësisht nga vendi i punës në shkollë (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).
Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pa afatit, nuk merren në shqyrtim.
Rezultatet e konkursit do të shpallen në webfaqe të Komunës së Skenderajt.
Dokumentacioni nuk kthehet.
Afati i konkursit mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë dhe në webfaqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.
Drejtoria Komunale e Arsimit
Skenderaj

Drejtoria e Gjinnazit "Gjon Buzuku" në Prizren
Nr. prot: 385 datë 12.02.2019
Prizren

Bazuar në nenin 11, të Udhëzimit Administrativ – Aktivitetet jashtëshkollore nr. 02/2016 dhe në vendim nr. Prot: 383 të datës 11.02.2019, të të KDSH-së, Gjinnazi "Gjon Buzuku" në Prizren, shpall:

Ftesë për ofertë


Për ekskursion të maturantëve të Gjinnazit "Gjon Buzuku" në Prizren
Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjensitë turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të Gjinnazit "Gjon Buzuku" nga Prizreni për në Republikën e Shqipërisë më datë 07.05.2020 deri më 12.05.2020.
Paraqitësit në tender duhet t'i plotësojnë këto kushte:

Kriteret e përgjithshme:


- Certifikatën e biznesit me informata për biznesin,
- Vërtetimin e Administratës Tatimore për tremujorin e fundit të vitit fiskal
- Vërtetimin për pagesën e taksave komunale për vitin 2019
- Licencën e transportit ndërkombëtar "D"
- Referencat rreth organizimit të ekskursioneve me maturantë për tri vitet e fundit 2017, 2018, 2019
- Fotokopjet e librezave të autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore dhe kontrolli teknik
- Kopjen e sigurimit të autobusëve, patentshoferëve të vozitësve dhe certifikata e kompetencës profesionale CPC
- Certifikatat mjeksore për vozitësit
- Autobusët të jenë në pronësi, komfor me klimë dhe në numër të mjaftueshëm për mbi 500 vende.
- Kompania të siguroj mjekun (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut).
- Licencën e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve
- Dëshmi për hotelin e ofruar në Durrës për datat 07.05.2020- 12.05.2020.
- Të prezantohet ambienti (komoditeti) së paku me foto i Hotelit (në CD) nr.telefonit i pronarit dhe adresa.
- Hoteli të posedoj mbi 500 shtretër. Të posedoj banjo dhe ujë të mjaftueshëm.
- Sistemimi i nxënësve në dhoma të jetë jo më shumë se katër nxënës.
- Të prezantohet menyuja e ushqimit dhe pijeve për tri racione ditore për pesë ditë qëndrimi, dhe sipas kërkesave të ofrohet ushqim në orar për nxënësit që axherojnë.
- Gjatë vizitave nëpër monumente të sigurohet shujta dhe pagesa hyrëse nëpër monumente sipas itinerarit të përcaktuar nga KDSH.
- Agjensioni të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tre vitet e fundit (2017, 2018 dhe 2019) së paku 250 000 euro.
- Hoteli të posedoj sallë për argëtim për nxënës dhe të mos shërbehen apo lejoj shitjen dhe përdorimin e pijeve alkoolike në tërë hapësirën e hotelit.
- Licencën e sallës për argëtim për së paku 500 nxënës.
- Oferta për nxënës të liuar nga pagesa.
- Vërtetim (certifikatë) mbi qëndrueshmërinë e Hotelit pas termetit të lëshuar nga organet kompetente.
- Të gjithë dokumentacionet të jenë të noterizuara, ose të vërtetuara në Komunë

Vërejtje: Kompania Turistike fituese në përfundim të ekskursionit duhet t'i siguroj nënshkrimet nga: Drejtori i shkollës, përfaqësuesi i Këshillit të prindërve si dhe nga përfaqësuesi i Këshillit të nxënësve, për përmbushjen e kushteve të përcaktuara sipas kriterëve të lartçekura dhe ky dokument të dorëzohet në DKA.

P.s. Lartësia e pagesës 105 euro
Ofertuesit e interesuar aplikacionet dhe itinerarin e udhëtimeve mund t'i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit në Prizren.
Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë nga dita e publikimit në gazetë.
Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA.02/2016 më datë 20.02.2020.
Pas hapjes së ofertave, Komisioni do të verifikoj dokumentacionin dhe kushtet e ofruara nga kompanitë, ku dhe do të bëhet vlerësimi.
Fituesi i ofertës për organizimin e ekskursionit do të jetë kompania Turistike e përgjegjshme me çmimin më të ulët të ofertës.
Drejtoria e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Skenderajt
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim / Department of Education

Nr. 1435 /2020
Dt: 12.02.2020

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës nr.03/L-212, të nenit 5 pika c të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068 dhe nenit 4 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, Drejtoria e Arsimit në Skenderaj, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Pozita: Punëtor teknik - Pastrues

1. Punëtor teknik – në Shfmu "Ahmet Delia" - Skenderaj
1. Punëtor teknik – në Shfmu "Drenica" - Polac

Koeficienti : **4.0**
Lloji i vendit të punës: **me orar të plotë**
Numri i pozitave: **dy (2) ckzckutues**

Detyrat kryesore të punës :

- Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha ambientet e shkollës, të mirëmbajë dhe pastrojë sipërfaqet e gjelbëruara të shkollës.
- Të ruajë mirë pasurinën e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujdes.
- Të identifikojë, të evidentojë, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizimin ose harxhimin e mjeteve të punës.
- Të mirëmbajë objektin, të kujdeset për shpenzimet e lëndëve djegëse, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe, sipas nevojës, t'ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës.

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
- Të kenë të mbaruar Shkollën e Mesme
- Përvoja e punës e preferuar

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Aplikacioni
- Diploma e shkollimit
- Certifikatën që nuk është nën hetime
- Letërvojë (kopje)

Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e Komunës, kati i parë, sporteli nr.13.
Afati i konkursit mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë dhe në webfaqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "VB. Tofaj" Sh.p.k. Junik, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK



Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit në Botushë komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 11.03.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Kroni"- Potok i cili gjendet afër zonës kadastrale Botushë komuna e Gjakovës do të organizohet debat publik nga kompania "VB. Tofaj" Sh.p.k. Junik, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit në Botushë komuna e Gjakovës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

"VB.TOFAJ" SH.P.K
JUNIK 51050
DREJTORI:



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government



Këshilli i Sigurisë i Kosovës
Savet Bezbednosti Kosova / Kosovo Security Council
Sekretariati / Sekretariat / Secretariat

Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës shpall **KONKURS TË BRENDSHËM** për këtë vend të punës:

I. Udhëheqës i Sektorit të Politikave të Sigurisë
Numri referencës: SKSK-003
Koeficienti: 9

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e Drejtorit të Drejtoratit të Analizave dhe Politikave të Sigurisë, kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- Menaxhon punën e përgjithshme të sektorit dhe ndihmon Drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave;
- Menaxhon stafin dhe në bashkëpunim me Drejtorin, organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore;
- Ndihmon Drejtorin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime / përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
- Menaxhon ofrimin e produkteve dhe shërbimeve në fushën e hartimit të dokumenteve strategjike të KSK-se për tu siguruar se janë në përputhje me politikën e sigurisë së vendit, para se ato të diskutohen nga ana e KSK-së e në veçanti duke këshilluar mbi qështjet që ndërlidhen me politikën e e veprimit në fushën e sigurisë;
- Zhvillon dhe mban kontakte të niveleve të larta me institucionet qeveritare dhe organizatat tjera të sigurisë për shkëmbimin e informatave dhe përfaqësimin e qëndrimeve të departamentit rreth çështjeve relevante;
- Ekzaminon dhe ofron komente dhe këshilla ligjore dhe politike të sigurisë Sekretarit të KSK-së në rishikimin e strategjive, projekt ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare si dhe çfarëdo dokumentesh, që Këshillit të Sigurisë së Kosovës i kërkohen me ligj t'i zhvillojë apo rishikojë;
- Përmbledhe raportet e punës dhe finalizon analizat parësore dhe dytësore mbi çështjet e ndërlidhura me politikën e sigurisë, të përcjellura nga stafi profesional;
- Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara.

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë universitare, preferohet në shkencë shoqërore, administrim publik, shkencë juridike dhe minimum 4 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e politikave të sigurisë;
- Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
- Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues;
- Njohuri të mirë të gjuhës shqipe dhe serbe në të folur dhe shkruar, e dëshirueshme gjuha angleze;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim.

PROCEDURAT E KONKURIMIT

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunësit civil ekzistues në Sekretariat dhe Qendrën e Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.

Së bashku me formularin zyrtar të punësimit, duhet të dorëzohet dëshmia për kualifikimin shkollor dhe profesional, dëshmitë për përvojën e punës sipas konkursit, vlerësimet e fundit të punës, si dhe dy referenca.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në zyrën e Drejtoratit të Administratës. Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni në web faqen: www.ksk.rks-gov.net

Kërkesat dorëzohen në zyrën e Drejtoratit të Administratës. Kati -2, Ndërtesa e Qeverisë.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda SKSK-QS. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2010 për procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Njësive Civil.

Afati i konkurrimit është prej datës 13/02/2020 deri me datë 20/02/2020, nga ora 08:00 deri në orën 16:00.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit.
Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.
Për informata shtesë mund të telefononi në numrin: 038 200 15 607.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government



Këshilli i Sigurisë i Kosovës
Savet Bezbednosti Kosova / Kosovo Security Council
Sekretariati / Sekretariat / Secretariat

Sekretarijat Saveta Bezbednosti Kosova objavluje **OVAJ UNUTRAŠNJI KONKURS** za sledeće poslove:

I. Šef sektora bezbednosne politike
Broj referencije: SSBK-003
Koeficijent: 9

Obaveze i odgovornosti: Pod nadzorom i odgovornošću direktora Direkcije za bezbednosnu analitiku i politike, obavljaje sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Upravlja cjelokupnim radom odeljenja i pomaže direktoru u postavljanju ciljeva i razvoju plana rada za postizanje tih ciljeva;
- Upravlja osobljem odeljenja i u saradnji sa direktorom organizuje rad preko podređenim zadataka, pruža smernice i nadgleda rad osoblja za isporuku kvalitetnih proizvoda i usluga;
- Pomaze direktoru u proceni internih procesa i procedura i preporučuje izmene / poboljšanja u cilju povećanja efikasnosti i kvaliteta rada;
- Upravlja pružanjem proizvoda i usluga u oblasti izrade strateških dokumenata SBK-a kako bi se osiguralo njihovo usklađivanje sa politikama nacionalne bezbednosti, pre nego što ih raspravlja sa SBK-a i posebno savetuje o pitanjima u vezi sa politikama bezbednosnih akcija;
- Razvija i održava kontakte na visokom nivou sa vladinim institucijama i drugim bezbednosnim organizacijama radi razmene informacija i predstavljanja stavova odeljenja o relevantnim pitanjima;
- Ispitiva i pruža komentare i pravne i političke savete i bezbednosne savete Sekretaru SBK-a o preispitivanju međunarodnih strategija, nacarta zakona i sporazuma kao i svih dokumenata za koje je Savet bezbednosti Kosova potreban da bi ga razvio ili pregledao;
- Rezimira izveštaje o radu i završava primarne i sekundarne analize o pitanjima bezbednosne politike, koje sledi stručno osoblje;
- Provodi redovnu procjenu osoblja pod njegovim nadzorom i podržava njihov razvoj kroz obuku za obavljanje poslova u skladu sa traženim standardima.

Kvalifikacija, radno iskustvo i veštine:

- Univerzitetsku diplomu, po mogućnosti iz društvenih nauka, javne uprave, prava i najmanje 4 godine profesionalnog radnog iskustva.
- Znatno znanje i iskustvo u oblasti bezbednosne politike;
- Veštine postavljanja ciljeva, planiranja rada i analize;
- Veštine vodstva i organizacije, sposobnost upravljanja timom ili radnom grupom;
- Dobro poznavanje albanskog i srpskog jezika, koji se govori i piše, po mogućnosti i engleski;
- Veštine softverskih aplikacija (Word, Excel, Power Point, Access);
- Veštine komunikacije, pregovaranja i prepričavanja.

PROCEDURA KONKURSA

Procedura konkursa je otvorena za postojeće državne službenike u Sekretarijatu i Situacionom centru Saveta bezbednosti Kosova koji ispunjavaju kriterijume konkursa.

Uz zvanični obrazac za zapošljavanje, moraju se priložiti i dokazi o školskoj i stručnoj spremi, radno iskustvo, nedavne ocene posla i dve reference.

Upotreba netačnog obrasca i nepotpunog obrasca sa traženim podacima smatrat će se nevažećim.

Prijava za posao i opis posla mogu se dobiti u kancelariji Uprave za administraciju. Zvanični obrazac za prijavu možete naći na: www.ksk.rks-gov.net

Prijave se dostavljaju kancelariji Uprave za administraciju. -2. sprat, zgrada Vlade.

OPĆE INFORMACIJE ZA SVE KANDIDATE

Sekretarijat Saveta Bezbednosti Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve postojeće državne službenike u okviru SBK-SC-a. Zapošljavanje i izbor vršice se u skladu sa Zakonom br. 03/L-149 o državnoj službi Republike Kosovo, Pravilnikom br. 02/2010 o postupcima zapošljavanja u državnoj službi i Uredbi br. 21/2012 o unapređenju karijere državnih službenika.

Rok konkursa je od 13/02/2020. Do 20/02/2020, Od 08:00 do 16:00 casova.

Konkurs je otvoren 8 dana od dana objavljivanja.
Zahtevi poslati posle poslednjeg datuma konkursa neće biti prihvaćeni.
Za dodatne informacije možete nazvati 038 200 15 607.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Drejtoria për Arsim dhe Edukim

Adresa : Malishevë
Rr.-Skenderbeu ", p.n
Email: dkaemalisheva@gmail.com
Tel: 029-269-003

Data: 12.02.2020
Nr: 11/121

Drejtori për Arsim dhe Edukim në mbështetje të kontratës Kolektive neni 14 pika 7 nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për anulimin e Konkursit të datës 24.01.2020

1. Anulohet Konkursi i datës 24.01.2020 për mësimdhënës të lëndës së biologjisë për 4 orë mësimi dhe 2 orë mësimi të lëndës zgjedhore numri rendor 1 i konkursit .
2. Vendimi hynë në fuqi pas nënshkrimit të tij

Arsyetim

Mbështetur në Kontratën Kolektive Neni 14 pika 7 dhe në mungesë të buxhetit për vitin shkollor 2020 për paga u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Vendimi u dërgohet:

1. Drejtorit të SHFMU" Gjergj Fishta" në Senik z. Deli Zulfaj
2. Komisionit intervistues
3. Arkivit

Shtojca 6

Thirrja për aplikim

Mergim Kuçi B.I nga Juniku (Përfituesi) po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për mallrat/punët/ si në vijim:

Ndertimi i Pendes së Uitjes në Komunën e Junikut

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek Mergim Kuçi B.I (Përfituesi) nëpërmjet e-mail: megrim.kuqi@hotmail.com apo telefonit 049 236 236 për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë, thirrja per aplikim mbetet e hapur 5 ditë nga dita e publikimit të njoftimit

- Emri i përfituesit Mergim Halil Kuçi
- Adresa: Junik
- Tel./ 049 236 236
- E-mail adresa: megrim.kuqi@hotmail.com

Ofertat/Propozimet duhen dorëzuar tek adresa e përfituesit me jo më vonë 10 ditë pasi që Ftesa për Kuotim të jetë dërguar tek të gjithë ofertuesit / kompanitë e interesuara].

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Tehnoburimi" D.D. Shupkovc, Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksplotimin e gurit gëlqeror në Korroticë e Epërme, Vasilevë komuna e Drenasit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.03.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant të stacionit te karburanteve "Ex Fis" në Komoran komuna e Drenasit do të organizohet debat publik nga kompania "Tehnoburimi" D.D. Shupkovc, Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksplotimin e gurit gëlqeror në Korroticë e Epërme, Vasilevë komuna e Drenasit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Annex 6

Call for application

Mergim Kuçi B.I from Junik (Beneficiary) is required interested and qualified Bidder/Contractor/ Company to submit a Bid/Proposal/for goods/work as follows:
Construction of Irrigation Dam in Junik Municipality

Interested companies should contact Mergim Kuçi BI (Beneficiary) directly by e-mail: megrim.kuqi@hotmail.com or phone 049 236 236 to request a call for Quotation at the address below. The call for applications remains open 5 days after publication of the notice.

- Beneficiary's name Mergim Halil Kuçi
- Address: Junik
- Tel./ 049 236 236
- E-mail address: megrim.kuqi@hotmail.com

Bids / Proposals must be submitted to the beneficiary's address no later than 10 days after the Invitation to Quotation has been sent to all interested bidders / companies].



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

